



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2, 9 DHE 10 MARS 2017**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2, 9. I 10. MARTA 2017. GODINE**

**MARS - MART
2017**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale,
5. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit nr. 05/L-146 i drejtësisë për të mitur,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-128 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për minierat dhe mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-145 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-147 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-144 për noterinë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-136 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime,
13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, dhe Ligjin nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
14. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-152 për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave,
15. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-153 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar,
16. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-154 për ratifikimin e Protokollit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS,
17. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-155 për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK - Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Prvo razmatranje N/zakona o socijalnim preduzećima,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakonika br. 05/L-146 pravde o maloletnicima,
6. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-128 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-163 o rudnicima i mineralima, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-158,
7. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-145 o izmenama i dopunama Zakona br. 2004/26 o nasleđu na Kosovu,
8. Prvo razmatranje N/zakonika br. 05/L-147 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-007 o van parničnom postupku,
9. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-144 o javnom beležništvu,
10. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-140 o sprečavanju konflikta interesa u toku vršenja javne funkcije,
11. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-136 o uspostavljanju nacionalne infrastrukture za prostornu informaciju u Republici Kosova,
12. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-130 o uslugama,
13. Razmatranje Izveštaja Komisije za zakonodavstvo, mandate, imunitete, Poslovnik Skupštine i nadgledanje Agencije protiv korupcije o nadgledanju sprovođenja Zakona br. 03/L-223 Sudskog veća Kosova i Zakona br. 03/L-224 Tužilakog veća Kosova,
14. Razmatranje N/zakona br. 05/L-152 o ratifikaciji Sporazuma o finansijskoj saradnji između Vlade Republike Kosova, koju zastupa Ministarstvo za finansije i Vlade Republike Austrije, koju zastupa Federalno ministarstvo za finansije,
15. Razmatranje N/zakona br.05/L-153 o ratifikaciji Sporazuma između Vlade Republike Kosova i Vlade Mađarske o osnivanju okvirnog programa za finansijsku saradnju,
16. Razmatranje N/zakona br.05/L-154 o ratifikaciji Finansijskog protokola između Vlade Republike Kosova i Vlade Republike Francuske i Sporazumu o pozajmici za sprovođenje finansijskog protokola između Ministarstva za finansije Republike Kosova i NATIXIS-a,
17. Razmatranje N/zakona br.05/L-155 o ratifikaciji Sporazuma o garanciji za FSDK- druga kreditna linija Fonda za osiguranje depozita Kosova između Republike Kosova i Evropske banke za obnovu i razvoj,
18. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-150 o izmenama i dopunama Zakona o Centralnoj banci Republike Kosova,
19. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-129 o izmenama i dopunama Zakona o izvršenju krivičnih sankcija.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Zoti ministër,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23. 2. 2017.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka zoti Pal Lekaj, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Kolegë deputetë,

Sot, kur pritej të përfundonte një maskaradë, e cila po bëhet në kurriz të ish- kryeministrit Ramush Haradinaj, si duket disa vende ende nuk janë ngopur nga lojërat e ndyta që Serbia po ia bën Kosovës.

Vendimi i sotëm i një gjykate provinciale në Francë për t'ia vazhduar qëndrimin e edhe më tutje atje ish-kryeministrit Haradinaj tash po shihet qartë se është abuzim me të drejtat e njeriut, shkelje e tyre, tendencë për të diskredituar një luftë të tërë të një populli.

Ky shtet, ky vend duhet të tregohet shumë më serioz që këto përndjekje që po i bëhen Ramushit e Kosovës të marrin fund një herë e përgjithmonë.

Këtë që sot e pamë nga Kolmari nuk është asgjë më shumë se sa një kidnapim për interesa të Serbisë dhe të gjithë atyre që janë në krahun e saj.

Nuk e marrim ndryshe kur e shohim se Nikoliqi është president i Serbisë sot, dje bashkë me Vuçiqin, Daçiqin nën frymëzimin e Milosheviqit ishin ideatorë e organizatorë të krimeve ndaj popullsisë joserbe. Ndërsa, të tri vendet ende vazhdojnë të kërcënojnë me luftëra e gjakderdhje në Ballkan.

E, në anën tjetër, Ramush Haradinaj, ish-kryeministër, ish-deputet e lider i një partie në Kosovë, edhe përkundër se është dorëzuar vetë në vitin 2005 dhe është shpallur dy herë i pafajshëm nga instanca më e lartë e drejtësisë ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, vazhdon të mbahet tash peng nga një shtet evropian, për qëllime të një shteti agresor, siç është Serbia.

Ramushi duhet të lirohet. Kjo duhet të jetë alfa dhe omega e thirrjes të të gjithë neve pa dallime politike.

Në të kundërtën, e shohim si një kombinim vendor e ndërkombëtar për të eliminuar politikisht një udhëheqës të shquar politik të Kosovës, i cili të vetmin mëkat që po bën është mbrojtja me çdo çmim e Kosovës dhe historinë e kaluar e të ardhmen e saj, Kosovën të pacenuar dhe të fortë përballë të gjithë armiqve.

Prandaj, kërkoj që të ndërpritni këtë seancë dhe të reflektoni sa nuk është bërë vonë.

E kuptoj që Ramushi tanimë është peng i asaj, ndoshta edhe i riprocedimit të demarkacionit e i shumë të këqijave të Kosovës, prandaj, ju lutem, nëse doni ta mbani peng, silleni demarkacionin dhe votojeni. Por, mos bëni lojëra të pista dhe ta mbani peng Ramushin në Francë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Biznesi është mjet i rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe stabilitetin social në një vend.

Zhvillimi, rritja dhe qëndrueshmëria e sektorit privat është i një rëndësie të veçantë, sepse ndikon në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe për këtë është e vështirë të imagjinohet rritja e standardeve të përgjithshme të jetesës pa një zhvillim edhe të këtij sektori.

Zhvillimi i këtij sektori në Kosovë është në ngritje, por ende ka shumë sfida dhe barriera, të cilat duhet të eliminohen, në mënyrë që të krijohet një klimë dhe kushte më të mira e më të përshtatshme për ndërmarrësit e rinj nëpërmjet krijimit të kushteve të favorshme dhe të një infrastrukture ligjore dhe fizike, sepse ambienti i të bërit biznes te ne, nëse krahasohet me vendet në rajon, është ende mbrapa.

Përpjekjet e institucioneve qendrore dhe lokale nuk kanë munguar dhe për këtë kanë krijuar një mjedis më të përshtatshëm për zhvillimin e bizneseve si dhe joshjen e investitorëve të huaj, në mënyrë që të ketë investime në fusha të ndryshme, duke u afruar atyre mundësi për krijim dhe mundësi për uljen e kostove dhe zhvillimin e aktiviteteve të lira dhe pa pengesë.

Mirëpo, nëse shikohen raporte të ndryshme të publikuara, pothuajse janë ende problemet e njëjta të listuara, me të cilat ballafaqohen bizneset, si: problemi me energjinë elektrike, sundimi i rendit dhe ligji, konkurrenca jo e drejtë, monopoli, informaliteti, që janë pengesa dhe distimulues të zhvillimit të bizneseve, pasi që vazhdojnë të përballen me një mjedis jo edhe aq miqësor.

Ngritja dhe zhvillimi i bizneseve pa barriera të natyrave të ndryshme do të jetë faktor stimulues i zhvillimit të bizneseve, të cilët kanë potencial që të luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Kemi një angazhim të shtuar të Qeverisë së Kosovës dhe të dikastereve që merren me zhvillimin ekonomik, kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit, duke ftuar dhe joshur investitorët e huaj që një pjesë të potencialit dhe kapitalit të tyre të investojnë në Kosovë dhe besoj se kjo është e mirë dhe e shëndetshme për ekonominë tonë.

Mirëpo, është mirë që para së gjithash të bëhet një analizë dhe trajtim më adekuat i bizneseve vendore, të hiqen këto barriera, me të cilat po përballen bizneset vendore, e sidomos ato prodhuese.

Në këtë drejtim do të dëshiroja që përgjegjësit dhe dikasteret që merren me zhvillimin ekonomik të trajtojnë shumë seriozisht vështirësitë që ju shkakton KEDSI bizneseve prodhuese vendore.

Së pari, kjo kompani nga ajo që po shohim për çdo ditë largon punëtorët nga puna, nuk dihet sa ka investuar në rrjetin energjetik në bazë të kontratës së nënshkruar me Qeverinë e Kosovës dhe nuk ka arritur të ketë furnizim të rregullt me energji elektrike...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nuredin Ibishi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar përfaqësues diplomatikë,

Media dhe qytetarë,

Banorët e Orllanit, dikur qendër komunale me fshatrat përreth, e tash zonë e mbrojtur, janë të privuar nga e drejta elementare e shfrytëzimit të ujit të pijshëm. Nga akumulimi i liqenit të Batllavës dhe rrjedhat nga vjen ky ujë furnizohet gati gjysma e Kosovës, duke filluar nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, Podujeva, Obiliqi, Fushë-Kosova dhe vendbanimet e tjera.

Gjithashtu ky ujë shërben edhe për ftohjen e sistemit të termocentraleve A dhe B në Obiliq.

Imazhet televizive që i pamë para pak ditësh lidhur me cilësinë e këtij uji që shfrytëzohet nga banorët lokalë të Orllanit dhe fshatrave përreth ishin shqetësuese.

Këso reagime të këtyre banorëve kemi pasur në vazhdimësi, por mundësia e zgjedhjes së problemeve nga autoritetet kompetente ka hasur në heshtje. Ai ujë jo vetëm që nuk mund të

shfrytëzohet për pije, por nga analizat e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës është konstatuar si i kontaminuar dhe eventualisht mund të shërbejë vetëm si ujë teknik.

Ky kontaminim i puseve, nga të cilët nxirret ky ujë, vjen si pasojë e derdhjes direkte në liqe të ujërave të zeza dhe ndotjeve të tjera, si hedhja e mbeturinave nga personat e papërgjegjshëm dhe e vizitorëve të shumtë.

Kjo pakujdesi e banorëve lokalë shpesh vjen edhe si hakmarrje ndaj autoriteteve të papërgjegjshme, të cilët nuk po ndër marrin asnjë hap për ta zgjidhur këtë çështje jetike për ta si dhe për shfrytëzuesit e këtij uji, të cilët nuk kanë treguar aspak kujdes edhe qasje serioze për ta zgjidhur problemin.

Gjithashtu brengë e madhe është mungesa e sistemit të rrjetit të kanalizimit dhe ndotja e ambientit përreth dhe brenda liqenit.

Banorët i kanë njoftuar autoritetet kompetente lidhur me këto probleme, duke prezantuar shqetësimin dhe mungesën e ujit të pijshëm për banorët e këtij rajoni, të sistemit të kanalizimit dhe derdhjet e ujërave të zeza në liqe si dhe ndotjes së ambientit përreth, deri te afrimi i mundësive për zgjidhjen e problemit me projekte konkrete për ujësjellësin dhe kanalizimin me koston gjegjëse.

Ujësjellësi Rajonal “Batllava” ka ndihmuar në hartimin e projektit të detajuar me kosto totale prej një milion e 200 mijë eurosh.

Gjithashtu CEDF-i ka bërë projektin e detajuar për rrjetin e kanalizimit, ndërsa Instituti për Shëndetësi Publike ka kryer marrjen e mostrave, ku edhe këto analiza të ujit kanë rezultuar me nivel të lartë të kontaminimit bakterial dhe kimik.

Komuna e Podujevës ka zgjidhur çështjen e menaxhimit të mbeturinave, e lidhur me projektin e ujësjellësit i jemi drejtuar edhe Agjencisë Evropiane për Rindërtim në vitin 2006, por ky nuk është realizuar.

Ndërsa, lidhur me rrjetin e kanalizimit u jemi drejtuar Ujësjellësit Rajonal Batllava dhe autoriteteve lokale, por asnjëri nga ta nuk është përgjigjur.

Lidhur me çështjet e lartpërmendura, banorët dhe shoqëria civile nga kjo anë kanë kërkuar në vazhdimësi zgjidhje, por deri tani nuk kanë marrë ndonjë përgjigje.

Pas të gjitha këtyre përpjekjeve të shumta të banorëve lokalë e heshtjes nga autoritetet kompetente, situata mund të përshkallëzohet, duke pasur parasysh rrezikun që kanoset për shëndetin e këtyre banorëve dhe shfrytëzuesve të këtij uji.

Unë para dy vjetëve i jam drejtuar me pyetje parlamentare ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga i cili kam marrë përgjigje edhe me shkrim, duke përshkruar mundësitë e zgjidhjes së këtyre problemeve, por që deri më tani asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

Në Orllan me rrethinë është paraparë në fazën e pestë të investimeve të Qeverisë zvicerane dhe të Qeverisë së Kosovës të bëhet ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në impiantin për trajtimin e ujërave të zeza për këtë rajon dhe rreth Batllavës.

Shpresëdhënëse është zgjidhja e problemit të kanalizimit, siç e përshkrova më lart, por që ende mbetet i parealizuar uji i pijshëm për këta banorë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

Tema ime sot ka qenë preokupim i qytetarëve të Republikës së Kosovës, mirëpo ne nuk e kemi pritur një vendim të tillë nga Gjykata e Kolmarit me rastin Haradinaj.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës unë shpreh shqetësimin e thellë të Grupit Parlamentar të PDK-së për shtyrjen e vendimit për rastin Haradinaj nga Gjykata e Kolmarit në Francë.

Grupi Parlamentar i PDK-së kërkon po ashtu nga drejtësia dhe institucionet udhëheqëse të Francës si dhe nga i gjithë faktori ndërkombëtar relevant që të angazhohet për lirin e menjëhershëm të zotit Haradinaj.

PDK-ja po ashtu vlerëson se kjo është një padrejtësi e madhe, e cila po i bëhet jo vetëm zotit Haradinaj, por të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Do ta vazhdoj temën time që e kam paraparë sot në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

I nderuar zoti Haliti,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Vitet që kaluan, qytetarët e Kosovës mendoj se janë ballafaquar me shumë çështje, të cilat e kanë nxitur një debat jo rrallë të parë në vendin tonë, e të cilat do të mundohem sadopak t'i trajtoj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Kultura, sporti dhe fushat tjera të artit s'do mend se po bëjnë shumë në promovimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Madje, janë artistët e rinj ata, të cilët me talentin e tyre po sjellin shpresë dhe vlerësim të shtuar për institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo u dëshmuar edhe një herë me shpërblimin e filmit britaniko-kosovar "Home" nga Akademia britanike e Filmit dhe e Arteve Televizive "Bafta", ku regjisori i filmit u kujdes edhe një herë që para botës të shpallë komplet gjenocidin e kryer në Kosovë.

Po ashtu, këngëtarja Dua Lipa ka korrur suksese, duke u vlerësuar si artistja më e mirë në ndarjen e çmimeve në Londër për vitin 2017. Dy flamuj të Republikës së Kosovës janë ngritur përsëri në Kampionatin Botëror prej nga Majlinda dhe Distria ia sollën Kosovës medaljen e artë dhe atë të bronzit. Në kohën kur artistët kosovarë po shpalosin para botës krijimtarinë e tyre artistike dhe atë të Kosovës, ata po përballen me vështirësi të mëdha, sepse kufijtë e Kosovës vazhdojnë të jenë mure, jo vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe për njerëzit e artit, të kulturës dhe të sportit kosovar.

Para disa ditëve, ndonëse të ftuar zyrtarisht, dy përfaqësues të shoqërisë civile nuk kanë marrë vizë për të marrë pjesë në njërin prej festivaleve prestigjioze, i cili mbahet në një shtet të Bashkimit Evropian. Peng i lëvizjes së lirë kanë mbetur edhe shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët ne po i shohim çdo ditë në turma dhe në radhë para ambasadave të ndryshme të shteteve të Bashkimit Evropian. Në mesin e tyre, fatkeqësisht, ka edhe shumë qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët kërkojnë një vizë për të gjetur shërim në ndonjërin prej shteteve të Bashkimit Evropian. E përgjegjësinë për këtë e kemi në klasa politike të Republikës së Kosovës, ne që duhet që të hapim perspektivën e vendit dhe të hapim muret që po i mbajnë të mbyllur pa të drejtë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Sot në këtë foltore nuk do ta ndërpres fjalën time pa u ndalur edhe te një çështje shumë emocionale, e cila e ka lënduar shpirtin e atyre që e respektojnë mundin e burrave dhe të grave për lirinë e vendit. Ne ishim dëshmitarë të një momenti për mua dhe për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, jashtë mase iritues e ofendues, kur kolegët e mi deputetë na nënçmuan të gjithëve, duke nënçmuar himnin e shtetit të Kosovës, duke nëpërkëmbur vendin e mijëra nënave, të grave e burrave, të cilët dhanë krejt çka patën për të qenë të lirë.

Dy kolegët e mi deputetë, sikur harruan se po ata në këtë formë po e nëpërkëmbin atë që fëmijët tonë, që fëmijët e Kosovës e ndiejnë për republikë të tyre. Emocionet, tingujt dhe simbolet janë

pjesë e identitetit tonë. Ne të tjerët këtë emocion e ndiejmë dhe e shohim në sytë e fëmijëve tanë, në sot e përbotur të Majlinda Kelmendit, e lotët dhe të dridhurat e saj gjatë intonimit të po këtij himni na japin të drejtën e shpresës se ne tashmë jemi në rrugë e sipër për ta bërë këtë republikë ashtu siç e deshën ata, të cilët u përpoqën shumë për të, ata të cilët sot nuk janë në mesin tonë, ata të cilët u burgosën dhe u persekutuan me vite të tëra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Me këtë rast, edhe Lidhja Demokratike e Kosovës është tejet e shqetësuar me kalvarin dhe padrejtësinë që po bëhet ndaj zotit Ramush Haradinaj dhe Kosovës.

Andaj, me këtë rast kërkojmë nga drejtësia franceze drejtësi dhe vetëm drejtësi. Asgjë më shumë! Unë po vazhdoj me çështjen për të cilën dola këtu:

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua të ngre një çështje, saktësisht një rast tejet shqetësues për sigurinë dhe jetën e deputetëve dhe Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa së bashku me GIZ-in gjerman, më 23 shkurt, ka organizuar një punëtori në Shqipëri. Në këtë punëtori ka munguar deputetja e PDK-së Safete Hadërgjonaj dhe deputeti i “Nismës”, Enver Hoti. Ndërsa, GIZ-i gjerman ka udhëtuar me automjetin e vet, si dhe deputeti i PDK-së, AAK-së dhe VV-së kanë udhëtuar me automjetin privat. Me automjetin zyrtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës të tipit “Kombibus” kemi udhëtuar tre deputetë të LDK-së, deputeti i komunitetit turk, deputetja e Partisë së Drejtësisë dhe katër punëtorë të Administratës së Kuvendit të Kosovës.

Kthimi i ne pesë deputetëve dhe katër punëtorëve të Administratës ka qenë një dramë, e cila krejt rastësisht nuk u kthye në tragjedi. Pas dy orëve udhëtim në Rrugën e Kombit në kushte të mira atmosferike, eksplodon goma e pasme e automjetit zyrtar dhe ne shpëtuam krejt rastësisht. U ndalëm, e ndërruan gomën dhe u nisëm. Pas 10, 30 apo 40 minutave, pasi hymë në Kosovë, në autostradën “Ibrahim Rugova” eksplodon goma tjetër, e pasme. Ishin jo vetëm momente të vështira, sepse natyrisht ishte në pyetje jeta, por shqetësimi për mua mbetet pse ndodhi ky rast?

Andaj, e ftoj Prokurorinë e Shtetit që të merret me rastin, ta dimë nëse ishte atentat i përgatitur ndaj deputetëve dhe të tjerëve, apo ishte papërgjegjësi e Kuvendit të Republikës së Kosovës?

Cilado qoftë, është tejet shqetësuese loja me jetën tonë. Për këtë rast, unë, në emër të kolegëve dhe punëtorëve të Administratës, kërkoj që Prokuroria, Kuvendi dhe ministritë e linjës të merren seriozisht me rastin. Kërkojmë që përgjegjësit e kësaj ngjarje të japin llogari para drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar dhe ju qytetarë të nderuar,

Sot do të flas për dy çështje: e para është çështja për skemat pensionale. Familjarëve të dëshmorëve, disa prej tyre edhe i kam takuar, pra atyre, qoftë nënë, baba apo grua e dëshmorit, me një vendim të dalë nga Ligji për skemat pensionale u ndalohej që t'i marrin dy pensione. Unë konsideroj që nuk ka bazë ligjore për t'iu ndalë pensioni kategorive të dala nga lufta, ngase këtë pension e marrin për anëtarin e vrarë gjatë luftës dhe nuk mund të konsiderohet pension i dyfishtë. Nuk mund të konsiderohet pension i dyfishtë, sepse shumica e përfituesve janë kujdestarë të fëmijëve jetimë të kategorisë së dëshmorit të luftës, të viktimës së vrarë civile, apo të të zhdukurit të luftës.

Ne të gjithë e dimë një gjë, se nuk ekziston në këtë botë një fuqi që t'ua kthejë familjarëve njeriun e dashur, por ne duhet të jemi fuqia që familjet, të cilat nuk e kanë njeriun e tyre për shkak të rënies së tyre dëshmor, duhet t'ua mundësojmë të mos ndihen të fyer, të mos ndihen vetëm dhe menjëherë duhet vepruar që të ndryshohet Ligji për ndarjen e pensioneve.

Çështja tjetër, me Ligjin nr. 04/L-054, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-172 për statutin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjarëve të tyre si kategori të veçanta gëzojnë të drejta dhe beneficione të veçanta sipas nenit 6, paragrafi 2. Në mesin e beneficioneve të tjera, kjo kategori e ka të drejtën e lirimit nga tatimi dhe Dogana për vetura speciale për përdorim personal - një veturë në çdo pesë vjet, gjë që familjarët e dëshmorëve nuk e gëzojnë këtë të drejtë. Ndërsa, Kodi Doganor dhe i Akcizave, respektivisht neni 79, përcakton ndalesën e huazimit, tjetërsimit, dhënies në shfrytëzim të automjetit të liruuar nga obligimi doganor për personin e tretë, që do të thotë që këtë veturë nuk ka të drejtë ta ngasë askush, as anëtarët e ngushtë të familjes, e nëse vdes poseduesi i makinës, familjarët duhet ta paguajnë doganën e veturës.

Me këtë ligj janë diskriminuar edhe invalidët e luftës të UÇK-së, të cilët për shkak të plagëve të luftës nuk kanë mundësi ta kenë patentëshoferin, ngase janë pa gjymtyrë, dhe për invalidët e luftës, të cilët nga plagët janë verbuar. Pse të mos e ketë këtë të drejtë përcjellësi i tyre, të cilin ligji e lejon. Një ligj i tillë nuk është aspak afirmativ për këto kategori të luftës, por është tejet

diskriminues, ngase i cenon në substancë të drejtat e kësaj kategorie. Andaj, kërkoj që edhe ky Ligj nr. 02/L-2 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Më lejoni që, po ashtu, të shpreh solidarizim me zotin Haradinaj në këtë situatë tërësisht të pakuptimtë, pas vendimit të sotëm, njëjtë siç është i pakuptimtë edhe çdo negociim me shtetin e Serbisë përderisa nuk tërhiqen fletarrestet ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës që janë bërë gjatë kohës së Milosheviqit dhe këtu nuk po flas vetëm për luftëtarët e UÇK-së, por edhe për shumë qytetarë të tjerë, përfshirë aktivistë të LDK-së ndaj të cilëve ka fletarreste për veprimtarinë e tyre kundër regjimit të Milosheviqit.

Meqenëse po flitet shumë, megjithatë për temën e liberalizimit të vizave, përfshirë edhe sot, dhe meqenëse është një proces në të cilin kam qenë personalisht e angazhuar për vite me radhë, e ndiej për obligim të bëj disa sqarime dhe këto sqarime vijnë nga askush tjetër, pos nga ueb-faqja zyrtare e Ministrisë së Integritimit Evropian. Gjatë ditëve të kaluara, më mirë të them gjatë muajve të kaluar, qytetarët e Kosovës po dezinformohen vazhdimisht nga zyrtarë të ndryshëm se liberalizimi i vizave nënkupton të drejtën për t'u shkolluar, përfshirë edhe të drejtën për të punuar, lejon shërimin në ditë pa kufi, mund të lejojë shumëçka tjetër që për mua është asgjë tjetër, pos një thirrje për zbrazje të Kosovës dhe në kundërshtim të plotë me regjimin e vizave.

Prandaj, e ndiej për obligim që duke u bazuar në dokumentet që vetë Ministria e Integritimit Evropian i ka publikuar t'i bëj këto sqarime: Ky është dokumenti ku Ministria thotë që "liberalizim nënkupton regjim i lirë, që i lejon qytetarët e Kosovës të bëjnë vizita siç janë ato turistike, apo për qëllime familjare". Mund të shkojnë në ndonjë trajnim të shkurtër, apo kurs të shkurtër, mirëpo njëjtë sipas Ministrisë së Integritimit Evropian është gënjeshtër të thuhet që liberalizimi nënkupton të drejtën për të punuar, është gënjeshtër të thuhet që liberalizimi lejon të drejtën për të kërkuar azil, është gënjeshtër të thuhet që liberalizimi nënkupton të rrini në vendet Shengen mbi 90 ditë, qoftë edhe në qoftë se shkoni për t'u shëruar mbi 90 ditë, është gënjeshtër të thuhet që lejohet të studioni, sepse vetë në këtë dokument thuhet që nuk lejohet studimi, përderisa nuk merrni leje qëndrimi nga vendi ku shkoni.

Është tepër me rëndësi, sepse këto do të jenë shkelje për të cilat do të dënohen qytetarët e Kosovës në qoftë se ata vërtet në momentin që ndodh liberalizimi dalin dhe u besojnë këtyre fjalëve. Prandaj, është tepër e nevojshme që të bëhet një fushatë vetëdijesimi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Më lejoni që edhe unë të shpreh pakënaqësinë dhe brengosjen time për shtyrjen e vendimit për lirin e zotit Ramush Haradinaj, liderit të AAK-së, dhe duke përkrahur masat që ndërmarrin institucionet tona lidhur me këtë çështje do të kërkoja që të iniciohet një bashkëpunim në nivel multilateral me institucionet evropiane dhe institucionet euroatlantike që të bëhet çmos që këto akuza të pabaza të Serbisë të zhvlerësohen dhe Interpoli më mos të veprojë në bazë të tyre.

Tani unë desha të flas diçka lidhur me aktivitetet që po zhvillohen këto ditë lidhur me pakon fiskale 2, e që ndërlihet me pakon fiskale 1. Ne e kishim edhe një debat shumë përmbajtësor me ministrin në komision dhe konstatuam se këto masa janë në drejtimin e duhur për arsye se me pakon fiskale 1 kanë ngelur diku rreth 50 milionë euro të bizneseve për investime dhe kjo është ajo që duhet të thellohet edhe me pakon fiskale 2.

Ajo që është shumë me rëndësi me pakon fiskale 2 deri tani dhe që ne e përkrahim është që sa më shpejt të implementohen dhe aprovohen këto masa.

E dyta, gjithashtu është me rëndësi që të intensifikohen aktivitetet për dokumentet apo për legjislacionin sekondar që e implementon Ligjin për investime strategjike.

Jam i informuar se në Ministrinë e Industrisë ka filluar aktiviteti në këtë drejtim, por ky aktivitet duhet të përfundohet sipas afatit që kemi, diku tre muaj më duket, në mënyrë që të fillojë implementimi i këtij ligji, për arsye se ne e kemi një trend pozitiv të rritjes ekonomike. Tash për tash, e kemi stabilizuar rritjen ekonomike diku 4%, me gjasa të mëdha që brenda këtij viti të hyjmë në zonën e rritjeve 5% a më shumë, gjë që ka rëndësi jetike edhe për adresimin e problemeve shoqërore dhe ekonomike të Kosovës dhe për zgjidhjen dhe uljen edhe më të shpejtë të papunësisë dhe të përqindjes së popullsisë që jeton në kushte të varfërisë.

Në këtë drejtim, unë e ftoj edhe më tutje ministrin e Financave, që në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, siç ka vepruar këto ditë, t'i vazhdojë këto aktivitete, në mënyrë që të fuqizohen këta trendë pozitivë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përhëndetje kryeministër!

Ministra,

Kabinet qeveritar,

Përschëndetje kolegë të nderuar!

Për mua është i ndjeshëm rasti i Ramushit. Këto paralajmërime kanë qenë edhe më herët që do të ndodhë një shtyrje, e këto po ndodhin thuaja si raste politike. Jemi bërë në vazhdimësi “sui generis”.

Por “sui generis” e patëm edhe Gjykatën Speciale, “sui generis” jemi edhe kur i kemi krimet dhe trajtimin e tyre dhe të gjenocidit serb në Kosovë, “sui generis” jemi edhe në raportin e Dubravës, ku i kemi me emra e mbiemra të masakruarit, mbi 120 të burgosur, mbi 300 të plagosur. Prandaj, gjithherë jemi duke u trajtuar, duke u mbledhur brenda vetes, e asnjëherë duke e dhënë një iniciativë, një veprim a një gjë konkrete se çfarë të bëjmë dhe si të ecim më tutje.

Në vazhdimësi, shoqatat e luftës, familjet e dëshmorëve, martirëve, kanë kërkuar dhe kërkojnë në vazhdimësi që të trajtohet çështja e tyre, e viktimave, e vrasjeve, e torturave dhe e dhunës që ka bërë policia dhe ushtria serbe në Kosovë. Asnjëherë nuk janë trajtuar rastet e Krushës së Vogël, rastet e Krushës së Madhe, Celinës, Ratkocit apo të Drenicës, Deliajve, Prekazit, Reçakut e të gjitha.

Deri kur ne do të shkojmë në këso forme dhe të trajtojmë këso gjërash e të themi ‘jo sot, jo nesër’, jo ta lëmë në duart e dikujt, ose atij tjetrit. Fati i Kosovës, fati ynë, fati i këtyre familjeve është në duart tona, të njerëzve tanë, të drejtësisë dhe të udhëheqësve sonë.

Prandaj, kërkoj nga ju që me anë të këtyre viktimave që i kemi këtu dhe familjet që vazhdimisht janë duke bërë presion dhe sot i kemi edhe në Kuvendin e Kosovës, ku kanë ardhur të kërkojnë drejtësi për familjarët e tyre, ata po kërkojnë pikërisht që edhe trajtimi i Gjykatës Speciale të jetë pjesë e Kuvendit të Kosovës. Kërkojmë në vazhdimësi dhe kërkoj, e edhe atëherë kam kërkuar që Gjykata Speciale është një dëm që i bëhet Kosovës, një dëm që do t’i bëhet Kosovës, një trajtim i cili do të tentojë ta barazojë gjenocidin serb me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për liri, që individë të caktuar mund të kenë bërë ndonjë vrasje atje.

Prandaj, kërkoj nga kryeministri, meqë e kemi këtu, nga ju deputetë, nga ministrja që ishte këtu dhe shkoi, që të deklarohen edhe grupet parlamentare që ta rikthejmë Ligjin për Gjykatën Speciale në Kuvendin e Kosovës, ta trajtojmë edhe një herë dhe mundësisht t’i japim mundësi që ky Kuvend të deklarohet edhe një herë. Nuk i kemi rrethanat politike si para një viti, kur e kemi miratuar këtë projektligj. Rrethanat e sotme janë ato që Bashkimi Evropian ka ndryshuar politikisht. Në Bashkimin Evropian nuk është më Britania e Madhe. Nga Bashkimi Evropian kanë tentuar të dalin edhe Finlanda, po ashtu edhe Italia e ka pasur me referendum një kërkesë të tillë. Të gjitha shtetet po kërkojnë rikonfigurimin e Bashkimit Evropian, prandaj për ne dhe për mua është që ky Kuvend të deklarohet që ta futim në rend dite sot Ligjin për Gjykatën Speciale dhe ta trajtojmë edhe një herë dhe ta bëjmë abulimin e tij, sepse ai është pikërisht kundër interesave të Kosovës, kundër familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe viktimave.

Prandaj, kërkoj nga grupet parlamentare që të deklarohen për këtë çështje, që ta futim si pikë të rendit të ditës, sepse një kërkesë i ka ardhur presidentit, kryeministrit, kryetarit të Kuvendit, mua dhe të gjitha grupeve parlamentare. Prandaj, kërkoj edhe një herë që ta trajtojmë këtë çështje, ta futim në rend të ditës, i nderuar nënkryetar dhe kryeministër, pikën “Gjykata Speciale të trajtohet edhe një herë në Kuvendin e Kosovës”.

KRYESUESI: Faleminderit! Koha për deklarime jashtë rendit të ditës ka kaluar. Ndoshta Naiti ka menduar këtë ta futim tek rendi i ditës. Sidoqoftë, unë e kuptova si kërkesë për mocion dhe kur të vijmë te rendi i ditës mund të diskutojmë. Tani, fjalën e ka kërkuar zoti Enver Hoxhaj, që në emër të Qeverisë, të thotë diçka para deputetëve.

MINISTRI ENVER HOXHAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues, nënkryetar zoti Haliti!

I nderuar zoti kryeministër Mustafa,

Të nderuar kolegë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Vendimi i një gjykate në Francë për rastin e zotit Haradinaj është edhe zhgënjyes, edhe i papranueshëm. Unë sot pas vendimit që ka marrë gjykata, këtë qëndrim ia kam përcjellë edhe ambasadorit të Francës në Prishtinë, sikur kam kërkuar nga ai që këtë qëndrim t’ia përcjellë homologut tim në Paris, meqë ne kemi pritur që zoti Haradinaj do të kthehet në Kosovë dhe nuk ka asnjë arsye që të qëndrojë më tutje në Francë dhe të shtyhet prej javës në javë mbajtja e tij atje.

Po dua edhe një herë ta ritheksoj se ky vendim është edhe zhgënjyes, edhe i papranueshëm për ne si shtet dhe për Qeverinë e Kosovës.

Po ashtu, dua të ju informoj se do ta kemi një takim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e Brendshme që ta bëjmë një rivlerësim të të gjithë procesit dhe se si t’i qasemi këtij procesi. Unë kam biseduar me telefon edhe me zotin Haradinaj pas vendimit që ka marrë gjykata në Francë dhe jemi në koordinim me vetë zotin Haradinaj, por edhe brendapërbrenda Qeverisë, se si t’i qasemi një çështjeje të tillë.

Dua po ashtu të them që si Ministri e Punëve të Jashtme, edhe Ambasada jonë në Paris do të ofrojë përsëri garanci shtetërore për akuza, të cilat janë qesharake dhe të papranueshme, që ka ngrehur Serbia në rastin e zotit Haradinaj, sikur që dua ta ftoj këtë Kuvend, dua ta ftoj çdo parti politike, që raportet tona me Francën të shihen si raporte ndërmjet vendeve mike, që ta njohim rolin e Francës në shtetformimin dhe shtetbërjen e Kosovës, që këto raporte të mos lëndohen.

Natyrisht që ndalimi i zotit Haradinaj në Francë dhe ballafaqimi i tij me një proces atje është vazhdimësi e një politike të cilën e ka ndjekur Serbia në raport me Kosovën. Politikën që e ka

ndjekur Serbia në raport me Kosovën për një shekull ka qenë dhunë e planifikuar, dhunë e menduar dhe dhunë e ushtruar brendapërbrenda territorit të Kosovës, që ka kulmuar me spastrime etnike dhe me gjenocid. Agresionin që e ka bërë ndaj një vendi, sot po e shndërron në një agresion ndërkombëtar, duke ndjekur qytetarët dhe liderët e Kosovës.

Kështu që kjo fushatë e Serbisë dhe keqpërdorimi i Interpolit nga ajo, për ne është po ashtu i papranueshëm.

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Ne do të bëjmë përpjekje që ta bëjmë të pamundurën që t'i ndihmojmë zotit Haradinaj edhe më tutje, por vendimi i sotëm është zhgënjyes dhe për ne është i papranueshëm dhe secili prej nesh do të duhej ta kuptojë në mënyrën e njëjtë dhe në mënyrën e drejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, po kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Po kalojmë menjëherë. Deputetja Blerta, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Pyetja ime është bërë disa herë, mirëpo kryeministri nuk ka qenë këtu, e ka të bëjë me çështjen e dialogut. Besoj që rastet e fundit kanë qenë raste bukur të rënda në qasjen tonë që do ta kemi ndaj shteti serb, por po ashtu pyetjen që do ta parashtroj lidhet konkretisht me fazën e re të dialogut, se si do të përfshihet dhe cilat do të jenë kompetencat tuaja si kryeministër?

Në diskutimet e shumta që i kemi pasur në Komisionin për Politikë të Jashtme dhe me ministren për Dialog, zonjën Tahiri, na është thënë që do të ketë një fazë të re të dialogut. Mbase nuk është temë për sot, mirëpo është bartur disa herë për shkak të mungesës suaj në seancë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Mustafa, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar deputete Deliu-Kodra,

Unë do të bëj përpjekje që të përgjigjem në pyetjen që e keni shtruar. Është një pyetje që na preokupon mjaft shumë. Para kësaj vetëm dëshiroj që të mos e shfrytëzoj përgjigjen në pyetjen tuaj, por ajo që e tha ministri i Punëve të Jashtme në rastin Haradinaj i përfaqëson qëndrimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ne sot e kemi dhënë një qëndrim tonin dhe e konsiderojmë krejtësisht të papranueshme mbajtjen e Zotit Haradinaj dhe moskthimin e tij në Kosovë. Prandaj, presim nga institucionet e Francës që të mundësojnë që ai sa më shpejt të kthehet në Kosovë. Ndërkaq, para gjykatave të tilla duhet të përgjigjen ata që kanë bërë krime në Kosovë.

Sa i përket dialogut në Bruksel, është një dialog që ka filluar më herët, i cili i ka kapërcyer disa faza, janë arritur disa marrëveshje, të cilat i kemi vlerësuar edhe më parë se kanë dhënë rezultate të caktuara. Por, janë po ashtu edhe tema të cilat ne mendojmë se duhet t'i përfundojmë atje dhe se konsiderojmë që procesi i dialogut në Bruksel duhet të përmbyllet me njohjen e ndërsjellë të dy shteteve, me demarkacionin e kufirit ndërkombëtar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me respektimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet dy shteteve, përkatësisht me respektimin e sovranitetit të njëres dhe tjetrës, me reparacionet e luftës dhe me suksesionin, përkatësisht ndarjen e pasurisë mbi parimin e zhbërjes së ish-Jugosllavisë, në të cilën Kosova ishte njëra ndër tetë njësitë federale.

Në kuadër të reparacionit ne e kemi shtruar edhe më parë si evidente çështjen e të pagjeturve, kur ne do të kërkojmë garanci nga Bashkimi Evropian, në mënyrë që Serbia të japë informacione të sakta për vendndodhjen e personave akoma të pagjetur dhe lokacionin e varrezave masive në Serbi. Do të kërkojmë po ashtu edhe hapjen e arkivave të ish-ushtresë jugosllave, që tash janë në Serbi, e të cilat tani po na pengojnë që të bëhen gërmime, po nuk po gjenden të mbetura mortore të njerëzve që pritet të identifikohen. Do të hapet çështja e Fondit Pensional dhe Invalidor të qytetarëve të Kosovës dhe kthimi i depozitave bankare, do të shtrohet çështja e dëmshpërblimit për dëmet e luftës, për vrasjet, humbjet e njerëzve, dëmshpërblimet për trashëgiminë kulturore dhe fetare, për humbjen e pagave të personave të përjashtuar nga puna dhe dëmshpërblimet për pasojat, ose dëme të drejtpërdrejta fizike në prona private dhe publike, atëherë shoqërore, që janë si pasojë e veprimeve të Serbisë.

Tani si do të jetë formati i dialogut, këtë çështje do ta trajtojmë së bashku me presidentin e vendit, me kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky format, natyrisht, gjithmonë bëhet në relacion me formatin që e ka edhe Serbia. Pjesa dërmuese e çështjeve që dialogohen atje janë çështje qeveritare, por varësisht nga nivelet, të cilat përcaktohen në Bruksel, do të përcaktohen edhe në Kosovë dhe ne do të bëjmë përpjekje që në të ardhmen dialogu të jetë sa më transparent karshi kërkesave që janë shtruar para nesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Deliu?

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Mustafa!

Konkretisht për çështjen e të pagjeturve, Kosova është njëra prej sfidave që i kanë institucionet e vendit, do të thotë ne për çdo përvjetor, për çdo Ditë ndërkombëtare të të pagjeturve po ballafaqohemi me qasje të njëjtë, ndërkohë që Fondi për të Drejtën Humanitare në Serbi ka publikuar së fundi një raport, për të cilin do të kisha kërkuar një përgjigje nga ana jua lidhur me fshehjen e krimeve të zyrtarëve serbë, pra e kam fjalën për krimet e luftës në Kosovë, dhe çfarë kanë bërë institucionet tona?

Përderisa ne kemi krijuar një Gjykatë Speciale, shteti serb po i fsheh krimet e zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme të asaj kohe, të cilët kanë qenë direkt të përfshirë në krime të kryera gjatë luftës në Kosovë.

Pra, çfarë keni bërë ju si kryeministër në këtë drejtim? Kisha pasur dëshirë të kemi një përgjigje tuajën lidhur me gjetjet e fundit të Fondit për të Drejtën Humanitare në Serbi.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Është në rrjedhën e pyetjes, e cila u shtrua. Unë mund t'ju them se çështja e të pagjeturve në Bruksel është hapur, ashtu siç jam informuar edhe unë, sepse atëherë nuk kam qenë në këto procese, qysh në takimet e para në vitin 2011.

Do të thotë, si çështje e kemi hapur në vazhdimësi në Bruksel, në mënyrë që të bëhet presion në Serbi që të jepen dokumentacione të sakta dhe të identifikohen vendet ku ende s'po gjenden personat që kërkohen. I kemi 1.660 të pagjetur. Këtë çështje do ta shtrojmë edhe më tutje dhe do të kërkojmë që të bëhet presion nga Brukseli në Serbi.

Ajo çfarë prej komisioneve tona kërkohet me urgjencë është që të mundësohet hapja e arkivave të ushtrisë jugosllave, sepse nëse hapen këto arkiva, atëherë do të mundësohet të kemi qasje, përkatësisht edhe ne, edhe bashkësia ndërkombëtare, në vendet ku dyshohet se gjenden mbetjet mortore të njerëzve tanë.

Do t'i shfrytëzojmë edhe të dhënat e fundit të Fondit, por deri këtu kemi mbërritur. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Blerta Deliu-Kodra ka pyetje për ministren Edita Tahiri.

BLERTA DELIU-KODRA: Zoti Hamiti, është pak e pakuptimtë, sepse kështu si po shtrohen pyetjet, ne po e humbim edhe aktualitetin e temës për të cilat janë bërë. Prandaj unë po e shtroj sot pyetjen, për ata që donë ta dëgjojnë, e po ashtu edhe ministria Tahiri do ta dëgjojë dhe do të kemi një përgjigje prej saj.

Pyetja lidhet konkretisht me raportimet e saja të fundit, ku temë e diskutimit natyrisht se ka qenë edhe çështja e të pagjeturave, siç çështje e ndjeshme dhe vazhdon të mbetet plagë e hapur e luftës së fundit në Kosovë.

Ajo ka diskutuar shumë rreth kësaj teme, e cila do të jetë pjesë e dialogut në të ardhmen, që e përmendi edhe sot zoti Mustafa.

Kjo temë, thuhet shpesh, do të diskutohet në Bruksel dhe duhet të ketë edhe pajtueshmërinë e të dy palëve.

Unë e kisha një pyetje lidhur me qëndrimin e palës serbe për trajtimin e kësaj çështjeje në Bruksel?

Cilat janë obligimet e palës kosovare?

A i ka delegacioni kosovar të gjitha informatat, përfshirë edhe listën e të pagjeturve, lokacionet lidhur me këtë çështje shumë të ndjeshme që vazhdon të preokupojë secilin qytetar të Republikës së Kosovës dhe çfarë duhet të presin qytetarët e Kosovës se do të arrihet konkretisht nga një marrëveshje e tillë?

Po e them këtë, sepse ne muajve që do të vijnë do t'i kemi përvjetorët e shumtë dhe është fatkeqësi që çdo vit po përballemi me një numër të njëjtë të të pagjeturve. Nuk ka ende asnjë lajm e asnjë informatë, përkundër vullnetit që e ka treguar pala kosovare, pra ka një barrikadim të shtuar të palës serbe për t'u kthyer të pagjeturit në shtetin e Kosovës.

Shpresoj se ministrja do ta marrë këtë pyetje dhe do të përgjigjet në njërin prej seancave që do t'i kemi këtu.

KRYESUESI: Deputetja Shqipe Pantina ka pyetje për kryeministrin. Deputetja s'është këtu.

Prapë, Shqipe Pantina ka pyetje për ministrin Zharku, nuk është deputetja.

Deputetja Shukrije Bytyqi ka pyetje për ministrin Arsim Bajrami, nuk është këtu.

Deputeti Bislim Zogaj ka pyetje për ministrin Arban Abrashi.

BISLIM ZOGAJ: Unë edhe herën e kaluar këtë pyetje ia pata bërë kryeministrit, por u përgjigj ministri Abrashi, prandaj pasi s'është ministri Abrashi, po i drejtohem kryeministrit.

Zoti kryeministër, në nëntor të vitit të kaluar, kur e pata bërë pyetjen për pensionet e familjeve të dëshmorëve, të cilëve u është i njohur statusi, jeni deklaruar se deri në fund të dhjetorit do të përfundojnë procedurat dhe to t'i kemi listat dhe pastaj do të futen në proces të pagesës.

Tani jemi në mars dhe ende nuk ka lëvizur asgjë në këtë drejtim, siç nuk ka lëvizur asgjë në drejtim të formimit të komisionit për caktimin e shkallës së invaliditetit të atyre veteranëve që u është njohur statusi i invalidit.

Prandaj, zoti kryeministër, ku është problemi që po zvarriten këto procedura dhe po dëmtohen këto kategori të luftës?

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit!

Unë mund të them se nuk ka zvarritje të procedurave. Sa i përket shkallës së invaliditetit, ajo që unë jam i informuar është se po punohet në formimin e komisionit dhe po ashtu është duke u punuar me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar për harmonizimin e vlerësimit lidhur me shkallën e invaliditetit, sepse ka vërejtje të Fondit Monetar Ndërkombëtar që janë dallimet shumë të mëdha ndërmjet asaj se çfarë për personat e tjerë konsiderohet shkallë e invaliditetit dhe çfarë konsiderohet në këtë rast për invalidët e luftës, në mënyrë që të mos kemi problem pastaj me FMN-në sa i përket aplikimit të këtyre kriterëve.

E kemi biseduar nja 3-4 herë me përfaqësuesit e Fondit Monetar dhe jemi pajtuar që edhe atë çështje ta zgjidhim në mënyrë që të mos ketë probleme me invalidët. Kanë qenë edhe përfaqësuesit e veteranëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së dhe unë shpresoj se kjo do të bëhet.

Do të thotë, është një çështje në proces.

Dhe, sa i përket çështjes së veteranëve, komisioni e ka përfunduar punën. E ka përfunduar punën edhe personeli administrativ, i cili i ka shërbyer këtij komisioni.

Ne jemi marrë vesh në mbledhjen e djeshme të Qeverisë që të mundësojmë angazhim edhe për dy-tre muaj të personelit administrativ, në mënyrë që të përkrahë komisionin për të lëshuar vërtetimet që i kërkojnë veteranët, për ata që kanë mbetur pa vërtetime dhe ta mbyllim këtë proces.

Informata të tjera nuk kam. Pra, këto janë ato në të cilat edhe unë kam qenë i kyçur si kryeministër, ndërkaq pjesën operative e bën Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zogaj e ka fjalën.

BISLIM ZOGAJ: Më fal, kryeministër!

Nga mbledhja e kaluar që e patët në Qeveri, ministri u deklarua se tani dy punëtorë do t'i caktojmë për t'i lëshuar vërtetimet për veteranë.

Pyetja ime më konkrete ka qenë, për familjet e dëshmorëve, të cilave u është pranuar statusi gati që një vit dhe certifikatat i kanë marrë, por për një vërtetim apo për një burokraci që për mendimin tim është shumë e paarsyeshme, sepse kur janë në pyetje familjet e dëshmorëve pensionet i marrin vetëm prindërit apo edhe bashkëshortja, kurse fëmijët që janë mbi 18 vjet, në qoftë se nuk janë duke u shkolluar, nuk u takon.

Prandaj, kur dihet se që një vit u është pranuar statusi, përse nuk u jepen pensionet këtyre familjeve të dëshmorëve?

Mendoj se ose është duke u pritur që të vdesin ata prindër dhe të rezervohet buxheti, apo për çfarë është fjala?

Pra, edhe një herë kërkuj dhe ju lutem që sa më parë të fillojë dhënia e pensioneve familjeve të dëshmorëve, të cilave u është pranuar statusi.

KRYESUESI: Faleminderit! Shkojmë tutje. Deputeti Hajdar Beqa, pyetje për ministrin Hyseni.

Ministri nuk është këtu. Zoti deputet, a doni të lexoni pyetjen?

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Është hera e tretë që përsëritet pyetja, nuk ka qenë ministri, e tash do ta lexoj pyetjen, me arsye se për këtë çështje do të marrë hapa konkretë Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht ministri.

Në seancën e mbajtur më 4 gusht 2016 e kam ngritur çështjen lidhur me statusin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Kam kërkuar të rregullohet statusi i qëndrimit të tyre, lehtësimi i procedurave të fitimit të shtetësisë së Kosovës, për arsye se qëndrojnë në Republikën e Kosovës nga viti 1999, si pasojë e gjendjes ekonomike dhe presionit intensiv policor e ushtarak që u bëhet atje nga policia serbe, të cilat de fakto edhe i plotësojnë kushtet e shtetësisë, sepse jetojnë nga viti 1999 apo, mund të them, që 17 vjet në Kosovë, dhe nuk kanë shtetësi.

Kam propozuar që në nenin 5 dhe nenet 31 e 32 të Ligjit nr. 04/L-215 për shtetësi të Kosovës të parashihet forma e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës për këta qytetarë nga Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit.

Pyetja ime për zotin ministër ishte lidhur me çështjen e ngritur si më lart. Pra, a është marrë ndonjë veprim për të rregulluar statusin e këtyre qytetarëve, të cilët ballafaqohen çdo ditë me probleme të ndryshme për zhvillimin e një jete normale për t'i realizuar të drejtat e tyre elementare, si pasojë e mungesës së statusit të tyre.

Unë edhe një herë kërkoj këtu që Ministria e Punëve të Brendshme të shikojë ligjin në fjalë dhe ta bëjë plotësim-ndryshimin, me qëllim që t'u lehtësohet këtyre qytetarëve fitimi i shtetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Salihe Mustafa ka pyetje për ministrin Abrashi. Ministrin s'po e shoh këtu. Deputete, a doni të lexoni pyetjen?

SALIHE MUSTAFA: Edhe pse pyetja ime është për ministrin Abrashi, unë do ta lexoj pyetjen, duke pasur parasysh faktin se ministri i Financave është këtu dhe mund të më japë përgjigje.

Zoti ministër, duke iu falënderuar kërkesës së adresuar nga organizata "Hendikos" më 14. 11. 2016 Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione rreth shqetësimit të tyre për Ligjin për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në muajin dhjetor ministri Abrashi pati premtuar fillimin e zbatimit të këtij ligji në janar të këtij viti.

Zoti ministër, në buxhetin e vitit 2017 nuk është përfshirë Ligji 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, d.m.th. mjetet e nevojshme financiare për të filluar zbatimin e këtij ligji.

Andaj, i nderuar ministër, kërkoj nga ju të na jepni përgjigjen se kur do të fillojë zbatimi i këtij ligji?

Dhe, meqenëse ministri Abrashi nuk është këtu, nëse do, ministri i Financave mund të na përgjigjet: A i ka lejuar mjetet e nevojshme të ministrisë adekuate për zbatimin e këtij ligji?

KRYESUESI: Faleminderit! A doni të përgjigjeni?

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

E nderuar deputete, gjatë rishikimit të buxhetit jemi kujdesur që të bëhet një program i veçantë në përputhje me kërkesat që dalin nga ky ligj. Është ndarë një buxhet që diku mbulon 2/3 e nevojave për këtë vit dhe do të kujdesemi pastaj me rishikim të buxhetit që ta përmbyllim krejt vitin në përputhje me kërkesat që derivojnë nga ky ligj. Pra, besojmë në seancën e ardhshme mund të japim informata detale së bashku me ministrin Abrashi.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Salihu, edhe një herë!

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit për përgjigjen, zoti ministër, edhe pse s'ishte e drejtuar për ju.

Besoj se do të bëni të mundshme, edhe pse s'mora përgjigje konkrete, se kur do të fillojë, sepse këta persona, sipas informatave, e dinë që në muajin prill do të fillojë zbatimi i këtij ligji, fatmirësisht numri i tyre nuk është i madh dhe besoj që do të siguroni mjete.

Unë do ta përsëris pyetjen për ministrin Abrashi, në mënyrë që të përgjigjet kur do të fillojë saktësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Faton Topalli ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, deputeti Topalli nuk është këtu. Deputeti Faton Topalli ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, nuk është deputeti.

Deputeti Enver Hoti ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, nuk është deputeti.

Deputetja Shukrije Bytyqi ka pyetje për ministrin Kujtim Shala, nuk është deputetja.

Time Kadrijaj ka pyetje për ministrin Imet Rrahmani, nuk është deputetja.

Prapë Time Kadrijaj ka pyetje për ministrin Abrashi, nuk është deputetja.

Lahi Ibrahimaj ka pyetje për ministrin Lutfi Zharku, nuk është deputeti.

Ali Berisha ka pyetje për ministrin Imet Rrahmani, nuk është deputeti.

Salih Salihu ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, nuk është.

Ismajl Kurteshi ka pyetje për ministren Hykmete Bajrami, nuk është deputeti.

Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafën, nuk është deputeti.

Deputetja Puhije Demaku, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, nuk është as deputetja, as ministri.

Prapë Puhije Demaku, pyetje për ministrin Hoxhaj, edhe një herë nuk është deputetja.

Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa, nuk është deputetja Haxhiu.

Prapë deputetja Haxhiu, pyetje për ministren Dhurata Hoxha, nuk është deputetja, as ministrja.

Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani, nuk është deputetja.

Deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Blerand Stavileci, nuk është as ministri, as deputeti. Tash e kemi një situatë interesante, kur nuk janë ministrat, deputetët janë të gjithë, sot që janë ministrat, mungojnë deputetët.

Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

I thërrasim deputetët të hyjnë në seancë. Ju informoj se 69 deputetë të shumicës, si quhet mazhorancë e Kuvendit të Kosovës, 69 e kanë nënshkruar praninë këtu në fillim. I thërras të vijnë në seancë.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Ok! Kemi kuorum për votim. Atëherë, e kemi miratimin e pikës së tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Për arsye se seanca e mëparshme plenare nuk i ka përfunduar të gjitha pikat e miratimit të procesverbalit nga seanca e mëparshme, është shtyrë për seancën e radhës. A ka dikush ndonjë vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka.

Kemi kërkesa për mocion. Zoti Osmani e ka kërkuar fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë po e shoh që sot do të ishte e pamundur të sigurojmë 80 vota për aprovimin e ratifikimeve të marrëveshjeve, por unë në emër të komisionit jam i obliguar të bëj kërkesë, sepse Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 28. 2. 2017 ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare financiare dhe i ka propozuar Kuvendit që në pajtim me nenin 42.2 të bëjë plotësimin e rendit të ditës së seancës plenare të datës 2 mars 2017, dhe në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit të votojë për shmangie nga afatet procedurale të parapara në nenin 56, paragrafi 1 për shqyrtimin e projektligjeve si në vijim:

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-152 për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga ministri i Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave,

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-153 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunime financiare,

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-154 për ratifikimin e protokollit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të marrëveshjes për hua për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS,

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-155 për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për FSDK, linja e dytë kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Prandaj, unë propozoj që të ketë shmangie që këto të radhiten si të parat në rend të ditës. Po ashtu, kërkoj që në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa të renditet edhe në leximin e dytë votimi për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Bankën Qendrore, meqenëse kemi një marrëveshje me Fondin Monetar Ndërkombëtar që kjo të kalojë në procedurë për shkak të arritjes së afateve për nënshkrimin e pjesës tjetër të prezencës së tyre dhe mbështetjes së tyre direkte, prandaj Komisioni për Buxhet dhe Financa kërkon që edhe plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për bankën të futet po në këtë seancë, njëherësh që komisionet e përhershme të mbajnë mbledhjet e tyre që të bëjnë raporte në kuptimin e asaj që të jetë proceduralisht i rregullt për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë kërkoj deklaratimet e grupeve parlamentare sa i përket kësaj çështjeje në përgjithësi, ndërsa votimin e bëjmë një nga një, për pesë pikat e propozuara nga kryetari i komisionit, zoti Osmani.

Ok! Ta procedojmë këtë mocionin e Naserit, pastaj kalojmë në të tjerat. Është e qartë që 80 vota nuk i kemi për të hyrë në votim, por po e fusim në rend dite, pastaj kur të bëhen votat, kur të merremi vesh me opozitën që të jenë 80 vota, për shkak të rëndësisë së çështjes ne do t'i procedojmë prapë bashkërisht.

Atëherë, fjalën e ka kërkuar zonja Halimi, në emër të komisionit.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Në pajtim me nenin 42.2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Legjislacion, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit paraqet amendament për plotësim të rendit të ditës, si në vijim:

- Të plotësohet rendi i ditës i mbledhjes plenare të Kuvendit, më 2 mars 2017, me pikën e re: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, si pikë e fundit e rendit të ditës.

Ne si komision sot përfunduar amendamentet dhe derisa të vijë radha në fund të seancës kërkoj nga komisionet e tjera të përhershme që të gjejnë kohë dhe të shqyrtojnë raportin me rekomandime, kështu që në fund të pikave të rendit të ditës të futet si pikë dhe si material i kompletuar të votohet në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani po e shqyrtojmë mocionin e zotit Osmani në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Grupet parlamentare e kanë radhën, grupet të deklarohen për të gjitha pikat që i ka nxjerrë zoti Osmani, pastaj votojmë pikë për pikë për t'i futur në rend të ditës. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kush e do fjalën? Për mocionin e zotit Osmani. Jo, pastaj. Ta kryejmë njëherë këtë të zotit Osmani, pastaj paraqitesh ti, nëse s'e ke për ngutë.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kush e dëshiron fjalën lidhur me këtë? Zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Ne e mbështesim nocionin. Le të procedohet më tutje, pastaj të gjendet momenti për këto pika, kur kërkohen 2/3-at, po le të futet në procedurë, le të vazhdohet!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i mbështet të dy propozimet. Domethënë, propozimin e Komisionit për Buxhet e Financa dhe Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "6+", zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar "6+" e përkrah propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Legjislacion.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që duan të flasin në emër të grupeve parlamentare. Atëherë, sa vota janë në sallë, regjia?

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, ju lutem t'i bini ziles që të futen deputetët në sallë. Unë nuk e di pse bëhen lëvizje, një herë ishin 67, tash mbetën 59.

Konsideroj se kemi kuorum, janë 63 deputetë. Ju lus që t'i zini vendet tuaja. Atëherë, po hyjmë në votim. Sqarime procedurale sa i përket vendimmarrjes për juve. Për miratimin e propozimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa kërkohet shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe neni 15, paragrafi 7 i Rregullores së Kuvendit.

Neni 84 i Rregullores së Kuvendit thotë: "Për t'iu shmangur Rregullores së Kuvendit vendosin 2/3-at e deputetëve të pranishëm në seancë". Ne i kemi 63 deputetë në seancë.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës, që është:

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave

Po, e dini tani si do të funksionojë, ju lus të votoni! Votojmë tash!

A ka pa kartelë? 3 janë pa kartelë. Atëherë, 59 vota me kartelë, 3 pa kartelë, bëjnë 62 vota.

Konsideroj që Kuvendi e miratoi propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës dhe për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës së Austrisë, përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

Shqyrtimin e këtij projektligji e radhisim sipas radhës që e kemi në rend të ditës.

Tani votojmë për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim

financiar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, ashtu siç i lus që të mos e lëshojnë sallën! Në sallë janë 63 deputetë. Votojmë tani!

Pa kartelë janë dy. 60 veta kanë votuar me kartelë, 2 pa kartelë. Konsideroj që miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar.

Radhitja e projektligjit bëhet sipas radhës në rendin e ditës.

Tani votojmë për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e protokollit financiar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të marrëveshjes për hua për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Ju lutem, votoni, që të mos ketë nevojë të përsëritet. Faleminderit!

61 veta kanë votuar me kartelë, 2 janë pa kartelë. 63 vota janë për. Miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e protokollit financiar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të marrëveshjes për hua, për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS.

Shqyrtimi i këtij projektligji radhitet sipas renditjes në rend të ditës.

Tani votojmë për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për FSDK-në, linja e dytë kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Në sallë kemi 65 deputetë, me kartelë kanë votuar 61 deputetë. Të gjithë kanë votuar për. Janë plus 2 pa kartelë, që do të thotë se kanë votuar 63 për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Prandaj, konstatoj se miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet e Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për FSDK-në, linja e dytë kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Shqyrtimi i këtij projektligji radhitet si pikë e veçantë e rendit të ditës, sipas renditjes së rendit të sotëm të ditës.

Tani votojmë për propozimin e Komisionit për Buxhet e Financa për plotësimin e rendit të ditës, që është: Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Regjia dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tani!

65 deputetë janë prezentë në sallë. Kanë votuar 62 deputetë me kartelë, 2 pa kartelë, pra 64 deputetë. Kundër dhe abstenim nuk ka.

Konstatohet se miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Shqyrtimi i këtij projektligji radhitet si pikë e veçantë e rendit të ditës.

Tani kemi mocionin që e lexoi më herët zonja Halimi, në emër të komisionit.

Në vazhdim deklarimi me votim i miratimit të propozimit të Komisionit për Legjislacion për plotësimin e rendit të ditës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Lus deputetët të votojnë!

Kanë votuar 58 deputetë, 3 pa kartelë, që bëjnë 61 deputetë dhe është e mjaftueshme, sepse të gjithë janë për. Sipas Rregullores, miratohet propozimi i Komisionit për Legjislacion për plotësimin e rendit të ditës dhe për shmangien nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Shqyrtimi i këtij projektligji radhitet si pikë e veçantë e rendit të ditës.

E kemi edhe mocionin e kërkuar nga zoti Hasani. Zoti Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!
Përshëndetje kryeministër,

Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Edhe më herët e thashë në foltore, e përsëris se për ne me rëndësi është që si çështje që ka ardhur nga familjet e dëshmorëve, invalidët, viktimat e luftës për një kërkesë për Kuvendin e Kosovës, që është dërguar edhe te unë, dhe është protokolluar më 8. 2. 2017.

Është protokolluar po ashtu edhe më 1. 3. 2017 në kabinetin qeveritar si kërkesë e tyre, por edhe imja personalisht, që Kuvendi i Kosovës ta rishqyrtojë edhe një herë Projektligjin për Gjykatën Speciale, për shkak se të gjitha rrethanat kanë ndryshuar në raportin evropian, në Bashkimin Evropian dhe kjo kërkesë do të mundësojë që të paktën, të gjithë ata që mund të akuzohen, të jenë pjesë e Kosovës, pjesë e gjykatave tona, pjesë e legjislativit tonë.

Prandaj, po kërkoj që në rend të ditës, për krimet dhe gjenocidin që e ka bërë Serbia dhe pikërisht ata të gjykohen e të akuzohen.

Jaku i kemi familjet që nuk i dinë se ku i kanë eshtrat e viktimave të tyre. Prandaj, po kërkoj që në rend dite të futet si pikë: Shqyrtimi i Projektligjit ose Ligjit për Gjykatën Speciale dhe kërkoj nga grupet parlamentare të deklarohen për këtë mocion.

KRYESUESI: Atëherë, më duhet ta nxjerr në diskutim. Fjalën e kanë grupet parlamentare, së pari Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Kjo është njëra nga çështjet më të ndjeshme dhe që ka zgjuar debate, ndoshta më serioze në këtë Parlament për mandatin që jemi.

Mendoj po ashtu se edhe rrethanat janë pak më ndryshe, por për t'u deklaruar si Grup Parlamentar për këtë çështje mendoj se duhet të jenë të gjithë në këtë sallë të Parlamentit, edhe opozita. Duhet të rezervoj deklarinimin e grupit parlamentar për këtë çështje, të krijohen rrethanat që të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët të jenë në sallë.

Meqenëse e mora fjalën, e shfrytëzoj këtë rast, për çka u dakorduam edhe me zotin Beqiri që sot pas një abstenimi të opozitës dhe pas rrethanave të krijuara me rastin Haradinaj, të ndërpresim këtë seancë dhe të vazhdojmë në një moment tjetër, kur do të jenë të gjithë për të mundur të debatojmë dhe të shprehim qëndrimin edhe për mocionin që e shtroi zoti Hasani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismet Beqiri në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Unë pikërisht për këtë pjesën e dytë që e tha zoti Pajaziti e kërkoja fjalën edhe më herët dhe sidoqoftë është OK edhe tash. Përkundër faktit se ne kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë punën, ne u dakorduam që në shenjë solidarizimi dhe për shkak të rrethanave të krijuara sot ta ndërpresim punën e Kuvendit dhe të vazhdojmë një tjetër ditë.

Ndërkaq, për çështjen që e shtroi ai, sigurisht se unë as nuk bëj deklaratë në emër të grupit, sepse kjo është një kërkesë e një deputeti për një çështje që nuk mund të bëhen deklaratime as të grupeve në mënyrën apo formën se si shtrohen kërkesat e tilla. Faleminderit!

(Ndërhyrje - reagim)

KRYESUESI: Zoti Damka, nuk dëshiron. E kemi një situatë që të dy kryetarët e grupeve parlamentare kanë kërkuar të ndërpresim seancën sot dhe në qoftë se doni ta votoni mocionin, unë e nxjerr në votim.

Atëherë, e qesim në votim mocionin e zotit Hasani, edhe përkundër kërkesës... A po doni ta shtyjmë mbledhjen për më vonë?

Atëherë, të dy grupet parlamentare kërkojnë të shtyhet votimi deri kur të jenë të gjithë deputetët në seancë.

Pra, me kërkesën e dy grupeve të mëdha politike, të Partisë Demokratike dhe Lidhjes Demokratike, e ndërpresim seancën në shenjë solidarizimi për situatën e krijuar pas vazhdimit të qëndrimit të zotit Haradinaj në Francë me vendim të gjyqit.

(Reagime)

Unë nuk mund ta nxjerr askënd, policia është e obliguar për atë punë. Unë s'mund as të jap leje, as kurrgjë.

Vazhdimin e seancës do ta lëmë për të hënë, në orën 10:00, sepse nesër e kemi konferencën ndërparlamentare.

* * *

E enjte, 9 mars

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 2 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

E nderuar ministre e Drejtësisë,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 2 mars 2017.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë me pikat e papërfunduara, ju njoftoj se në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët dhe grupet parlamentare të mbajtur më 8 mars 2017, me propozim të kryetarit të Grupit Parlamentar të AAK-së, zotit Pal Lekaj, në seancën e sotme do të procedohet votimi i propozim-rezolutës lidhur me mbajtjen e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në Francë, e mbetur nga seanca e jashtëzakonshme më 10 janar 2017. Për mungesë të kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje, respektivisht mospjesëmarrjes së deputetëve në votim, të paktën 61 deputetë që duhet të votojnë.

Pas debatit të seancës së jashtëzakonshme më 10 janar 2017 janë propozuar dy rezoluta: një nga Grupi Parlamentar i AAK-së dhe një nga grupet parlamentare PDK dhe LDK, po në votimin e tyre nuk kanë marrë pjesë të paktën 61 deputetë në votim.

Tani radha është e deklaramit, në qoftë se dëshirojnë, kryetarët e grupeve parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare për këtë çështje. Nuk e di, Pali si iniciues mund ta marrë fjalën i pari.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pas vendimit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për bojkot, me solidarizim edhe nga Grupi i "Nismës" sot jam këtu që të propozoj në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës që të rikthejmë në votim një çështje, e cila nuk e mori epilogun e duhur në muajin janar të këtij viti.

Pas një debati e solidarizimit të gjithmbarshëm të këtij Kuvendi me padrejtësinë që po i bëhet për të satën herë një luftëtari të shquar, një ish-kryeministri e një politikani siç është Ramush Haradinaj nuk ndodhi që të votohet e të kalojë një rezolutë, e cila në thelb të saj nuk përmban asgjë më shumë se disa kërkesa të deputetëve, e që rrjedhimisht i bëjnë kërkesa të qytetarëve për të ndërmarrë hapa konkretë që zoti Haradinaj të lirohet një herë e përgjithmonë dhe të mos ketë

pengesa në këtë lloj nga askush tjetër. Kur e themi për Ramushin, e nënkuptojmë tërë angazhimin e popullit në një kauzë të drejtë për çlirim, liri e pavarësi.

Pra, cilido nga ne që përballet me shpifje të Serbisë, siç tani po ndodh me Ramushin, i bëjnë që Serbia po e lufton Kosovën dhe të drejtën tonë për të konsoliduar shtetin e pavarur dhe sovran, duke shpifur për të kaluarën tonë të luftës për liri, e cila është mbështetur nga tërë bota perëndimore.

Sot jam këtu, kolegë deputetë të nderuar, t'ju bëj thirrje prapë t'i lëmë anash ndasitë politike, ato të politikës ditore dhe nëpërmjet kësaj rezolute të dërgojmë sinjalin e duhur te të gjithë miqtë, por më shumë te kundërshtarët e Kosovës, se jemi bashkë sa herë bëhet fjalë për cenimin e ekzistencës së historisë nga kaluam dhe do ta mbrojmë me çdo çmim rrugën për të forcuar shtetin tonë.

Nëse sot nuk bëhemi bashkë, atëherë nuk kemi bërë asgjë më shumë se sa që po tregohemi të dobët e aspak mbrojtës të vlerave tona, që janë pjesë e historisë dhe po u dërgojmë sinjale kundërshtarëve që mund të bëjnë çka të duan me Kosovën dhe vlerat e saj.

Duke mos e zgjatur më shumë, do ta lexoj rezolutën, e cila nuk u miratua në një nga seancat e kaluara dhe të njëjtën i propozoj kryetarit ta hedhë në votim, por me disa ndryshime.

Grupi Parlamentar i Aleancës,
Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të nenit 61.1, 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 52.2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pas debatit të zhvilluar për ndalimin e kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 10 janar 2017 propozon për miratim këtë:

R e z o l u t ë

Lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, në Francë.

1. Lirimi pa kusht i ish-kryeministrit të Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, të ndodhë sa më shpejt dhe të konsiderohet detyrë primare shtetërore.

2. Të pezullohet, të ndalohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë deri në lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj dhe deri atëherë kur Bashkimi Evropian do ta detyrojë Serbinë për t'i anuluar të gjitha fletarrestimet e lëshuara nga Serbia nëpërmjet Interpolit për shtetasit e Republikës së Kosovës.

3. Qeveria dhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës obligohen që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme, në mënyrë që t'i informojnë të gjitha instancat ndërkombëtare se refuzon juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e Jugosllavisë dhe konform kësaj të kërkojë lirim të ish-kryeministrit të Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është për deklarimin e grupeve parlamentare lidhur me këtë çështje. Fjalën e ka zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Deputetë të nderuar,

Ministra,

Partia Demokratike e Kosovës shfrytëzon këtë rast që të përsërisë mospajtimin dhe shqetësimin për vazhdimin e ndalimit për zotin Haradinaj në Francë. Konsiderojmë se tashmë është tepruar me gjithçka që ka ndodhur rreth tij, pavarësisht ftesave tona të vazhdueshme si institucione, si deputetë e si Kuvend.

Shfrytëzoj këtë rast, meqenëse edhe herën e kaluar nuk ka pasur një dakordim, të kërkoj që grupet parlamentare të mblidhen, ta formulojnë një tekst të përbashkët, të paktën kështu u dakorduar edhe më parë, në mënyrë që sot të dalim me një qëndrim të përbashkët, me një rezolutë të përbashkët që do të ndihmonte zotin Haradinaj të jetë këtu.

Kërkoj që veprimet tona të jenë të koordinuara, të përbashkëta, në mënyrë që të mundësojnë ose t'i ndihmojmë përsheptimin e kthimit të zotit Haradinaj në Kosovë dhe po ashtu, të mbështesim dhe të koordinojmë së bashku të gjitha përpjekjet, në mënyrë që të mos ketë më tutje ndalim të ish-ushtarëve të UÇK-së dhe të gjithë atyre që herë pas here kanë qenë viktimë e kërkesave të Beogradit për ndalim qoftë në Serbi, qoftë në vende të tjera.

Pra, kërkoj që të ketë një koordinim, përfaqësuesit e grupeve parlamentare të koordinohen dhe jemi në mbështetje të një rezolute të përbashkët.

Kërkoj që zoti Ilmi Reçica të jetë përfaqësuesi i PDK-së, të koordinojë këtë rezolutë bashkë me të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dëshiroj të apeloj te kryetarët e grupeve parlamentare dhe te kryetarët e komisioneve parlamentare që ditën kur ka seanca nuk mund të ketë mbledhje të komisioneve parlamentare. Deputetët duhet të jenë në seancë, jo nëpër mbledhje të komisioneve. Ose ta rregullojmë, të marrim pauzë si Kuvend, siç funksionon në vende të tjera dhe pjesën t'ua kushtojmë komisioneve, le të mbetet për komisione, jo kështu Komisioni për Buxhet është në mbledhje, absolutisht nuk ka asnjë arsye të thirret mbledhja ditën kur ka seanca.

Radha është e zotit Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Ne edhe në seancën e kaluar si grup parlamentar, ose më mirë të thuhet, në kohën kur ishte teksti i paraqitur dhe debati, ajo që ka të bëjë me ndalimin e zotit Haradinaj, e kemi thënë qëndrimin në kuptimin e mospajtimit tonë për këtë që i ka ndodhur dhe po vazhdon t'i ndodhë zotit Haradinaj dhe ne pajtohemi që sot të jetë një rezolutë dhe do të bëjmë përpjekje ta harmonizojmë, në mënyrë që do të ishte edhe një mesazh i mirë, besoj, për gjithë ne dhe jam dakord dhe kërkoj që të bëhet një pauzë, gjegjësisht të autorizohemi dhe ta harmonizojmë një tekst për këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Këtu para më shumë se një viti e patëm mbajtur një seancë kur herën e parafundit u ndalua zoti Haradinaj në Slloveni dhe u patëm marrë vesh që të kushtëzohet çdo marrëdhënie me Serbinë me heqjen e fletarrestimeve nga ky shtet që i ka për shumë ish-luftëtarë dhe udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në bazë të të cilave ata po ndalohen sa herë që po kalojnë nëpër shtete të ndryshme të Evropës dhe prej atëherë Qeveria e Kosovës nuk ka bërë asgjë në këtë drejtim.

Njëra prej pikave që është miratuar atëherë është edhe që Qeveria jonë ta ngre në Bruksel këtë çështje dhe që ta kushtëzojë çdo marrëdhënie me Serbinë, e bile edhe dialogun me pastrimin e këtyre listave. Kjo nuk ka ndodhur. Qeveria e Kosovës vazhdon dialogun me Beogradin dhe në janar na ndodhi sërish, na u përsërit e njëjta dukuri që është ndalimi i zotit Haradinaj nga autoritetet e Francës, sërish sipas një fletarrestimi të Serbisë.

Serbia nuk e ka ndryshuar asnjë milimetër qëndrimin ndaj Kosovës, kjo është fare e qartë: nuk e njeh Kosovën, është shtet armiqësor, e kontrollon një pjesë të territorit të Kosovës, veriun e Kosovës e mban me strukturat e saj, të cilat nuk i ka shpërbërë e i financon ende. Pastaj e kolonizon atë pjesë të Kosovës me projekte, siç është Lugina e Diellit. Pra, është një Serbi armiqësore, këtu nuk kemi kurrfarë dyshimi, po Qeveria jonë është shumë e nënshtruar dhe e vazhdon dialogun me Serbinë pa kurrfarë kushti.

Tash shtrohet pyetja? Çka ka bërë Qeveria e Kosovës deri tash, përveç deklaratave që të ushtrojë ndonjë trysni që Serbia t'i heqë fletarrestimet edhe për zotit Haradinaj, por edhe për gjithë udhëheqësit dhe ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

Qeveria përpos që ka lëshuar deklaratat, nuk ka bërë asgjë deri më tash. Çka ka në dorë Qeveria e Kosovës me Serbinë? E ka në dorë dialogun. Ky është një mjet shumë i vlefshëm që Qeveria jonë e ka në dorë, të cilin nëse e shfrytëzon ashtu si duhet, do të ishte trysni për Serbinë që të

mos na qaset në këtë mënyrë, pra që t'i mbajë ende aktive ato fletarrestime për udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Qeveria përndryshe e ka brenda edhe Listën serbe, që është mekanizëm i Vuçiqit brenda Qeverisë të Republikës së Kosovës. Ajo po e kushtëzon Qeverinë e Kosovës, kurse Qeveria jonë nuk ka kurrfarë kushti për Serbinë në dialogun e Brukselit. Do të ishte veprim shumë i mirë nëse Qeveria e Kosovës do ta kushtëzonte dialogun e Brukselit me lirimin e zotit Haradinaj. Kjo do të ishte në interes të shtetit të Kosovës dhe t'i tregohej Serbisë që nuk mund të luajë kështu me shtetin e Kosovës, që Qeveria e Kosovës ka dinjitet, që i mbron interesat e veta dhe që ne nuk mund të shtiremi se po bëjmë marrëdhënie fqinjësore e të mira, kur Serbia na konsideron terroristë dhe ku ti kalon në një shtet të Perëndimit dhe befasisht e gjen veten të arrestuar sipas disa dokumenteve që i lëshon Serbia.

Pra, deri tash, faktikisht, e kemi pasur një politikë të qyqarllëkut do të thosha, dhe të nënshtimit të kësaj Qeverie ndaj Serbisë. Nëse doni që të tregoni zotshpillëk, nëse doni të tregoni që ky vend ka Qeveri, atëherë më e pakta që do të duhej që të kushtëzohet vetë dialogu, krejt dialogu të pezullohet deri në lirimin e zotit Haradinaj. Prandaj, ne e mbështetim plotësisht këtë rezolutë të sponsorizuar nga AAK-ja, prej të cilave më e rëndësishmja është natyrisht pika e parë dhe e dytë - që të lirohet zoti Haradinaj dhe që si masë e presionit Qeveria ta kushtëzojë dialogun me Serbinë deri në lirimin e zotit Haradinaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të "Nismës", zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Nisma për Kosovën natyrisht se e mbështet këtë rezolutë dhe mendoj se rezoluta ka elemente që na bëjnë seriozë karshi Serbisë, e cila vazhdon të jetë agresive në raport me Kosovën dhe qytetarët e saj.

Edhe më 10 janar është diskutuar dhe përafërsisht ka qenë kjo përmbajtje. Dihet se si ka qenë epilogu dhe unë mendoj se mazhoranca duhet të ndryshojë qasje në raport me Serbinë dhe dalëngadalë të fillojmë të sillemi seriozisht si shtet, për arsye që tashmë po dihen. Rrethanat gjithmonë e më shumë po ndryshojnë, maska e Serbisë po i shkoqet, kështu që besoj se kalimi i kësaj rezolute kësaj do të jetë një favorizim dhe një seriozitet i Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje, në emër të "6+" e ka fjalën.

DUDA BALJE: Hvala vam!

Parlamentarna grupa "6+" je u poslednjim danima potpisala jedno pismo podrške za oslobođanje gospodina Haradinaja. Na 6 poslanika, zajedno sa još tri poslanika iz manjinske zajednice

saglasni smo da se sedne, da se harmonizuju ova rezolucije i da se izade sa jepnim zaključnim tekstom danas. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, mendoj që shumica e deputetëve dhe grupeve parlamentare është që të dalë një komision, të formohet një komision ose me përfaqësuesit e partive, ta shqyrtojnë dhe ta sjellin edhe një herë për ta votuar në seancë.

Mendoj që kështu kemi vepruar edhe për raste të tjera dhe kështu po veprojmë edhe sot. Ne po e marrim një pauzë prej gjysmë ore, edhe pastaj mund ta sjellim. Gjysmë ore pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë vazhdojmë, besoj që përfaqësuesit e partive respektivisht grupet parlamentare e kanë shqyrtuar projektin e rezolutës dhe e kanë sjellë të harmonizuar sipas tyre në seancë.

E ftoj zotin Lekaj që para deputetëve ta prezantojë tekstin e ndryshuar të rezolutës dhe të harmonizuar nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Zoti Lekaj, e keni fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

I falënderoj të gjithë shefat e grupeve parlamentare që më në fund e harmonizuan një rezolutë për zotin Haradinaj që do ta lexoj tani:

R e z o l u t ë

1. Lirimi i pakusht i ish-kryeministrit të Kosovës, zotit Haradinaj të ndodhë sa më shpejt dhe të konsiderohet detyrë primare shtetërore.
2. Të pezullohet procesi i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë deri në lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga BE-ja që ta detyrojë Serbinë për t'i anuluar të gjitha aktakuzat dhe fletarrestet lëshuar nga Serbia nëpërmjet Interpolit për shtetasit e Republikës së Kosovës.

4. Qeveria dhe institucionet tjera të Republikës së Kosovës obligohen që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që t'i informojnë të gjitha instancat ndërkombëtare se refuzon juridiksionin universal të Serbisë për krimet e pretenduara në tërë territorin e ish-Jugosllavisë dhe konform kësaj të kërkojë lirimin e ish-kryeministrit të Kosovës dhe kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Ramush Haradinaj.

Të nënshkruar nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ka vërejtje nga grupet parlamentare? Atëherë, urdhëro Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Nuk është diçka që po dal kundër kolegëve të mi, por diçka që ju thashë edhe aty, domethënë kur ishim në takim thashë që nuk kam qare pa e marrë fjalën dhe pa e shpjeguar që këtu është bërë një kompromis në këtë rezolutë dhe kompromisi e dobësoi pak rezolutën.

Pra, me ndërhyrjen e pushtetit u bë ky kompromis, sepse ajo çka ishte esenciale në rezolutën e mëparshme ishte që të jetë kusht heqja e fletarresteve, ky është halli i vërtetë i Kosovës. Se zoti Haradinaj atje është arrestuar për shkak që fletarrestet e Serbisë janë aktive. Edhe pasnesër nëse lirohet zoti Haradinaj, por fletarrestet nuk hiqen, ai mund sërish të ndalohej prapë pas 2 muajsh për shembull nëse është duke udhëtuar diku. Edhe nëse nuk i ndodh zotit Haradinaj, do t'i ndodhë atij tjetrit, që është komandant i UÇK-së.

Pra, krejt esenca është që Serbia të kushtëzohet që të hiqen fletarrestet, që të mos ketë dialog me Serbinë pa u hequr fletarrestet. Kështu që kjo u hoq prej ndërhyrjes të PDK-së dhe të LDK-së dhe çështja u reduktua në kthimin e zotit Haradinaj. Ne pajtohemi, kjo është shumë mirë, kjo është në rregull, por të mos pretendojmë që e kemi zgjidh problemin me fletarrestet e Serbisë. Por, në rregull është, shumë mirë që do ta votojmë sidomos këtë pikën që të lirohet pakusht zoti Haradinaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë së pari dua të them që nuk jemi aq të fortë sa ta detyrojmë Gjykatën franceze, s'jemi aq të fortë sa ta detyrojmë Bashkimin Evropian, por është mirë që është harmonizuar dhe po i bëhet një thirrje Bashkimit Evropian për një hall tonin, hall të përbashkët, hall që mirë e tha i ka ndodhur sot Ramushit, nesër mund t'i ndodhë dikujt tjetër. Prandaj, unë e hedh në votim!

Në sallë i kemi 80 deputetë. E dini që me shumicën e votave miratohet rezoluta, u bënë 83 deputetë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Atëherë, konstatoj që kanë votuar 75 deputetë me kartelë, plus 4 pa kartelë bëjnë 79 deputetë. Për kanë votuar: me kartelë 74, plus 4, gjithsej 78 deputetë, 1 deputet ka votuar kundër.

Konsideroj që Kuvendi e miratoi rezolutën e propozuar dhe të harmonizuar nga grupet parlamentare të PDK-së, të LDK-së, të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të AAK-së dhe të “Nismës”.

Naiti e ka kërkuar fjalën, dhe ky e ka një çështje që kërkon për ta diskutuar. Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në seancën e kaluar unë e shtrova një çështje për Gjykatën Speciale dhe kam kërkuar që të jetë pikë e rendit të ditës, por atë ditë nuk kishte kuorum. Sot kemi kuorum prej rreth 80 deputetësh dhe kemi mundësi ta vëmë në rend dite për shqyrtim. Unë kam edhe propozimin e shoqatave, kam propozimin e familjeve të dëshmorëve, kam po ashtu edhe kërkesë të nënshkruar nga 60 deputetë për debat për plotësim ndryshimin Ligjin për Gjykatën Speciale. Këtë e kam kërkuar dhe po e kërkoj, pikërisht për shkak se kjo gjykatë trajton vetëm ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk trajton asnjë rast të policisë, të ushtrisë të serbëve që kanë bërë krime në Kosovë.

Prandaj, po kërkojmë që të vihet në rend dite Plotësim ndryshimi dhe kjo gjykatë të jetë pjesë e Kosovës si Gjykatë Speciale dhe të jetë pikërisht për juridiksionin mbi krimet kundër njerëzimit e jo t'i trajtojë a t'i barazojë ato. Unë kërkoj që pikë e rendit të ditës, kërkoj nga kolegët deputetë që të trajtohen të gjitha krimet, ja ku i kemi krimet, kemi fëmijë dyvjeçarë që kanë vrarë serbët, policia dhe ushtria, kemi masakra dhe gjenocid që kanë bërë, kemi djegien dhe karbonizimin e tyre që e kanë bërë, të gjitha që i kanë bërë asnjë nuk trajtohet përmes kësaj gjykate.

Prandaj, kërkoj që të plotësohet e të ndryshohet dhe të jetë pjesë e debatit dhe e ligjit krimet kundër njerëzimit, që i ka bërë policia dhe ushtria serbe në Kosovë. Kërkoj që ta fusim në rend dite dhe ta debatojmë, ta plotësojmë e ndryshojmë dhe të jemi konform me ndërgjegjen e njerëzve tanë, të cilët i kërkojnë eshtrat dhe i kanë nëpër gjithë Serbinë. Mendoj që edhe nënshkrimet që janë nga grupet deputetët dhe nga partitë tjera po kërkoj me 6 nënshkrime, nëse nuk mund të kalojë këtu, atëherë do ta procedoj përmes Kryesisë, por megjithatë kërkoj që kjo si çështje si çështje urgjente, unë konsideroj, të jetë pjesë e jona, e këtij debati e seancës së sotme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores kemi shumë hapësirë për të hapur çështje dhe është e potencuar në Rregullore, që secili deputet ka të drejtë të bëjë mocion në çdo kohë dhe kjo është një mundësi.

Megjithatë, këto janë çështje jo shumë të lehta për t'i trajtuar, por sidoqoftë unë dua të them, se çdo kërkesë për amendamentim të cilitdo ligj e ka rrugën e vet të amendamentimit dhe kalon përmes Kryesisë dhe Kryesia ia përcjell pastaj Qeverisë dhe të gjitha këto mund të ndodhin në procedura normale.

Sa i përket debatit, unë mund ta qes në votim edhe kërkesën për debat dhe në seancë ka mjaftë deputetë. E dini që për shqyrtim urgjent si mund të procedohet. Megjithatë, unë jam i obliguar që sipas rregullores kërkesën për debat ta hedh së pari për të diskutuar kryetarët e grupeve parlamentare dhe pastaj, në qoftë se duhet ta hedh në votim, e hedh në votim, ose ndiqet rruga normale e propozimit për debat, përmes Kryesisë dhe amendamentimit të ligjit, sërish përmes Kryesisë së Parlamentit, respektivisht Komisioni të ligjeve dhe komisioneve përkatëse.

Kështu që, unë nuk mund ta refuzoj asnjërin për mocionin, për asnjë mocion, edhe tash fjala është e kryetarëve të grupeve parlamentare, sa i përket mocionit të zotit Hasani, bashkë me... s'po di kush janë deputetët, s'kam asnjë letër përpara, por dëgjova se janë deputetët. Zoti Pajaziti e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe në seancën e kaluar zoti Hasani pati një kërkesë të tillë. Në atë seancë ne nuk patëm ndonjë qëndrim të grupit parlamentar, për shkak se... ose ishte kërkesa jonë që të jenë të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare dhe të trajtohet kjo çështje.

Sot, doli sërish kjo kërkesë edhe pse nuk ishte, ka pasur edhe Kryesia e Kuvendit dhe nuk është proceduar në seancë, nuk e di si janë ndjekur procedurat. Për sa i kam konsultuar sot deputetët e Partisë Demokratike, ne mbështesim një... meqenëse kjo kërkesë vjen edhe prej përfaqësuesve të shoqatave të ndryshme dhe komuniteteve të ndryshme, meqenëse kjo temë është një prej temave më të përfolura dhe më të ndjeshme edhe kërkesat e tilla nuk mund të mos trajtohen.

Ne jemi për, në përputhje me ligjet në fuqi, rregulloren, për t'i dhënë dritën jeshile procedurave për ndryshimin, kemi bërë... jo rrallë ky Kuvend ka bërë nisma për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve. Pra, nëse kjo kërkohet edhe për debat, ne i japim mbështetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Ju i shpjeguat procedurat. Është shumë e qartë, se si është e rregulluar çështja e procedimit të projektligjeve, amendamentimi i tyre. Ne asnjëherë nuk e kemi fshehur dhe kemi diskutuar edhe më herët, dhe kur është miratuar vetë Gjykata Speciale i kemi shprehur shqetësimet tona, por ajo që sot pa asnjë letër, pa asnjë dokument, ne nuk jemi që të mos debatohet, kur t'i vijë radha, edhe për këtë çështje dhe në procedurat kuvendare edhe po të donim ne, nuk mund t'i ndalim

procedurat e tilla. Por, sot nuk ka mundësi, s'ka se si kjo të futet në procedurë, po të respektohen, siç u tha edhe nga parafolësi, të respektohen procedurat siç janë të parapara e pastaj është çështje tjetër e Kuvendit dhe asaj, se si parashihet me Rregullore.

Shkurt, sa i përket debatit, gjithmonë ka mundësi që debatet të bëhen për të gjitha temat, për çdo temë, por sa i përket amendamentimit dhe procedurave ligjore, është shumë e qartë që është rregullativa e qartë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: Po, ne e dimë se si ka ardhur Gjykata Speciale dhe e dimë kush ka qenë për dhe kush ka qenë kundër, në atë kohë.

Këta që po flasin tash janë njerëzit që e kanë çuar dorën për ta votuar Gjykatën Speciale, këtu në Kuvend. Më së shumti zor i kanë dhënë presidenti Thaçi, në atë kohë zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm i Kosovës dhe Isa Mustafa me partinë e tij. Domethënë, koalicioni i mazhorancës në këtë Kuvend e ka votuar me 2/3-ën e votave dhe jo vetëm që e ka votuar me 2/3-ën e votave, por është bërë edhe çështje kushtetuese kjo Gjykata Speciale.

Pse po bëni gjëra tash shumë vonë, për të dashur t'i rregulloni. Atëherë, ne thoshim që Gjykata Speciale duhet të refuzohet për shumë arsye dhe i kemi shpjeguar shumë mirë. Ajo është një gjykatë e njëanshme, është një etnike, e paragjykon UÇK-në si kriminele, i paragjykon shqiptarët që kanë bërë krime dhe është gjykatë një etnike, ajo thotë: “...do të gjykohet krimi i shqiptarëve këtu.” Plus, pastaj kritika tjetër që është përmbi institucionet e Kosovës, funksionon përmbi juridiksionin e Kosovës, funksionon përmbi drejtësinë, sistemin e drejtësisë të Kosovës. A i patët mendtë në kokë atëherë, kur i çuat duart për ta votuar Gjykatën Speciale, apo vetëm pse u tha Hashim Thaçi që duhet të votohet gjithqysh apo mos ka qenë atëherë ndonjë Pazar “kë ka me e marrë e kë s'ka me e marrë”, e tash mos nuk u ka dalë bash ashtu. E tash po u dashka me e ngritë në pikëpyetje Gjykatën Speciale! Mos është edhe kjo rastësisht! Mos nuk po flitet këtu për interesa të Kosovës, po për interesa të ndokujt që nuk i ka dalë matematika bash tamam!

Mosni, ju lutem, kështu! E keni bërë amendament kushtetues, a po kuptoni, Gjykatën Speciale! Për Gjykatën Speciale keni vendosur ashtu, që kur është bërë amendament kushtetues tash nuk zhbëhet pa listën serbe. Merreni me mend çfarë dëmi i keni shkaktuar Kosovës. Domethënë, tash kjo çështje të varet prej Vuçiqit atje, e prej Listes Serbe.

Kjo punë nuk bëhet spontanisht. Edhe për zotin Hasani e kam këtu kritikën. Kjo punë nuk bëhet pse na ka rënë në mend në njërin prej seancave plenare, ku nuk është as pikë e rendit të ditës bile. Për këtë ulen krejt subjektet politike, bëhet një projekt, analizohet cila është procedura për ta zhbërë tash Gjykatën Speciale. Procedura është e qartë, zonja dhe zotërinj. Procedura është:

duhet të zhbëhet në nivel kushtetues, po qe se doni ta zhbëni Gjykatën Speciale, duhet të zhbëhet në nivel kushtetues me 80 e sa vota, edhe Listën serbe duhet me e bindë.

Kjo është procedura çfarë keni bërë ju tash, dëmin që e keni bërë kështu s'bëhet. Nëse jeni përnjëmend për ta zhbërë Gjykatën Speciale, atëherë kjo është me konsensus të krejt subjekteve politike, të PDK-së, të LDK-së, të "Vetëvendosjes", të AAK-së, edhe të pakicave bile. Ulen përfaqësuesit, e shkruajnë një projekt se cila është, edhe një analizë politike bile, qysh duhet të zhbëhet Gjykata Speciale dhe e keni përkrahjen tonë. "Vetëvendosja" ka qenë gjithnjë kundër Gjykatës Speciale, për çështje parimore kemi qenë, ajo është kundër shtetit të Kosovës, e paragjykon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, nuk e trajton asnjërin prej atyre krimeve, që i përmendi edhe me dokumente, zoti Hasani. Asnjë prej 254 masakrave në Kosovë nuk do ta trajtojë Gjykata Speciale, thuajse këtu UÇK-ja paska bërë krime e jo policia, ushtria e paramilitarët e Milosheviqit.

Ju e keni votën tonë, këtu po ua garantoj, në Kuvend të Kosovës, në momentin që doni ta zhbëni Gjykatën Speciale. Ne nuk jemi kundër një departamenti që t'i trajtojë krimet e luftës. Çdo shtet në ish-Jugosllavi e ka pasur nga një gjykatë speciale vendore. Është Prokuroria Speciale, e ka pasur edhe Kroacia, edhe Bosnja, edhe Serbia e ka pasur gjykatën e vet speciale, edhe Kosova pse mos ta ketë gjykatën e vet speciale. Po, jo një gjykatë e cila bëhet atje në Holandë, një tribunal ndërkombëtar, ku thotë: "veç shqiptarët kanë bërë krime".

Zonja dhe zotërinj, kjo që na ka ndodhur është e tmerrshme. Kështu që, do të ishte lajm shumë i mirë për Kosovën, nëse do ta zhbente Gjykatën Speciale, por kjo kërkon një projekt nacional, një konsensus. Ejani, të ulemi të gjitha subjektet politike, t'i paraqesim propozimet e veta, t'i harmonizojmë dhe vijmë pastaj në Kuvend të Kosovës me një projekt shumë të qartë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Për të mos i përsëritur fjalët që i tha Glauku, kemi qenë kundër dhe prapë vazhdojmë të jemi kundër asaj gjykate etnike. Këtë e kemi thënë edhe me zë dhe jemi munduar t'i bindim edhe deputetët për të mos ia dhënë votën për, por pasi që e kanë votuar vetë, ndoshta edhe vetë mund ta ndreqin.

Për shkak të kundërshtimit shumë të madh që e kemi bërë në atë kohë edhe kemi paguar çmim, qoftë në Kosovë dhe jashtë saj, pse kemi qenë kundër. Besa, kanë shkuar deri atje, kolegët e mi deputetë, që kanë thënë edhe se "po tuten për vete". Ndoshta, tash ndonjë shqetësim më i madh që u ka rënë ndërmend, shpresoj se e kanë seriozisht. E nëse përnjëmend e kanë seriozisht, jo vetëm unë si deputet, por besoj se edhe kolegët e mi të Aleancës, janë edhe për debat po edhe do ta japin edhe votën për çfarëdo versioni që këta do të jenë të gatshëm për t'i ndëshkuar krimet e

panumërta serbe, që janë në Kosovë, duke filluar prej krerëve të shtetit në Serbi, që kanë qenë pjesë e një organizate të përbashkët kriminele të Milosheviqit e të cilët Qeveria jonë në vazhdimësi i ka trajtuar si homologë e si kolegë.

Pra edhe një herë, në rast se përnjëmend e kanë dhe po duan të bëjnë debat sa për folklorizëm, më leni debatin krejt. Nëse e keni bërë njet me e zhvendosë ose me tërheqë atë ligj, OK shko bjereni Listën Sërpska, ejani këtu në sallë dhe ne jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë. Edhe, meqenëse jemi duke folur tash në emër të grupit, pasi qenka këtu ministrja e Drejtësisë, e kam edhe një shqetësim. Ministre, një qëndrim publik i një djali po thotë se ju keni marrë një vendim për ta rikthyer në burg një të hospitalizuar, i cili ka vdekur në burg.

A qëndron kjo? Dhe, nëse po, cili është qëndrimi juaj? Duhet të përgjigjeni se është qytetar i Kosovës dhe keni edhe raste të tjera të përsëritura. Në këtë rast po flas për vëllezërit Ramadani. Por, një rast që kishte vdekur në burg, ju me urdhëresë e keni tërhequr prej spitalit dhe e keni dërguar në burg. Faleminderit!

KRYESUESI: Respekto rendin e ditës, Daut! Nuk ishte kjo çështje, pak më vonë ndoshta mund ta bësh këtë pyetje.

Fjalën e ka zoti Qerim Bajrami, në emër të grupit “6+”.

ĆERIM BAJRAMI: Kryetar, ne emrin tim personal, pasi qe s'i kemi përfaqësuesit këtu.

Dakle, predsedavajući u svoje osobno ime kratko, s obzirom da nemamo ovde predstavnike naše grupe.

Kao što je manje više je poznato u zapisnicima stoji, ja sam tokom rasprave oko formiranja specijalnog suda bio za stav da se takvi sud formira koji će tretirati sve eventualne zločine u oči rata na Kosovu, tokom rata i posle rata na Kosovu. I dan danas držim se tog stava i ako taj sud ne radi tako, odnosno to tužilaštvo onda smatram da su u pravu ovi ljudi koji su pokrenuli to pitanje.

U svakom slučaju, dakle pošto govorim lično, ja ću podržati sve ono što podrži većina poslanika u ovom Parlamentu vezano za ovaj problem, jer je ovaj veliki problem države Kosova, i trebamo da imamo barem većinski stav po ovom pitanju. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

“Nisma” me kohë e ka trajtuar këtë çështje dhe kemi pasur një qëndrim shumë të qartë, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm se kjo gjykatë është drejtuar njëanshëm për të gjykuar vetëm Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për t’i gjykuar vlerat tona historike, të sotme dhe të ardhmen, të kombit dhe vendit tonë.

E kemi ditur me kohë se është mbi sistemin juridik të vendit, e shkatërron sistemin juridik të vendit.

Ne e mbështesim iniciativën e zotit Hasani për ndryshimet që mund të bëhen, por vërtet është për t’u befasuar kur disa deputetë që janë krah andej nga shumica, u dukej pak njëra dorë, e tentonin t’i ngrinin dy duart për ta votuar dhe thurnin lavde se si është obligim dhe si i hap perspektivë Kosovës dhe vendit. Prandaj, sinqerisht po ndihem mirë që nuk po ua shoh fytyrat, sepse i kam këtu mbrapa shpinës, po më vjen mirë, por kisha pasur dëshirë t’i shoh ato fytyra të shëmtuara kur atëherë ngrinin edhe dy duart për t’i bërë një të keqe vendit.

Tani dua të di si do të ndiqet ajo rrugë dhe si do të bëhet? Nëse kjo iniciativë mbetet sa për sy e faqe, sa për t’i mashtruar ato organizata, të cilat na kanë drejtuar letra të gjithë neve si deputetë dhe për t’i mashtruar veteranët, më mirë është të mos fillojë fare.

Mirëpo, ne i mbështesim seriozisht dhe jemi të gatshëm të japim kontributin tonë, sepse janë mbi 12 000 viktima që i ka masakruar e vrarë Serbia dhe me gjykatën aktuale ato mbeten jashtë trajtimit.

Prandaj, ne do t’i mbështesim të gjitha ato mundësi që janë reale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë e hedh në votim kërkesën për debat.

(Ndërhyrje)

Jo, s’kam hapur debat. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim për propozimin e zotit Hasani që të ketë debat lidhur me këtë çështje dhe sa i përket amendamentimit, ky duhet të zhvillohet me procedurë.

(Ndërhyrje)

Zoti Nait Hasani, edhe një herë e ka fjalën!

NAIT HASANI: I nderuar nënkryetar!

Ne e futëm në rend të ditës, hapim debat dhe në bazë të debatit, ne dalim me përfundim dhe i bëjmë amendamentet.

KRYESUESI: Tani jeni ju që vendosni, unë nuk vendos për këtë. Unë e hedh në votim debatin e propozuar, nëse është me interes që të ketë debat dhe nëse i merr votat shumicë, që në sallë janë 82 deputetë.

Po them, e hedh në votim dhe nëse doni të votojmë, mundeni, votojmë tash. Votimi është i lirë.

I kemi 54 vota. Nuk kalon, mbetet të ndiqen procedurat.

(Ndërrhyrje)

Nuk kaloj, sepse s'i ka votat. Të pashë se e pate votën, por nuk kalon me votën tënde. Janë 55 vota gjithsej.

(Ndërrhyrje)

Po, vetëm ndiqni procedurat, unë e hedh në votim.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërmarrjet sociale

Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Abrashi, s'qenka këtu dhe nuk e di a e ka ngarkuar dikë Qeveria? Jo!

Atëherë si çështje e shtyjmë, sepse s'kemi raportues.

5. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të drejtësisë për të mitur

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projekt-kodin dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe të arsyetojë projekt-kodin. Zonja Hoxha, e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar nënkryetar,
Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur.

Ky projekt-kod është hartuar dhe finalizuar nga Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet të cilit janë adresuar pengesat e hasura gjatë zbatimit të kodit ekzistues, si dhe janë paraparë disa dispozita të reja, të cilat konsiderojmë se legjislacionin e kësaj fushe e avancojnë në masë të konsiderueshme.

Disa nga çështjet më të rëndësishme, të cilat i përmban ky projekt-kod për të mitur, janë:

- Është zgjeruar numri i parimeve garantuese dhe mbrojtëse të drejtave të fëmijëve, si dhe është paraparë një kapitull i veçantë, i cili i rregullon masat ndihmëse dhe mbrojtjes për fëmijët si kryerës të veprave penale në përgjegjësinë penale. Pra, për fëmijët nën moshën 14 vjet.

- Gjithashtu është rritur lloji i masave të diversitetit dhe janë përcaktuar kushtet e mënyra e shqiptimit të tyre;

- Është paraparë që koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo privim tjetër nga liria të llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar të dërgimit të të miturit në institucionin e tipit edukativo-korrektues, dënimin me burgim ndaj të miturit dhe dënimin me gjobë.

- Është përcaktuar edhe afati i paraburgimit prej 30 ditëve deri në 6 muaj, përjashtimisht deri në 12 muaj, për raste specifike.

- Në kuadër të propozimeve të reja është edhe zgjerimi i numrit të veprave penale, ku gjyqtari për të mitur apo trupë gjykues për të mitur i gjykon personat madhorë në rastin kur fëmija paraqitet viktimë.

- Është vendosur një kapitull i veçantë, i cili ka të bëjë edhe me mbrojtjen e fëmijëve - viktimë apo dëshmitarë.

Vlen të ceket se finalizimi i këtij drafti është bërë në koordinim dhe bashkëpunim me aktorët relevantë vendorë e ndërkombëtarë, me theks të veçantë me përkrahjen e UNICEF-it dhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Po ashtu, dispozitat e këtij projekt-kodi janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të BE-së si dhe i është bërë edhe vlerësimi financiar.

Konsideroj se miratimi i këtij projekt-kodi është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe avancimit të standardeve më të larta sa i përket trajtimit të të miturve, andaj propozoj miratimin e projektit të drejtësisë për të mitur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre e Drejtësisë! Ftoj tani nënkryetarin e Komisionit Funkcional, zonjën Selvije Halimi, ta marrë fjalën! S'është këtu. Atëherë, zoti Armend Zemaj e ka fjalën në emër të komisionit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e paraqes arsyetimin që e ka dhënë Komisioni Funkcional. Ne e kemi formuar edhe grupin punues, duke e marrë parasysh rëndësinë që e ka Projekt-kodi për të mitur, po edhe arsyeshmërinë e cila është dhënë me këto plotësim-ndryshime, sepse ligji i vjetër nuk i ka plotësuar disa kritere, të cilat janë në harmoni sidomos me edukimin apo edhe risocializimin institucional që duhet të ndodhë për të miturit që kryejnë vepra penale në Republikën e Kosovës.

Prandaj, Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar në parim projektligjin dhe ka konstatuar se projektligji i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Këtë e shpreh edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe vota jonë është për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve, respektivisht përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Aliu e ka kërkuar fjalën.

AGIM ALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projekt-kodin për të mitur dhe duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky projekt-kod, në mënyrë të veçantë për kategorinë që e trajton, do t'i japim mbështetje në lexim të parë si dhe do të japim kontributin në grupin punues në kuadër të Komisionit për Legjislacion që ky projekt-kod të jetë sa më i përmbushur karshi kërkesave që ia ka paraqitur vetes. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së e dha mendimin për ligjin më parë nëpërmjet zotit Zemaj.

Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari më duhet të them se e gjithë pakoja ligjore që ka të bëjë me të dënuarit, qofshin ata të rritur apo të mitur, në letër janë në përputhje me standardet evropiane, por problemi që po na

përcjell në vazhdimësi ka të bëjë me moszbatimin apo moszbatueshmërinë e këtyre ligjeve në praktikë.

Të drejtat e të miturve janë të rregulluara kryesisht në bazë të standardeve ndërkombëtare. Megjithatë, e thashë edhe më përpara, problemi qëndron te zbatimi i këtyre ligjeve.

Do të thotë, edhe kodi për të mitur, edhe ky projektligj, të cilin e ka propozuar Ministria e Drejtësisë, ne nuk jemi kundër se si janë shkruar këto kode, mirëpo ndoshta edhe ministria e Drejtësisë është në dijeni se çfarë është gjendja e të miturve, të paktën në Qendrën Korrektuese në Lipjan.

Ne sot jemi dëshmitarë të asaj se të drejtat e tyre po shkelen përditë, dhe kjo bazohet edhe në deklaratat e vetë të miturve që flasin për mungesën e kushteve për risocializim.

Do të thotë, sot në qendër të Lipjanit e kemi një psikolog dhe një punëtor social. Do të thotë, arsim jocalësor, mungesë të stafit social, por edhe kushte jo të mira të akomodimit.

Nëse qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe zhvillimin e kryerësve të mitur, atëherë si mund të arrihet kjo, përderisa ka mungesë të kushteve elementare në qendrat korrektuese.

Ndonëse edhe Kodi Penal që është në fuqi ka përkufizuar kategorizimin e statusit ligjor të personave që janë nën moshën 18-vjeçare, përkufizimet e tilla mund të shkaktojnë huti gjatë leximit të tekstit ligjor.

Do të thotë, rrjedhimisht në përkufizimin e termave që janë përdorur në këtë projekt-kod, njëjtë sikurse në Kodin Penal, të gjithë personat nën moshën 18-vjeçare konsiderohen si fëmijë. Mirëpo duhet pasur parasysh se personat nën moshën 14-vjeçare nuk kanë përgjegjësi penale, kështu që asnjëherë nuk mund të paraqiten si subjekt i të cilësdo procedurë penale.

Në këtë kuptim, përkufizimi i tillë i termit, ku përfshihen të gjithë personat deri në moshën 18-vjeçare si fëmijë, do të duhej të përkufizohej se fëmijë konsiderohen të gjithë personat deri në moshën 14-vjeçare, kështu që sa herë do të ishte përdorur termi “fëmijë”, do të ishte nënkuptuar se kemi të bëjmë me persona të papërgjegjshëm penalisht.

Tek neni 9, ku rregullohet çështja e ndërmjetësimit, është rregulluar edhe një rrethanë me rastin kur i mituri, i cili ka kryer vepër penale, pas vlerësimit të prokurorit të çështjes udhëzohen palët për ndërmjetësim.

Me paragrafin 5 është rregulluar rrethana kur palët nuk mund të merren vesh me përzgjedhjen e ndërmjetësuesit dhe me këtë rast prokurori cakton ndërmjetësuesin nga lista e ndërmjetësuesve të licencuar.

Mendoj se në këtë rast duhet të theksohet se meqenëse natyra e ndërmjetësimit kërkon pajtueshmërinë e të dy palëve, e këtu interes më të madh ka i pandehuri i mitur, nuk duhet harruar asnjëherë edhe interesin e viktimës.

Andaj duhet theksuar se prokurori para se të caktojë një ndërmjetësues, duhet të konfirmojë ekzistimin e vullnetit të palëve, sidomos duke pasur parasysh pozitën e viktimës, pa i dëmtuar interesat e të miturit në procedurë. Pra, duhet të vihet një mekanizëm, i cili do të ruante vullnetin e shprehur dhe konsistencën e atij vullneti në këtë procedurë.

Dhe, e fundit, ky projekt-kod përmban dispozita, me të cilat referohen kushte ligjore dhe formale për ndërmjetësuesin e kualifikuar për të mitur, domethënë neni 10 i këtij projekt-kodi.

Në paragrafin 5 të nenit 9 thuhet: “Prokurori do të caktojë ndërmjetësuesin nga lista e ndërmjetësuesve në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në këtë kod”.

Ligji për ndërmjetësim, i cili është në fuqi, ka rregulluar licencimin e veçantë, kjo madje nuk është rregulluar as me projektligjin për ndërmjetësim të sponsorizuar nga vetë Ministria e Drejtësisë.

Në këtë kuptim, dispozitat e neneve 9 dhe 11 janë kontradiktore dhe pa bazë të qartë ligjore.

Unë kam pasur kontakte edhe me organizata, të cilat i mbrojnë të drejtat e të miturve, ata ndonëse e mbështesin në parim këtë projektligj, kanë vërejtjet e tyre. Unë besoj që do t’i procedojnë me shkrim, por po ashtu edhe ne si grup parlamentar do t’i bëjmë disa amendamente, në mënyrë që ky projektligj të jetë sa më i plotë.

Unë po shpresoj që i njëjti do të gjejë zbatim edhe në praktikë dhe, në parim, ne si “Vetëvendosje” e përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projekt-kodin për të mitur dhe, në fakt, do ta përkrahë në parim.

Gjithë kontributin tonë do ta japim nëpërmjet përfaqësuesit tonë në komisionin parlamentar gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve nuk ka të tjerë të paraqitur.

Zoti Konjufca, je paraqitur për grupin apo ke ngelur prej më herët? Dëshiron fjalën për ligjin?
Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Desha ta marr fjalën dhe ta shfrytëzoj rastin që ky ligj është si shkas, po flas lidhur me një dukuri që po na ndodh këtu në Parlamentin e Kosovës.

Këtu nëse e analizon gjuhën shqipe, për shembull, shumë ligje të cilat vijnë në Kuvendin e Kosovës vërehet që ata të cilët janë të punësuar nga Qeveria dhe që janë ekspertë që merren me shkrimin e ligjeve punojnë me një metodë që nuk është e përshtatshme të prodhohen ligje të mira, e kjo metodë është “Googletranslate”, i thonë. Domethënë fjalët të shtihen në kompjuter, e kompjuteri t’i përkthejë automatikisht.

Për shembull, neni 32 i këtij ligji e ka një fjali, e cila në anglisht thotë kështu: “The curt may order punishment with comminute service work”, edhe kur e shohim gjuhën shqipe, “Googletranslate” ia ka përkthyer kështu: “Gjykata mund të shqiptojë dënimin urdhër me punë”. Tash këtu me “orden punishment”, domethënë e shqipton dënimin, e ka përkthyer këtu “dënimi në urdhër”. Kësi shembujsh nëpër ligjet e Kosovës, besoni a jo, kemi me qindra. I marrin ligjet e huaja nëpër shtete të zhvilluara evropiane, i marrin ligjet anglisht dhe i shtinë në kompjuter dhe me “Google translate” mendojnë që puna u krye. Kjo, së pari, nuk është në rregull, se ligjet nuk mund të përkthehen kështu. Ligjet duhet t’i përshtaten vendit ku zbatohen, duhet të kenë një përputhshmëri mes frymës institucionale, shoqërore, kulturore, një bazamenti vleror të atij vendi dhe çfarë ligjesh aplikon ai vend për vete, cilat janë më të përshtatshmet. Kjo është e para.

E dyta, një vërejtje që na ndodh këtu, sidomos me disa ligje që janë të fushës së drejtësisë.

Fusha e drejtësisë e ka edhe fjalorin e vet origjinal, ashtu si e ka fusha e mjekësisë fjalorin e vet dhe gjuhën e vet, kryesisht prej latinishtes.

Kur janë fjalët latinisht, si për shembull, “ex officio” apo shprehjet që janë tipike juridike, nuk bënë të përkthehen, se përkthimi e prish muhabetin, se ato janë terma juridikë që e kanë marrë formën e vet origjinale latine, dhe kur ti hyn t’i përkthesh edhe vetë ata terma, aty bëhet mish-mash ajo punë. Si, për shembull, në faqen 77 është neni 69, pika 9, shkon aty termi “mutatis mutandis” që është term domethënë specifik juridik, tash ky të shkon, hyn dhe thotë: “Pjesa e dytë e kapitullit XIX e Kodit të procedurës penale të Kosovës zbatohet përshtatshëmrisht në

shqyrtimin...”, i shohim aty disa tentime jo fort kreative për ta përkthyer terminin “mutatis mutandis”. Ai është term juridik, është i vulosur në gjuhën juridike, s’ke çka e përkthen atë.

Kështu që me të vërtetë, kur i lexon në gjuhën shqipe ligjet tona, definitivisht e vëren që ata që i shkruajnë ligjet te ne janë shumë të dobët.

Qeveria gjithë këtë buxhet, gjithë këto para e nuk gjen shkruer të mirë të ligjeve edhe profesionistë që e dinë punën mirë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Në fakt, jo rrallë herë neve na ndodh, kushtimisht pajtohem me Glaukun, por ligjet që vijnë nga fusha juridike janë specifike dhe përcillet gjuha juridike, sidomos kjo që ne kërkojmë të jenë në harmoni me Kodin penal dhe me Kodin e procedurës penale.

Unë po pajtohem që te neni 32 e theksoi, sigurisht i mungon një presje, por jo kuptimi, sepse ka të bëjë me “urdhër me punë”, i cili është në dobi të përgjithshëm, domethënë i mungon faktikisht një presje, por jo, nuk e humb logjikën e amendamentit edhe për të cilën është përcaktuar.

Ndërsa terminologji të tjera që shprehen në gjuhën latine janë pjesë e Kodit penal edhe çdo herë përcaktohen apo përshtaten me Kodin penal edhe me Kodin e procedurës penale.

Sigurisht që duhet të jemi ndonjëherë, jo ta quaj kështu kritik, sepse edhe vetë këtu lëshojmë, po t’i shohim komisionet funksionale kur të hartojnë amendamente shpesh e humbin kuptimin apo logjikën e përcjelljes së amendamentit të një amendament tjetër. Por, si do që të jetë, unë mendoj që kodi që ka ardhur për të mitur është një ndër ligjet më të mira që deri tani janë proceduar kohët e fundit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Unë po përsëris ato që i tha zonja Haxhiu lidhur me ligjin, por po mendoj që është vërtet shumë problematike çështja që ne, në fakt, po sjellim ligje, të cilat në një farë mënyre tregojnë drejtime, kontura të ideve dhe të çështjeve që implementohen në vende të ndryshme perëndimore, por që, në fakt, në Kosovë janë të pazbatueshme, për arsye se këto koncepte as nuk janë të njohura dhe pastaj sjellin vetëm konfuzion.

Për shembull, unë do ta përmend nenin 26, për mbikëqyrjen e shtuar nga familja tjetër. E kam bindjen që as vetë ministrja, e cila është këtu, nuk e ka të qartë se për çka është fjala.

“Gjykata shqipton masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e familjes tjetër pas dëgjimit të prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, kur prindi adoptues apo kujdestari është i paaftë për kryerjen e mbikëqyrjes së shtuar ndaj të miturit dhe kur masa e tillë është në interes më të mirë të të miturit”.

Nuk e di se a e di ministrja për çka është fjala, por unë po konsideroj që fjala është për shoqërim socio-pedagogjik, kështu një koncept bukur i njohur dhe i aplikuar në botën perëndimore, por i cili nuk mund të zbatohet vetëm kështu siç është përcaktuar në ligj, e sidomos nuk mund të zbatohet kur një detyrë edukative apo të mbikëqyrjes i jep një familjeje tjetër, sepse për të bërë një shoqërim të tillë dhe për qenë kjo në interes të të miturit, atëherë duhet të ketë profesionistë që punojnë, që e njohin këtë fushë, që kanë koncepte të caktuara, qëllime të caktuara, të cilat ky ligj nuk i rregullon.

Ligji ka mjaft kritika dhe shpresoj që gjatë punës në komisione do të ndryshojë në përmbajtjen e tij.

Po e përsëris edhe një herë, fjala është që Qeveria po na sjell ligje, të cilat po përdoren thjesht për dekor, për të thënë që i kemi, ndërsa në fakt, në praktikë janë të paimplementueshëm, sepse as vetë Qeveria dhe ata që e kanë përkthyer ligjin nuk kanë ide se për çfarë bëhet fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Bini ziles, regjia, ju lutem, të bëhemi gati për votim.

Lus që t’i zini vendet për votim, në sallë janë 66 deputetë. Votojmë tani:

Pa kartelë, për a ka pa kartelë, një. Kundër pa kartelë, abstenim a ka pa kartelë. Jo.

Atëherë kanë votuar 66 deputetë me kartelë, një pa kartelë, 67 vota janë për. Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projekt-kodin e drejtësisë për të mitur.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projekt-kodin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e tij.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Mustafa, që ta arsyetojë raportin e komisionit.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Pasi që e lexuat edhe ju, siç e theksuat, komisioni e ka trajtuar me respekt iniciativën e deputetit Muja, pasi e konsideroj se ajo trajton një çështje të rëndësishme. Komisioni ka propozuar që kjo iniciativë të mos përkrahet, të mos miratohet në parim. Ky është projektligj për ndryshim dhe plotësim, tanimë ka filluar punën një grup punues gjithëpërfshirës, ku është përfshirë komisioni, KPMM-ja, Ministria e Qeveria për hartimin e një ligji të ri dhe ky proces ka shkuar bukur shumë. Domethënë, shpejt do ta kemi versionin e një ligji të ri, ku do të trajtohet edhe kjo ide që ka të bëjë me shfrytëzimin e taniemës.

Ky propozim yni kërkoj të aprovohet nga të gjithë deputetët, për arsye se formulimet që janë në këtë, ndonëse intenca është e mirë dhe e ka përkrahur edhe komisioni, por mënyra e formulimit nuk është adekuate dhe nuk është në pajtim me Ligjin për financat publike, për çka vërejtje edhe Ministria e Financave lidhur me propozimin që kemi sot. Kështu që mendoj se kjo iniciativë do të inkuadrohet në Ligjin e ri për minierat, që është në përpunim e sipër, në mënyrë adekuate dhe në pajtim me ligjet që janë. Ju ftoj që të aprovohet propozimi i komisionit.

KRYESUESI: Atëherë, a doni të deklaroheni për mosmiratim sipas propozimit të asaj apo po e hedhim në votim menjëherë?

Zoti Shaip Muja e ke fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Arsyet pse unë e kam paraqitur ligjin janë të natyrshme, të bazuara mbi bazën e ligjeve që ne i kemi miratuar këtu në Parlament dhe në rast se ky ligj nuk miratohet, atëherë bie ndesh me dy ligje të miratuara këtu në Parlament dhe ne duhet të mbajmë seancë për zhvlerësim të neneve të ligjeve që i kemi miratuar. E kam fjalën për Ligjin për “Trepçën” dhe për Ligjin për Obiliqit.

Meqenëse te Ligji për Obiliqin, problemi që unë e kam paraqitur, nëse dy javë ditë nuk është nënshkruar nga askush është marrë vendim i plotë. Ne e kemi miratuar Ligjin për Obiliqin këtu dhe nëse nuk është nënshkruar edhe nga Presidenti pas dy javësh, ai e ka marrë formën ligjore të plotë, pavarësisht që unë kam dëgjuar se nuk është nënshkruar. Çka kam thënë unë, zoti nënkryetar?

Në nenin 65 të Ligjit aktual të Komisionit për Miniera dhe Minerale, në pikën 2, pas paragrafit 2, të shtohet një paragraf i ri, si vijon: “Ministria e Financave kërkon nga Komisioni për Miniera dhe Minerale që të japë të dhëna të detajuara tabelare për secilën njësi biznesore ku e ka inkasuar

rentën minerare dhe këtë rentë minerare në shumën prej 20% ta rialokojë në buxhetin komunal të Komunës ku ndodhet njësia biznesore e dedikuar në mënyrë specifike për mbrojtje të mjedisit, infrastrukturës, sportit, shëndetësisë dhe arsimit”.

Prandaj, unë ju njoftoj që edhe arsyeshmërinë që e ka bërë Ministria e Financave nuk e ka të bazuar, por ekziston mosinteresimi i vullnetit që kompanitë biznesore, duke filluar nga gurthyesit, ndotësit e ambientit, shfrytëzuesit e mineraleve, të lënë në buxhetin komunal 20% në secilën komunë dhe çfarë të keqe ka kjo kur është i dedikuar se çfarë qëllimi ka, për mbrojtje të ambientit, për infrastrukturë, për sport, për avancim të arsimit, por edhe për shëndetësi.

Prandaj, unë mendoj që përkundër shprehjes që më paskan bërë respekt kur e kanë studiuar, unë nuk kam nevojë që të më respektojnë, por duhet t’i interpretojmë ligjet. Ne nëse nuk e miratojmë këtë ligj, unë ju ftoj t’i analizojmë edhe ligjet tjera, të cilat bien ndesh ose në koalizion me ligjin aktual. Propozimi i kryetarit dhe i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, që po thonë “jemi duke bërë”, kjo është për të blerë kohë. Nëse mendojnë të blejnë kohë, atëherë për këtë vit ky ligj nuk do të miratohet dhe thoni “ne s’po duam ta futim në linjën buxhetore, se e kemi mbyllur linjën buxhetore, s’dimë si t’i ndajmë tjerat se jemi mësuar vetëm të mbledhim dhe vetëm të ndajmë, por jo për të planifikuar me plan strategjik”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka edhe një herë fjalën, për të replikuar.

MUHAMET MUSTAFA: Së pari të kuptohemi, thashë “respekti për idenë”. Edhe propozimi, për arsye se intenca është në rregull dhe ajo është përfshirë në Ligjin për “Trepçën”, por është përfshirë ashtu qysh duhet, jo për buxhet të Komunës, por për buxhet të Kosovës, i destinuar për nevoja të komuniteteve. Domethënë në harmoni me Ligjin për financa dhe dëshiroj edhe një herë të tërheq vërejtjen se Ligji për “Trepçën” është i zbatueshëm në tërësi dhe nuk ka asnjë ligj tjetër i cili mund ta pengojë zbatimin e tij.

Sa i përket Ligjit për Obiliqin, mendoj dhe për këtë arsye ne kemi propozuar që kjo intencë, ky propozim të përfshihet në punën e grupit punues gjithëpërfshirës për Ligjin e ri për minierat dhe mineralet. Nuk ka kuptim që ne të bëjmë ndryshime e plotësime në një ligj për të cilin veç ka filluar puna dhe është në përfundim e sipër, domethënë drafti i parë i atij Ligji të ri për miniera dhe minerale dhe kjo çështje do të rregullohet në mënyrë më precize, në mënyrë më adekuate në pajtim me të gjitha ligjet tjera dhe nuk e di pse kemi nevojë ta bëjmë këtë çështje kaq problem, aq më parë kur mënyra qysh është formuluar, po them nuk është adekuate.

Qëllimi është i mirë, por mënyra e formuluar nuk është adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja, një minutë!

SHAIP MUJA: Zoti nënkryetar dhe zoti kryetar i Komisionit,
Unë nuk e di në çfarë mënyre të formulohet ose të shtohet në ligjin aktual dhe të fillojmë që nga sot kur të miratohet të fillojë të implementohet pas dy javësh. Nëse ju bëni plotësim-ndryshim të ligjit, e kjo zgjat unë e di nga praktika sa do të zgjasë, këtë vit nuk vjen në shprehje.

Unë po them që në mënyrë shumë të shpejtë dhe ju lus deputetëve ta votoni propozimin tim, ta vëmë në votim, komunat duhet të përfitojnë nga kjo rentë minerale. Është diskutuar shumë herë edhe në vitin 2014-2015, kur e kemi miratuar, kam kërkuar, por nuk kam gjetur mbështetje, ne duhet të mësohemi që komunat të përfitojnë, sepse janë të dëmtuara direkt nga këto biznese. Meqë janë të dëmtuara duhet të përfitojnë dhe ju e dini Obiliqi, Hadja e të gjitha ato sa janë të dëmtuar dhe askush nuk është thelluar për shkak...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje ministre,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete

Dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson si shumë të rëndësishëm Ligjin për miniera dhe minerale, një ligj i cili i hap një rrugë zhvillimit të sektorit minerar, që është një segment shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Grupi Parlamentar e vlerëson edhe idenë e deputetit Muja, mirëpo ne si grup parlamentar kemi vendosur që të mos miratohet ky propozim i deputetit Muja, meqenëse komisioni parlamentar e ka në procedurë hartimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Të gjitha qëllimet, edhe qëllimi i kësaj nisme të deputetit të merret në konsiderim gjatë aktiviteteve të komisionit dhe zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit lidhur me hartimin e një ligji të ri për miniera dhe minerale. Grupi parlamentar e rekomandon që ideja e kësaj nisme të inkuadrohet gjatë këtyre aktiviteteve, ta punojmë bashkërisht një ligj të ri për miniera dhe minerale, meqenëse edhe në qoftë do të kishte pas mundësi për t'u inkorporuar kjo ide e deputetit, nuk do të ishte mirë, sepse ky ligj prej ligjit bazik ka pësuar disa herë ndryshime, është problem të zbatohet edhe në praktikë për t'u shërbyer me 3-4 dokumente, mirëpo kemi edhe çështje tjera shumë më të rëndësishme sesa ideja e taniemës për përfitimet e buxheteve komunale, të cilat duhet të hyjnë në Ligjin për miniera dhe minerale.

E ftojme deputetin dhe cilindo qoftë deputet të Parlamentit të Kosovës që t'u bashkëngjitet aktiviteteve të komisionit dhe grupit punues. Ne si grup punues veç e kemi në përfundim draftin

e parë të hartimit të këtij ligji, të cilit draft ia kemi dhënë formën gjatë një punëtorie që ka qenë javën e kaluar. Prandaj, edhe një herë, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që të mos miratohet ky propozimligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja prapë replikë, meqenëse ia ka përmendur emrin.

SHAIP MUJA: Faleminderit! Unë nuk desha të replikoj, por kur e pash Zenunin duke qeshur, meqë e di që s'është biseduar fare në grup parlamentar kjo punë, atëherë vendosa të reagoj.

Unë po ju thërras ta votoni ligjin dhe nuk është interpretimi ashtu siç po thotë Komisioni për Zhvillim Ekonomik se ka implikime. Në të kundërtën, Qeveria nuk ka vullnet. Bile Zenun, së paku prej 16 janarit as unë s'jam i njoftuar, as nuk keni diskutuar në grup, sipërfaqësisht keni diskutuar, por nuk keni qëndrim të qartë, keni difuz. Politikat e financave nuk preken, por nuk ekziston vullneti që komunat të përfitojnë dhe komunat duhet të përfitojnë, kështu që zoti kryesues hidhe në votim edhe propozimin tim, ndërsa komisioni këtu le të vazhdojë të punojë, ndërsa unë do të jem ndihmesë në komision dhe do të vij edhe aty ta jap një kontribut nëse di të orientohemi në atë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka kërkuar fjalën për replikë ose sqarim.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit!

Më shumë është sqarim, meqenëse është në procedurë ku mund të kyçet ende zoti Muja, është për t'u admiruar angazhimi i deputetit Muja edhe në këtë projektligj, edhe në projektligjet tjera.

Ne e prezantuar nëpërmjet deputetes sonë të nderuar qëndrimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, mendoj që ka kohë që brenda kësaj periudhe të trajtimit të këtij ligji të merren edhe idetë tjera të trajtohen. Si grup parlamentar ne nëpërmjet zonjës Sala Berisha-Shala e dhamë qëndrimin tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Blerim Grainca.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë nismë dhe në parim të gjitha nismat, të cilat i kontribuojnë zgjedhjes së këtij problemi janë të mirëseardhura. Mirëpo, meqenëse Komisioni për Zhvillim e ka krijuar një grup, i cili është duke punuar në hartimin e Ligjit për miniera, atëherë mendojmë se ne nuk duhet të krijojmë dy gjëra paralele në të njëjtën kohë.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës e mbështet qëndrimin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe ju fton që të votojmë kundër kësaj nisme të zotit Muja, me arsyetimin se ligji

është duke u bërë dhe të gjitha çështjet që janë ngritur mund të inkorporohen në ligj. Pra, ju ftojme të votoni kundër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shukri Buja e ka kërkuar fjalën.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Po që se dëshironi ta shihni se sa e nevojshme është që të ndahen 20% e mjeteve për komunat, shkoni në ato vende ku shfrytëzohet guri, ku shfrytëzohet minerali, ku ka miniera. Shkoni në Gadime dhe shihni çfarë pluhuri bëhet, shkoni atje dhe shihni sa dëmtohen rrugët, shkoni shikoni çka bën “Ferronikeli” në Magure, shkoni shihni dëmtimet që ua bëjnë komunave dhe ata që janë në komuna, që i udhëheqin komunat e dinë se sa me vështirësi përballen me qytetarët për shkak të dëmit që u krijohet nëpër komuna.

Dhe komunat i kanë kompetencë kryesisht rrugët lokale, i kanë kompetencat për rehabilitimin e atyre rrugëve dhe u krijohet problem. Pse duhet të përkrahet Ligji për Obiliqin, e të mos përkrahet ky ndryshim i ligjit për t’u përkrahur komunat me 20%? S’ka asgjë në kundërshtim, është i njëjtë, si me Ligjin për shfrytëzimin e pyjeve, meqë ndahet 25% për komunat nga shfrytëzimi i pyjeve shtetërore dhe nuk e di pse të neglizhohet kjo punë kur mund të harmonizohet, s’bie në kundërshtim kurrë me iniciativën që e paskan marrë për ndryshimin apo për plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe të inkorporohet pastaj. Në qoftë se s’është në kundërshtim, pse të mos e përkrahim sot, pse ta neglizhojmë për nesër?

Duhet ta përkrahim, sepse komunat kanë nevojë për t’i përkrahur me fonde për rehabilitim të rrugëve, për dëmet në ambient, për gjithë infrastrukturën që e dëmton në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shqip, prapë kundër-replikë? Replikë, ok!

SHAIP MUJA: Unë po mendoj që nuk kanë hyrë ta analizojnë thellësisht as grupet parlamentare, dhe nuk ka asnjë gjë të keqe të votohet dhe të përfitojnë komunat që janë direkt të ndotura nga këta operatorë ekonomikë me 20%: Drenas, Lipjan, “Sharrçemi”... tjerat ku bëjnë në Podujevë, të gjitha... në Prizren, të gjitha ku përdoret dhe kontaminohet ambienti.

Prandaj, unë nuk e di pse po e komplikojnë. Arsyeshmëritë që po mundohen të japin, se Ministria e Financave prishë, bie ndesh me ligjin, unë thashë, në standardin që ua ka lënë “temple”-tin UNMIK-u duhet ndërruar atë punë. Janë mësuar t’i kapin “cut and paste”, mblidhni para sa të mundni pastaj po i ndajmë ne. Jo! Duhet t’i marrë edhe buxheti komunal që t’i investojë vetë.

KRYESUESI: Atëherë, fjalën e ka... replikë zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Unë mendoj se ne këtu jemi. Nuk di pse po diskutojmë! Faktikisht, Komisioni për Zhvillim Ekonomik për herë të parë, ndoshta në rajon, edhe në krejt anëtarët në mënyrë unanime, pa marrë parasysh të cilës parti janë, ndoshta në rajon për herë të parë kanë diskutuar që një pjesë e tantimës të përdoret për nevojat e komunitetit minerar për këto destinimi, që kanë hyrë në Ligjin e “Trepçës”.

Prandaj, s’kemi këtu çka të bindemi. Është një zgjidhje shumë e avancuar. Tash, të merret ajo dhe të thuhet jo komunave e t’u japim komuniteteve, kjo çështje duhet të diskutohet. Në Ligjin e “Trepçës” është “komuniteti”, jo me shkuar në buxhet të komunës, se në buxhet të komunës mund të përdoret për gjithçka tjetër.

Më fal, të lutem, domethënë Ligji i “Trepçës” është dashur të shkojë në “komunitetet minerare për nevoja të arsimit, infrastrukturës, shëndetësisë... e të gjitha këto”. Prandaj, këto janë çështje që janë të rregulluara me atë ligj, do të diskutohet në komision, nuk ka... unë në mënyrë unanime komisioni është që një pjesë e tantimës edhe për gurëthyes, që tha Buja, edhe për krejt, për të gjitha minierat, të përdoret për komunitetet minerare për t’i zgjidhur problemet atje.

Prandaj, nuk kemi nevojë ne këtu ta bindim njëri tjetrin, as të bëjmë diskutime për të cilat, mendoj se nuk po mendojmë shumë ndryshe, por duhet vënë në rrugë të drejtë dhe zgjidhur në mënyrë parimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Besim Beqaj e ka fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Dua të bëj një sqarim, sepse është krijuar përshtypja që dikush është për të ndarë mjete të caktuara për ndotje të ambientit dhe të tjerët janë kundër. Ky pozicion nuk qëndron. Dua ta sqarojmë këtë çështje shumë hapur.

Të gjitha komunitetet ku shfrytëzohet resursi minerar do të jenë përfitues në harmoni me ligjet. Nisma që e kemi para vetes nuk u siguron komunave që këto mjete t’i shfrytëzojnë, sepse është në kundërshtim me Ligjin për financat publike. Ligji për financa publike është ligj i cili mbizotëron të gjitha ligjet tjera, të cilat bëhen në Republikën e Kosovës, sa u përket çështjeve financiare.

Dhe, nëse zoti Muja dhe kushdo qoftë, dëshiron që këtë çështje ta bëjë në të mirë të drejtpërdrejtë të qytetarëve, duhet që ta ndryshojë Ligjin për financa publike, në mënyrë që ai të hyjë në fuqi. Edhe Ligji për Obiliqin që është bërë nuk ka qenë në harmoni dhe për këtë arsye nuk është në funksion e sipër. Pra, duhet të jemi të ndershëm para qytetarëve. Ne të gjithë e kemi synimin, që të gjithë atyre qytetarëve ku shfrytëzohet resursi minerar t’u japim krejt meritat të

cilat i caktojnë dhe këto mjete të shkojnë në destinimi të caktuar për ambient, sport, rekreacion dhe gjëra që përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre, por kjo nismë aktuale nuk e ndihmon. Kjo nismë aktuale është vetëm sa për sot, për të kaluar këtu, dhe si pjesë përbërëse e grupit, unë po ju them që kjo çështje do të trajtohet në harmoni me ligjet dhe kjo çështje do të rregullohet në kuadër të Ligjit të ri për miniera dhe minerale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Qerim Bajrami.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedavajući!

Dakle, smatram da je predlog gospodina Muje dobrodošao, jer se radi o mnogim i rudnicima i majdanima po opštinama na Kosovu, između ostalih i opštine iz koje ja dolazim, iz Prizrena i mislim da je ovaj predlog zakasnio, jer ako je već neko trebao da inicira trebala je sama Komisija za ekonomski razvoj da ovo odavno reši i ministarstvo, a ne da i dalje odlažemo ovo pitanje.

Dakle, oni govore o tome da će raditi po ovom pitanju ali ne kažu kada će ka završiti. A u međuvremenu svaki dan se ti majdani koriste, svaki dan čine štetu sredinama u kojima se koriste a ni opštine, ni lokalne sredine gde se nalaze ti majdani, nemaju od toga bukvalno nijednog centa.

Prema tome, slažem se i sa ovim predlozima da treba izmeniti i Zakon o javnim finansijama, u redu je ali zašto onda nije inicirano da se to izmeni, jer kao što sam rekao, lokalne sredine od toga nemaju ništa.

Također, podržavam mislim da je gospodin Buja zastupnik bio jasan oko ovog pitanja i mislim da je suština problema u ovom da lokalne zajednice, odnosno opštine nemaju od toga ništa i da treba da imaju minimum taj 20%. Normalno, da opštine kasnije vide u kojim se to sredinama crpe ti majdani i zloupotrebljava se sredina i da normalno te sredine dobijaju najviše. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Avdyl Imeri e ka fjalën.

AVDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Mendoj se ne duhet përkrahur iniciativën e deputetit Muja dhe mos ta shikojmë se kush e ka bërë iniciativën, me qëllim që komunat të jenë përfituese të kësaj tanieme. Ajo që është e rëndësishme, këto komuna të shfrytëzojnë këto mjete për infrastrukturë, sport dhe rekreacion, sepse kanë nevojë për investime të tilla, prandaj ne duhet përkrahur këtë nismë me qëllim që të bëjmë ndryshimet e nevojshme dhe qytetarët e këtyre komunave të përfitojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Berisha, e keni kërkuar fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Po nënkryetar, faleminderit!

Kam diskutuar, por po dua ta bëj një sqarim si iniciuese e plotësimit dhe ndryshimit të kësaj nisme ligjore dhe si kryetare e Grupit Punues për Hartimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Ju lutem,

Nuk kisha pasur dëshirë që deputetët për çështje të caktuara, pa keqkuptim, ta përdorin foltoren e Kuvendit tani sikur jemi në prag të një fushate.

Asnjë deputet mendoj se nuk është këtu që të mos përfitojnë komunat në çfarëdo mënyre, sepse ne së pari bazën e kemi te komunat e pastaj jemi në Parlamentin e Kosovës, po gjithsesi duhet t'u kujtohet deputetëve, se me Rregullore të punës së Kuvendit edhe në qoftë se, ne jemi të parët ata që duhet t'i respektojmë rregullat dhe ligjet të cilat vetë i kemi miratuar në këtë Kuvend.

Më lejoni ta sqaroj, ne proceduralisht këtë çështje, cilido deputet që merr nismën në Kuvend, proceduralisht duhet ta çojë në Kryesi të Kuvendi, Kryesia e Kuvendit ta miratojë dhe ta procedojë për Qeveri. Të njëjtin hap e ka ndjekur edhe deputeti Muja për ndryshimin e Ligjit për miniera dhe minerale. Pastaj, pas këtij hapi duhet të shkohet në Qeveri dhe Qeveria ta japë mendimin e vet, se a i prishë politikat zhvillimore të planit të Qeverisë apo jo dhe t'ia kthejë një përgjigje Kuvendit.

Këtë hap Qeveria, domethënë pasi që e ka marrë propozimin e deputetit Muja, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përkatësisht Qeveria e Kosovës, e ka kthyer një përgjigje dhe ka thënë: "le ta shqyrtojë Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik këtë nismë dhe le ta vlerësojë, se a do ta fusë në nismën që e ka filluar hartimin e ligjit të ri apo çka do të vendosë."

Komisioni unanimisht ka vendosur që edhe këtë propozim, po edhe propozimet tjera, që lidhen për Ligjin për miniera dhe minerale t'i bashkëngjiten grupit punues, që është miratuar në komision për hartimin e ri të Ligjit për miniera dhe minerale. Prandaj, jemi në këtë pikë. Sot, nuk ka asnjë kuptim të miratohet siç po i dëgjoj disa deputetë e ata deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës nuk e di a kanë qenë atë ditë në grup apo s'kanë qenë, që është marrë vendim të mos miratohet kjo nismë, se proceduralisht duhet të hyjë në seancë, po seanca duhet thënë "jo", sepse është në rrugë ligji i ri për miniera dhe minerale.

Prandaj, nuk është mirë që të dalim jashtë rregullores e punës së Kuvendit dhe kujt t'i kujtohet diçka, qoftë ajo edhe pozitive, ta bëjë një nismë tjetër dhe të ndërhyjë në ndërkohë në punën e një komisioni që është përgjegjës për këto çështje.

Kështu që, mos ta keqinformojmë opinionin, për të mos thënë vrazhdë, mos ta manipulojmë opinionin, sepse asnjë deputet nuk është këtu që të mos ketë komuna buxhet dhe të mos përfitojë nga ato operime minerare, se ka shumë nevojë dhe është shumë e arsyeshme të përfitohet, por

kjo është një ndërhyrje, është një shkelje e rregullave të punës të Kuvendit. Prandaj, edhe unë sot ju ftoj, që të mos e miratoni ligjin, ose pikën që e kemi në rend dite, të gjitha nismat tjera t'i bashkëngjiten grupit punues për hartimin e Ligjit për miniera dhe minerale dhe mos ta paragjykojmë se çfarë do të vendosë grupi punues, a është për ta ndarë tani për tani për komuna apo s'është për ta ndarë. Kjo është krejt një çështje tjetër që sot s'kisha pasur dëshirë të merrem.

Edhe njëherë, ju ftoj të nderuar deputetë, t'i lëmë, se është herët koha për të bërë fushatë, t'i lëmë këto gjëra dhe ju ftoj të mos e miratoni, sepse ndërhyjni në procedurën dhe s'keni mundësi të depërtoni më tutje në këtë ligj, ndërhyjni në procedurën e ligjit që është hartuar drafti i Ligjit për miniera dhe minerale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Armend Zemaj dhe i fundit është Enver Hoti, pastaj Shaipi e ka fjalën. Mos u paraqitni të tjerët se s'jua jap fjalën, të ndikuar nga diskutuesit.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e mora fjalën, sepse kohë pas kohe i kam shprehur disa shqetësime, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit dhe që ndërlidhet edhe me temat që po i diskutojnë kolegët e mi, sidomos Komisioni Funkcional.

Sinqerisht, nuk është keq të debatojmë, të shohim edhe mundësitë, përparësitë po edhe dobësitë e këtij procesi dhe ajo që po kërkohet. Mbi të gjitha, Kuvendi mund të vendosi, nuk është aq i ngurtë edhe me ndryshimet legjislative po edhe me raportet me Qeverinë. Por, unë e kam një shqetësim, po e shpreh kështu kushtimisht, sepse më shumë po debatohet për një amendament, se sa kur është debatuar për vetë raportin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe kjo është për të ardhur keq. Pse po e them? Sepse, derisa ne po debatojmë për çështje të tilla, ambienti në Republikën e Kosovës është duke u shkatërruar skajshmërisht.

Dhe tash, ndoshta nuk është edhe temë tabu të flasim, se jo rrallëherë edhe këtu ndërthehen interesa të ndryshme, duke marrë parasysh shumë njerëz dhe individë, që kanë vetë gurëthyes apo edhe ato aferat e mëdha korruptive, qoftë nga "Ferronikeli" deri te pjesa perëndimore e Republikës së Kosovës.

Kështu që, besoj se komisioni duhet të jetë më konkret në mbikëqyrjen e kësaj dukurie, që është duke e shkatërruar Kosovën, unë po flas për një temë, ndoshta është lokale, por që e kam shprehur në vazhdimësi dhe asnjëherë nuk është duke u marrë një iniciativë, shkatërrimi shtratit të lumit Lumbardhë të Deçanit. Edhe atëherë është thënë, se është në interes të komunitetit lokal.

Po ju them, me sinqeritetin më të madh, edhe ata që e kanë përcjellë, se asnjë interes nuk ka përfutur komuniteti lokal, ka përfutur një grup i ngushtë kriminel, ta quaj, i cili e ka keqpërdorur dhe vazhdon ta keqpërdorë atë pjesë për interesa dhe në favore të ngushta të

individëve. Edhe sot e asaj dite, veç është duke u shkatërruar Deçani, është duke mbetur pa ujë, ndërsa Komisioni i Pavarur për miniera dhe njerëzit individë merren edhe me tema, që nuk e rregullojnë këtë sferë dhe këtë fushë.

Kështu që, sa herë që po debatojmë për çështje të tilla, diku po ngërthehen këto interesa personale, fatkeqësisht, t'i theksojmë sepse i kemi parë, i kemi përcjellë, nuk është se nuk janë diskutuar në Kuvendin e Kosovës, por komisioni duhet ta rrisë mbikëqyrjen dhe të thërrasë në raport në Komisionin e Pavarur për Miniera e Minerale më shpesh dhe të përcjellë edhe ndryshimet legislative.

Unë besoj dhe shpresoj që edhe ky ndryshim do të duhej të diskutohej. Nuk është keq që komunat përfitojnë, sepse pikërisht janë ato që po dëmtohen, dikush po i thithë ato të mira materiale dhe qytetarët e pjesëve lokale asnjë cent nuk po e përfitojnë. Edhe po e humbin natyrën, edhe po thithin ajër të papastër, edhe po u shkatërrohen, edhe në brendësi të fshatrave, edhe afër qyteteve, edhe bile-bile tash këto ndryshimet e transformimet e pronës komunale po ndodhin në harmoni të plotë, kur po kanë me Qeverinë, me AKP-në dhe me institucionet tjera, ndërsa është e pamundur për ne sot, që një 20%-sh të mos u ndahet komunave.

Kështu që, po më duket se po fshihen problemet e mëdha pas iniciativave të vogla, që do të përfitonin qytetarët direkt edhe në aspektin lokal, pa e prishur strukturën e Buxhetit Qendror të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni e ka marrë një qëndrim dhe ka shfaqur një propozim këtu, që të miratohet dhe hartohet një ligj i ri për këtë çështje, po ajo që pamë në këtë debat është interesant të trajtohet dhe ne e dimë, kemi pasur në komision edhe raportin e punës së minierave dhe mineraleve të komisionit dhe kemi parë shumë parregullsi aty. Kemi parë shfrytëzimet që nga keqpërdorimi i dhënies së licencave, i marrjes dhe përdorimit të tyre, e deri te shfrytëzimet që u bëhen operatorëve nga punëtorët e ndryshëm, sidomos nëpër nivele lokale, ku goditen direkt qytetarët me shfrytëzimin e këtyre mineraleve në formë të parregullt, pa kurrfarë kriteri dhe ajo që dëgjuam këtu, disa iniciativa, pajtohem me zotin Zemaj, që tha ndoshta shumë të vogla, por minore për t'u fshehur dëmet që i shkaktohen vendit edhe në ambient, edhe në aspektin financiar, janë të paarsyeshme. Na u zgjat pak se kemi shumë grupe brenda një grupi parlamentar apo po fillojnë fushatat, ndoshta edhe për kryetarë komunash tani, por mirë është t'i qasemi problemit seriozisht dhe të përkrahen idetë, të cilat janë në funksion të një rregullsie ligjore që duhet ta ketë. Të tjerat le t'i bartë secili dhe le t'i zgjidhë në shtëpinë e vet dhe të mos ballafaqohet Kuvendi, të mos i nënshtrohet një debati të tillë, aspak korrekt, dhe mendoj krejtësisht shterpë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Shaip Muja! Të lus, Shaip, mos repliko! Sqaroje pse duhet të mbështetesh dhe pastaj vota e deputetëve është përcaktuese. Pra, s'ke punë me diskutues të tjerë! Pas Shaipit nuk jua jap fjalën, sepse e keni kryer.

SHAIP MUJA: Unë dola t'ju shoh kështu, se nga mbrapa po më duket sikur nuk po skuqeni.

Propozimi im nuk është elektoral, sepse nuk i dihet a marr pjesë në elektorat më, por është i bazuar, është ligjor, prandaj kur e kemi miratuar Ligjin e Trepçës askush nga ju këtu nuk keni dalë të thoni që neni i tantimës të kundërshtohet. As ju, komisioni, e as ju disa që po e kundërshtoni këtë propozim.

Pse nuk e kundërshtuat atëherë? Nuk jam duke bërë fushatë. Duhet të përfitojë Drenasi. Po, nëse kontaminohet, duhet të përfitojë. Nëse ata tankerë e dëmtojnë rrugën vazhdimisht dhe s'i monitoron kurrkush, o duhet paguar "Ferronikeli", o duhet t'i paguajë me tantimë dikush. Ose, këta gurthyes që ua plasin shtëpitë, sikur që po i shohim në televizor. Dikush duhet ta paguajë atë faturë.

Prandaj, unë te ligji i financave, që e tha dikush këtu, dhe për të mos ia përmendur emrin për replikë. Është procedurë kjo. Po doni të gjuani hi syve. Kur doni ta bëni një ligj, normalisht se duhet të procedohet. Mos i shpjegoni procedurat e Parlamentit, shpjegoni çka ka thënë Qeveria. Qeveria ka thënë: "S'po dua të merrem hiq me këtë punë, sepse e kam më lehtë t'i mbledh paratë dhe unë i ndaj qysh dua vetë". Ndërsa Komisioni për Buxhet e Financa, në çdo ligj duhet ta japë edhe komentën e vet.

Dhe, Komisioni për Buxhet e Financa, kur kemi debatuar mbi një vit, komisioni ynë për mbrojtjen e ambientit, dhe ju e dini fort mirë, ne kemi kërkuar, apo unë së paku kam kërkuar të mos vijë hiq Ligji për Obilëqin. Nuk ka pasur vullnet as Qeveria, e as komisionet e tjera, të merren me këtë.

Kur e kemi aplikuar ligjin kanë filluar komentet dhe e kemi miratuar atë ligj këtu. Dhe, kur e kemi miratuar Ligjin e Trepçës, në nenin, s'po më kujtohet...

Këtu tha 'komuniteti mineral'. Çfarë zbulimi fantastik-shkencor. Studentëve t'u thuhet ajo marre është, s'ka komunitet mineral.

(Ndërhyrje)

Jo, nuk është ajo. Studentëve u jap 5-she unë që s'jam hiq në Ekonomik. Nuk ka komunitet mineral. Mos bëni hajgare. Ka komunitet shqiptar, serb, rom, hashkali dhe të tjerë me radhë.

Prandaj ti nuk mund të thuash 'komuniteti minerar'. Çka? I paske certifikuar ti se ata qenkan në miniera dhe me këtë minatorëve po u jep 20%, e jo popullatës.

Unë po them, te kjo që po kërkoni të aplikohet. Unë s'po ju pengoj për ta ndryshuar ligjin për Komisionin për Miniera e Minerale. Është standard i "acquis communautaire" të Evropës, me standarde të Bashkimit Evropian, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në shumë Shtete të Bashkuara të Amerikës 80% paguajnë për komunitetin, jo 20%.

(Ndërhyrje)

Po edhe kjo është e dalluar, zoti kryetar, kush përfiton! Në komunë janë komunitetet, nuk janë 'ufot', prandaj unë ju kërkoj, zoti kryetar, ta nxirrni në votim propozimin tim.

KRYESUESI: Të lutem, diskuto dhe bindna të votojmë, mos u merr me atë kush çka thotë prej vendit.

SHAIP MUJA: Po, nuk është terminologjia. Unë nuk e kam bërë këtë për fushatë. Doni ta votoni, urdhëroni! S'doni ta votoni, unë jam plotësisht dakord me Shukri Bujën, konkludimet e tij, urdhëroni e i arsyetoni edhe para opinionit, por mos spekuloni për vota. Po, i kam thënë unë komunitetit në Drenas: "Do të luftojmë ta shtimë, nëse ka përfituar Obiliqi, përfiton edhe Trepça. Do të përfitojë edhe "Sharrceci", ai komunitet atje". Por do të përfitojë edhe Drenasi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E vë në votim Shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale, i ndryshuar dhe plotësuar.

Si duket nuk ka kuorum! A ka ndokush jashtë nga deputetët, që duhet të votojë?

Nuk ka të tjerë, a?

Atëherë, tani kemi kuorumin. E kemi dëgjuar propozimin e komisionit që të mos votohet. Pra, kemi Komisionin Funkcional, e kemi propozimin me arsyetimet që janë dhënë dhe i kemi dëgjuar të gjithë. Edhe mendimin e deputetëve që janë për dhe kundër, edhe të zotit Muja.

Pra, e hedh në votim projektligjin. Ata që janë për ta votuar propozimin e zotit Mustafa si kryetar i komisionit, votojnë kundër. Ata që janë për ligjin, votojnë për dhe e kryejmë këtë punë.

(Ndërhyrje)

Jo një herë ashtu, e një herë kështu s'ka. Është kjo një çështje dhe nëse kalon, kalon. Dhe, nëse kalon, atëherë s'kemi pse ta votojmë propozimin e Mustafës.

I pari del propozimi i zotit Muja, projektligji.

Të përgatitemi për votim dhe e votojmë tani projektligjin e propozuar nga zoti Muja.

Si duket nuk ka kuorum, nuk votojnë të gjithë.

Atëherë, e votojmë propozimin e zotit Mustafa.

A doni ta përsëritim votimin edhe një herë?

Atëherë, meqenëse s'ka kuorum, e lëmë të pauzojë në përputhje me vendimin e Kryesisë.

A doni të marrim pushim për drekë? Atëherë, shkojmë në pauzë të drekës deri në orën 15:00.
Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Ndoshta na dëgjojnë që po fillojmë dhe vijmë të tjerët.

Ne po fillojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, e për pikat për të cilat nuk kemi kuorum, vazhdojmë me të tjerat derisa të bëhet kuorumi, dhe i votojmë pastaj përnjëherë të gjitha.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë

Komisioni Funkcional për Legjislacion ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhetë arsyetojë projektligjin. Zonja Hoxha, e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë.

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe ka për qëllim avancimin e legjislacionit të fushës së trashëgimisë, për më tepër nëpërmjet këtij projektligji synojmë:

- T'i eliminojmë pengesat, të cilat janë hasur gjatë zbatimit të ligjit ekzistues dhe harmonizimin e dispozitave të caktuara për këtë ligj me Ligjin për procedurën jokontestimore dhe noteri.

- Do të forcohet roli i gruas në trashëgimi, duke afuar mundësi të trajtimit të çështjeve trashëgimore dhe të bashkëshortëve jashtëmartesorë.

- Lëndët e natyrës trashëgimore do të trajtohen dhe zgjidhen në një afat më të shkurtë, ngase në kuadër të këtij projektligji janë rishikuar dispozitat që u referohen afateve, gjë që konsiderojmë se do të ndikojë pozitivisht në ngritjen e efikasitetit të organeve kompetente në trajtim dhe zgjidhjen e këtyre lëndëve trashëgimore.

- Po ashtu synojmë ngritjen e sigurisë juridike për qytetarët sa i përket trajtimit dhe zgjidhjes së lëndëve të natyrës trashëgimore nga ana e noterëve, si mundësi e ofrimit të shërbimeve më të shpejta.

Ky projektligj i ka kaluar të gjitha fazat e konsultimeve, sipas dispozitave për hartim të legjislacionit dhe i është bërë edhe vlerësimi i ndikimit financiar, si dhe është konstatuar se është në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Prandaj, ju ftoj që ta miratoni në lexim të parë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për trashëgimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Fjalën ia kalojmë nënkryetares së Komisionit Funkcional, zonjës Selviqe Halimi, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2017 ka shqyrtuar projektligjin dhe i rekomandon Kuvendit që të aprovohet në parim Projektligji për trashëgiminë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve ose e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së është paraqitur zoti Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

E nderuar ministre e Drejtësisë, zonja Hoxha,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë dhe e vlerëson të një rëndësie të veçantë në kuadër të pakos ligjore të reformave që janë duke u bërë në sistemin e drejtësisë.

Me këtë projektligj do të eliminohen mosharmonitë mes ligjeve ekzistuese, pengesat edhe vështirësitë në zbatim.

Po ashtu me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë e Kosovës do të bëhet autorizimi i noterëve në përfundimin e disa funksioneve në trashëgimi, si ulja e afatit për njohjen e trashëgimisë në mes të bashkëshortëve jashtëmartesorë.

Në këtë projektligj është fshirë dispozita për parashkrimin e të drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore.

Risi tjetër është edhe përfshirja e organit të kujdestarisë në dhënien e lejes sa i përket heqjes dorë në emër të të miturve.

Ky projektligj paraqet një ndër angazhimet e drejtpërdrejta për avancimin e infrastrukturës ligjore me qëllim të eliminimit të mosharmonisë me ligje të tjera, me qëllim që institucioneve të drejtësisë t'u ofrohet lehtësimi në punë dhe uljen e ngarkesave në gjykata, respektivisht në punën e tyre, e që tashmë është prioritet i Ministrisë së Drejtësisë.

Prandaj, duke parë rëndësinë e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështesë dhe fton deputetët e Kuvendit të Republikës që ta votojnë në lexim të parë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ademaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë dhe propozimet për këtë plotësim- ndryshim të ligjit vijnë nëpërmjet 10 neneve, që kryesisht kanë të bëjnë me bartjen e kompetencave nga gjykata te institucioni i noterisë, me qëllim të zbrazjes së gjykatave nga lëndë të tepërta dhe gjithashtu ka disa ndryshime në afate që mendojmë se janë ndryshime substanciale dhe të një standardi më të lartë.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim projektligjin dhe i ftojme kolegët që i njëjti të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja “Vetëvendosje”, kush e ka fjalën, zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit! Para se të flas për plotësim-ndryshimin e këtij projektligji, më lejoni t'i jap disa të dhëna se sa është zbatuar i njëjti, i cili flet për trashëgiminë dhe pronën, e ku sfida kryesore e zbatimit të këtij ligji është në fakt dhe zbatimi i tij, sidomos për gratë dhe vajzat, të cilat pavarësisht se ligji ka konstatuar të kundërtën, në vazhdimësi për shkak të traditës, për shkak të kulturës, për shkak të dokeve dhe zakoneve heqin dorë nga prona dhe trashëgimia.

Në vitin 2012 realisht në Kosovë kemi pasur një gjendje kur vetëm 2% e grave dhe e vajzave kanë poseduar pronë, qoftë shtëpi, banesë ose tokë bujqësore.

Sot kemi një gjendje tjetër, do të thotë kemi 3% më shumë, që po i bie që më shumë se katër vjet prej kur e kemi konstatuar herën e fundit këtë statistikë, kemi një përmirësim prej 3%, që i bie se

nëse vazhdojmë me këtë dinamikë të zbatimit të këtij ligji, Kosovës do t'i duhen 133 vjet që këtë ligj ta zbatojë në tërësi. Do të thotë, këto janë dinamikat me të cilat ne funksionojmë dhe i zbatojmë ligjet edhe arrijmë progres.

Pikërisht atë vit, do të thotë në vitin 2012, më 9 mars ka qenë një rezolutë e Grupit të Grave Deputete aso kohe, e cila është përkrahur nga shumica e deputetëve dhe kjo rezolutë, të cilën e kam me vete, ka paraparë tetë pika. Në mesin e tyre ka paraparë nëpërmjet zbatimit të këtij ligji dhe aso kohe fondeve substanciale të përmirësohet kjo gjendje e rëndë, ku gratë përtej asaj që jetojnë në varfëri ekstreme që janë të goditura nga papunësia, nga mungesa e përkrahjes në arsim, nga mungesa e qasjes në drejtësi, në fakt, kanë qenë edhe më të varfra, sepse kanë poseduar vetëm 2% të pronës.

Pothuajse asnjë nga këto pika, do të thotë nga këto 8 pika të kësaj rezolute nuk është zbatuar, e ne jemi tash 5 vjet më vonë, më 2017.

Prandaj, para se të jap rekomandimet në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për disa ndryshime, për të cilat kërkoj edhe përkrahjen tuaj, deputetë. Kisha dashurtë kërkoj që tani pasi jemi në një fazë të rëndësishme, kur Kosova ka nënshkruar MSA-në dhe kemi një numër të caktuar, një shumë të caktuar të IPA fondeve të parapara për demokratizim që nëpërmjet programeve qeveritare të kemi një aplikim dhe qasje në këto fonde për zbatimin pikërisht të këtij ligji. E ka bërë Kroacia, ku nëpërmjet subvencionimit të kolatoralit të grave të cilat kanë poseduar pronë, respektivisht kanë pasur ndërmarrje ose kompani të ndryshme private ose biznese të ndryshme, ose artizanale, ku gratë tona janë të njohura, në fakt, janë subvencionuar jo prej buxhetit të Kosovës, se edhe kështu buxheti nuk mjafton për nevojat e qytetarëve, por pikërisht nëpërmjet këtyre programeve, të cilat janë të parapara për demokratizim dhe zhvillim, dhe kjo është demokratizim. Në fakt, janë sjellë miliona euro në vend dhe ka ndryshuar kjo.

Brenda 4 vjetëve Kroacia ka bërë një ndryshim substancial sa i përket zbatimit të ligjit përkatës.

Mendoj që nëse e kemi seriozisht, e jo vetëm sipërfaqësisht, të bëjmë në vazhdimësi ndryshime të projektligjeve, të cilat nuk zbatohen asnjëherë.

Ne duhet t'i përcjellim këto projektligje dhe këto ligje tanimë, besoj që do të kalojë i njëjti, edhe me programe të ndryshme të ekzekutivit, të cilat do të mundësojnë zbatimin e të njëjtëve.

Tash, nëse me lejoni, do të paraqes disa amendamente dhe disa të dhëna, të cilat pres që do t'i përkrahni dhe do ta kemi një ndryshim, i cili do të mundësojë edhe zbatimin dhe të arritura pak më konkrete sa i përket këtij projektligji.

Kosova ka tash vetëm 5% të pronave të regjistruara në emër të grave.

Të drejtat e barabarta të grave në përgjithësi dhe në trashëgimi janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për trashëgimi, Ligjin për procedurë jokontestimore dhe Ligjin për procedurë kontestimore.

Megjithatë dhe pavarësisht ekzistencës së një kornize ligjore, për shkak të traditës popullore, ndarja e pasurisë kryesisht bazohet në të drejtën zakonore.

Në disa vende, kryesisht për shkak të Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe gratë rrjedhimisht asnjëherë nuk e realizojnë të drejtën e tyre të shfrytëzojnë pronën dhe trashëgiminë.

Hapësira që krijon ligji, duke mundësuar marrëveshjen e palëve dhe mundësinë e heqjes dorë nga trashëgimia, bëjnë që palët të merren vesh mes vete, e që në praktikë i bie që gratë dhe vajzat të zhveshën komplet nga trashëgimia dhe prona.

Duke marrë për bazë të drejtën e garantuar me Kushtetutë dhe neni 72, duke marrë përsipër garantimin e të drejtave sipas konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare, pjesë e Kushtetutës, siç është Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për trashëgiminë dhe propozon këto amendamente:

-Neni 13.1, kur një nga fëmijët ka vdekur, para trashëgimlënësit në vend të tij hyjnë në zëvendësim fëmijët e tij dhe bashkëshortja, pra të shtohet fjala “bashkëshortja”, e kur edhe te të porsalindurit për shkaqet e parapara me ligj nuk mund të jenë trashëgimtarë, hyjnë në trashëgim të porsalindurit e tyre pa kufizim.

- Neni 28.2 duhet të hiqet, sepse bie ndesh me nenin 28.1.

- Ndërkaq neni 130, mbi “heqjen dorë nga trashëgimia” duhet t’i shtohet një amendament dhe propozoj që të jetë si në vijim:

“Gratë dhe vajzat nuk kanë të drejtë heqje dore nga trashëgimia për një periudhë 10-vjeçare”.Pra, nëse ne e përkufizojmë një periudhë 10-vjeçare, besoj që gjendja do të ndryshojë. Besoj që ai vetëdijesimi, i cili ka mjaftuar për shekuj, në fakt do të vijë në shprehje nëpërmjet zbatimit të ligjit. Nëse e shtojmë këtu edhe atë që e propozova fillimisht, do të thotë një përkrahje financiare dhe ekonomike nëpërmjet subvencionimit të pronës dhe kolatoralit të grave, do të mbërrijmë që i njëjti të zbatohet dhe të kemi drejtësi në këtë vend dhe të mos presim edhe një shekull të kemi një ndryshim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin në plotësim-ndryshim dhe i japim përkrahje, kurse punën kryesore do ta kemi në Komisionin Funkcional dhe në komisionet e tjera të përhershme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka trajtuar projektligjin dhe do të japim kontributin tonë në amendamentimet e mëtutjeshme ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga grupet s’ka të tjerë të paraqitur. “6+” nuk është paraqitur, është dakord. Fjalën e ka zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Zonja Kadaj-Bujupi i tha qëndrimet e Lëvizjes “Vetëvendosje” sa i përket këtij projektligji.

Megjithatë, unë po i them edhe 2-3 çështje, të cilat BIRN-i i ka proceduar në Komisionin për Legjislacion dhe mendoj që janë tepër të rëndësishme.

E para, sepse kjo organizatë e ka bërë monitorimin e të drejtave të grave për trashëgiminë në pronë dhe në bazë të këtij monitorimi kanë dalë me disa rekomandime dhe na kanë proceduar në Komisionin për Legjislacion.

Zonja Kadaj-Bujupi e përmendi nenin 13 të ligjit aktual që nuk lejon që bashkëshortja të jetë trashëgimtare e burrit të vdekur. Domethënë, ne kemi pasur situata të tilla, sidomos në rastin e Shyhrete Berishës, e cila nuk ka arritur të trashëgojë pronën e burrit të saj të vdekur për shkak të problemeve nga vjehri.

Domethënë, edhe këta kanë propozuar që të ketë ndryshim te neni 13, i cili do të parashihte që në rast të vdekjes së trashëgimtarit, bashkëshortja e tij të jetë pjesë e trashëgimisë dhe jo të përjashtohet nga trashëgimia.

Një nen tjetër, në ligjin aktual thotë që mund të përjashtohen nga trashëgimia, thuhet këtu, ata që bëjnë “jetë të pandershme”. Unë mendoj që kjo është goxha problematike dhe nuk është e definuar çka, në fakt, është “jetë e pandershme”. Për shkak se kjo shprehërë është keqpërdorur nga trashëgimtarët, qofshin burra, babai, vëllai, bashkëshorti, duke e marrë parasysh vetëm këtë dispozitë në ligjin aktual.

Pra, mendoj që kjo duhet të kihet parasysh sidomos në Komisionin për Legjislacion, sepse kemi pasur jashtëzakonisht shumë probleme në praktikë pikërisht duke iu referuar kësaj dispozite.

Edhe diçka tjetër, duke marrë parasysh faktin që shumë gra dhe vajza heqin dorë nga trashëgimia pa vullnetin e tyre, ose të shtyra nga vëllezërit, baballarët, bashkëshorti, e përkrah propozimin e BIRN-it që thotë se “deklarata para gjyqtarit apo noterit është e pamjaftueshme” dhe kjo duhet ta ketë edhe audio dhe videoincizimin. Pra, duhet të ketë edhe audio dhe video incizim në kohën kur dikush heq dorë nga trashëgimia, pikërisht për shkak të problemeve dhe presioneve që i kemi pasur te vajzat dhe gratë për të hequr dorë nga kjo trashëgimi, e sidomos për t’i pasur edhe dy dëshmitarë, të cilët nuk janë anëtarë të familjes.

Pra, këto janë disa nga propozimet që unë pa u konsultuar me BIRN-in i fola në këtë seancë, për faktin se i konsideroj që janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tërmkollli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Çështja e trashëgimisë, në fakt, është një çështje shumë komplekse dhe, me gjasë, ende nuk po gjejmë zgjidhje të kënaqshme, e sidomos kur bëhet fjalë për çështje të trashëgimisë në aspektin gjinor.

Mirëpo, nuk mund të themi që tashmë dikush po na pengon, sepse në një kohë më herët kemi mundur të themi që për trashëgiminë në përgjithësi, për pronën në përgjithësi kemi pasur probleme të mëdha, tash s’mund të themi që dikush po na pengon, pos nëse e pengojmë veten.

Prandaj, i kemi krejt mundësitë, edhe ligjore, edhe të tjera që të bëjmë hapa të rëndësishëm në drejtim të zgjidhjes së drejtë të kësaj çështjeje.

Përveç ligjit, tashmë mund të kemi edhe mekanizma për zbatimin e ligjit, sepse jo rrallëherë ne po bëjmë ligje, të cilët thjesht nuk po gjejnë zbatim në praktikë.

Në fakt, në këtë projektligj, ndryshime ka edhe në do elemente të pabarazisë që bëhen në emër të barazisë, e që natyrisht duhet të evitohen.

U tha këtu që një nga elementet e rëndësishme ose dobi të rëndësishme të këtij ligji është lehtësimi i punës së gjykatave, duke i kaluar disa nga çështjet ose disa nga kompetencat te noterët.

Zonja ministre, zvogëlimi i lëndëve në gjykata, në fakt, nuk mund të vijë me këtë ligj. Zvogëlimi i lëndëve në gjykata vjen me themelimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative, që nuk di

në këtë qeveri dhe në qeveritë e mëhershme a është përmendur ndonjëherë dhe a keni biseduar ndonjëherë?

Në fakt, në planin legjislativ që na është sjellë neve deputetëve, unë nuk kam parë që Ministria e Drejtësisë të ketë propozuar Ligj për Gjykatën Administrative.

Prandaj, ju lutem, merreni shumë seriozisht këtë çështje, sepse pa një gjykatë administrative gjykatat tona aktuale, herë me fajin e tyre, e herë pa fajin e tyre, do të mbeten pa zgjidhur lëndë edhe me dekada të tëra. Kaq! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!
Faleminderit, zonja ministre, për prezantimin e projektligjit.

Konsideroj që është momenti i fundit që ky projektligj, me këto ndryshime që i keni bërë, por edhe të kolegët që i cekën, ka vështirësi jo vetëm sa i përket të drejtës pronësore të vajzave dhe grave, mirëpo edhe të çështjetë tjera.

Sipas disa hulumtimeve të USAID-it, në Kosovë vetëm 19% të grave kanë prona në emrin e tyre. Kjo u tha edhe nga disa kolegetë mia, që konsideroj se është numër shqetësues sa i përket përqindjes.

4% e tyre kanë trashëguar nga familjet e tyre. Kjo shifër na tregon se ende jemi në atë mentalitetin që vetëm gjinisë mashkullore i takon, burrit apo djalit, dhe kjo duhet të ndryshohet me mentalitetin, por edhe me vetëdijesimin në kampanja të ndryshme nga ju, ministria, mirëpo edhe nga ne vetë që jemi këtu pjesë e institucioneve vendore.

Ky numër shumë i ulët tregon për pabarazi, andaj ligji në amendamentim duhet të adresohet mirë nga këto çështje.

Për t'u sigurua që gratë dhe vajzat të mos heqin dorë nga trashëgimia dhe të mos mbeten hapësira ligjore, ku mund të përjashtohet apo fshehën, në fakt, trashëgimtarët, e drejta pronësore është e drejtë themelore dhe duhet garantuar si e tillë.

Unë kërkoj nga ju, ministre, që përveç këtij projektligji, mendoj që na duhet edhe një vetëdijesim, një kampanjë bashkë me ministrinë e tjera, sepse kjo nuk i takon vetëm ministrisë që ju e drejtoni dhe të merren edhe institucionet e tjera, sepse nga organizatat ndërkombëtare kemi pasur adresime të ndryshme. Mirëpo tash ka ardhur momenti që me këto propozime të

amendamenteve që i konsideroni që duhet të involvohen, mendoj që të jenë edhe të zbatueshme kur të vijë edhe te shqyrtimi i dytë i projektligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Besoj që sidomos këto vitet e fundit kanë dëshmuar që barazia gjinore në Kosovë në të gjitha aspektet do të mund të arrihet një ditë vetëm nëpërmjet fuqizimit ekonomik të grave dhe ky fuqizim ekonomik do të jetë i pamundur në qoftë se gratë në Kosovë jetojnë në rrethana ku nuk mund të posedojnë pronë.

Pra, në qoftë se nuk kanë prona në emër të tyre, as nuk mund të marrin kredi për të hapur biznese, në qoftë se nuk kanë pronë të regjistruar edhe në emër të tyre nuk mund të largohen nga dhuna, në qoftë se ajo ushtrohet ndaj tyre, e shumë e shumë padrejtësi të tjera, të cilat janë si rezultat i mungesës së të drejtave pronësore.

Pra, ndryshimi i këtij ligji ka qenë i domosdoshëm që një kohë, edhe pse në qoftë se dëgjoni deklaratat që janë bërë madje edhe nga ky Parlament për vite të tëra, do të dëgjoni shumë thënie se kinse ligji ynë është perfekt, por praktika është problem. Por po del që as ligji nuk ka qenë perfekt, prandaj edhe kanë qenë të domosdoshme dispozitat, të cilat tani përcaktojnë, sa po e shoh unë, sipas modelit të Maqedonisë dhe disa shteteve të tjera, edhe heqjen e të drejtës për një periudhë nga mundësia për të hequr dorë nga prona për vajzat dhe gratë, që është një ndryshim i mirë, mirëpo çka është me rëndësi përtej kësaj, përtej ligjit, përtej copës së letrës, që do të shkojë në gjykata për t'u zbatuar, është trajnimi intensiv i gjyqtarëve.

Unë kam punuar për vite të tëra në gjykata dhe mund të ju them që një ndër ankesat kryesore edhe prej grave është fakti që nuk janë trajtuar si duhet rastet e heqjes dorë nga pronësia. Pra, gjyqtarët duhet të jenë të trajnuar në mënyrë të tillë që të mos lejojnë që dispozitat e reja që do të miratohen sot të shkelen dhe të ndërmerren masa konkrete dhe shumë më strikte, në mënyrë që të mos lejohet heqja dorë nga të drejtat pronësore.

Sa u përket termave që u përmendën më herët, si për shembull ndershmëria, kjo është logjikë primitive dhe primitivizma të tillë ne nuk duhet të lejojmë që të bëhen pjesë e ligjeve tona. Në fund ka edhe mënyra se si mund të ndihmojnë edhe komunat. Për shembull, në qoftë se dy bashkëshortët dëshirojnë ta regjistrojnë pronën e tyre si të përbashkët duhet ta paguajnë një shumë mjaft të lartë, e cila është e lartë për shumicën dërrmuese të familjeve në Kosovë dhe zakonisht kur e regjistrojnë vetëm në emër të njërit bashkëshort pronën është shumë më lirë, dhe ju e dini se për cilin bashkëshort pastaj vendoset, në shumicën dërrmuese të rasteve.

Pra, duhet ajo taksë, ai çmim që paguhet në komunë, në qoftë se dy bashkëshortët vendosin ta regjistrojnë pronën në emër të të dyve, patjetër të hiqet dhe ndoshta duhet të shikohet që kjo çështje edhe të detyrohet nëpërmjet ligjit, pra të jetë çmimi i njëjtë sikur të regjistrohet vetëm në emër të njërit bashkëshort, sikur do ai çift ta regjistrojë në emër të të dyve, pra duke rritur kështu numrin e rasteve, se tani për shembull në Prishtinë janë vetëm 13-14 raste sipas statistikave. Pra, duhet patjetër të rritet numri i rasteve kur të dy bashkëshortët e regjistrojnë pronën në emër të tyre, jo vetëm në emër të burrit, gjë që ndodh në shumicën e rasteve.

Pra, ndryshimi sa i përket fuqizimit të të drejtave pronësore të grave është më se i mirëseardhur, por duhet patjetër të përpiqemi si Kuvend që t'i bëjmë këto dispozita edhe më strikte, në mënyrë që të mos shkojnë dekada të tëra për ta ngritur nivelin e barazisë në pronësi vetëm në 1%.

Dhe e fundit, Kushtetuta e Kosovës neni 24.3 lejon diskriminim pozitiv ndaj grupeve të caktuara me qëllim të arritjes së barazisë, pra çdo masë, përfshirë edhe masat që parashihen në këtë ligj, që kanë për qëllim që të krijojnë barazi të një kategorie të caktuar, në këtë rast te gratë. Edhe pse dikujt në shikim të parë mund t'i duket pabarazi ndaj gjinisë tjetër, në fakt është kategori kushtetuese dhe bëhet me qëllim që të arrihet barazia përfundimtare. Pra, është diçka që lejohet te ne dhe inkurajohet dhe këtë e kemi bërë edhe në ligjet e tjera, por ajo çka mungon deri tani është implementimi në praktikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi, a je paraqitur për ligjin? Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Kur bëhet fjalë për Ligjin për trashëgiminë, unë nuk jam fort për barazinë, pra unë jam për njëfarë diskriminimi pozitiv në favor të femrave. Për shkak se ne e dimë që femra është shtylla e shtëpisë, e nëse dikujt i besohet një gjë e tillë, atëherë do të duhej t'i besohet edhe trashëgimia.

Prandaj, unë këtu dua të them edhe një herë, nëse do të doja barazi, mendoj që do t'i hynim në hak aktorit kryesor të familjes, e cila është femra, apo jo? Dhe, e dyta, unë mendoj që nëse do të bëhej fjalë për trashëgiminë ndërmjet dy gjinive do duhej të favorizohej femra. Unë personalisht kam një vajzë dhe një djalë, nëse do të kisha diçka t'i trashëgoja, së pari do të mendoja t'i trashëgoja vajzës, prandaj mendojeni këtë punë pak më mirë, se barazia nganjëherë mund të jetë edhe jo e drejtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Mos u emociononi tash se s'ka nevojë të gjithë që të paraqiteni për një çështje që e dimë të gjithë. Zonja Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e pashë të arsyeshme që në emrin tim t'i paraqes disa çështje sa i përket Ligjit për trashëgiminë në Kosovë.

Po qe se i analizojmë periudhat tona të kaluara si qytetarë të Kosovës dhe gjendjen e Kosovës, dhe po qe se i analizojmë të arriturat e pasluftës, në veçanti pas pavarësisë së vendit, ne veç kemi filluar t'i bëjmë hapat e parë pozitivë. Mirëpo, të mos e harrojmë një gjë - transformimi i përgjithshëm i shoqërisë në Kosovë kërkon kohë, mund, angazhim të të gjitha strukturave në të gjitha nivelet e organizimit dhe të të dyja gjinive. Trashëgimia është vërtet një çështje e ndjeshme kur hapet diskutimi për të, por zbatimi i Ligjit për trashëgiminë kërkon një riedukim të përgjithshëm shoqëror. Ky riedukim duhet të përcillet më pas me një zhvillim të përgjithshëm shoqëror, në mënyrë që ne të dalim të barabartë në aspektin e zbatimit të ligjit në rrafshin gjinor.

Askujt nuk mund t'i japësh asgjë me zor, ose pa vullnetin e tij, por askujt nuk mund dhe nuk ke të drejtë t'i marrësh diçka pa vullnetin e tij. Andaj, edhe çështja e trashëgimisë, pavarësisht që unë i përkas gjinisë femërore, pavarësisht të tjerëve që mund t'i përkasin gjinisë mashkullore, është çështje që mbetet në vullnetin e secilit, pavarësisht edhe nivelit të vetëdijes tij, edhe nivelit të edukimit të tij. Janë rastet e parapara me ligj kur dikush tjetër mund të vendosë për cilindo qytetar, qoftë ai edhe i moshës madhore.

Andaj, zbatimi i Ligjit për trashëgiminë kërkon vërtet përkushtim, e nuk kërkon deklarime politike. Ne me deklarime politike për trashëgiminë në aspektin gjinor jemi duke folur tash 17 vjet në Kosovë, thua se s'e kemi ditë më herët këtë, thua se edhe tradita jonë zakonore nuk i ka dhënë shumë përparësi femrës në shumë çështje, por që nuk ia ka dhënë ndoshta të drejtën që ajo të ketë një tokë të trashëguar nga babai apo një shtëpi është çështje tjetër, mirëpo femra ka pasur beneficione femra, kështu që t'i kujtojmë edhe ato momente të kaluara të historisë tonë kur femra vërtet ka qenë në nivel të mirë.

A duhet të pajtohemi me nivelin çfarë ka qenë dje dhe është sot? Jo! Synojmë diçka më shumë, por gjithherë duke pasur parasysh edhe të drejtën e vetë qytetarit, përkatësisht qytetares, pavarësisht marrëdhënieve që ka në familje. Pavarësisht ndershmërisë apo pandershmërisë, të gjitha konceptet duhet të japin përkufizim çka konsiderohet e ndershme dhe çka e pandershme, por duhet t'i eliminojmë rastet, të cilat bëjnë pengesa edhe në regjistrim të pasurisë, siç është rasti i taksave për pronën e përbashkët bashkëshortore. Me çfarë të drejte e kemi lejuar këtë? Vetë e kemi lejuar.

Kështu që duhet t'i rishikojmë, jemi Kuvend, prandaj duhet t'i ndërmarrim të gjitha masat që ta fillojmë një riedukim, por edhe në tekstet shkollore të lënda e Edukatës qytetare kjo çështje duhet të trajtohet dhe që nga vegjëlja fëmijët të rriten me edukatën se çdo gjë në familjen e prindit, ku ai jeton dhe rritet, pavarësisht marrëdhënieve me kujdestarin, të ketë të drejtë të trashëgojë, por gjithsesi çdo kund në botë është e rregulluar, po qe se njëri, qoftë mashkulli apo femra dëshiron të tërhiqet edhe nga trashëgimia, edhe nga e drejta për të përfitur pronë, pavarësisht në emrin e trashëgimisë, apo faljes, është e drejtë e tij dhe këtë s'mund ta imponojmë, por të kemi kujdes që vetëdijesimin, kampanjat të bëhen gjithherë prej qëllimit të mirë, ngase e përmenda në fillim të

diskutimit - transformimi krahas dëshirës dhe obligimeve kushtetuese për ta arritur një barazi të mirëfilltë gjinore në vend, nganjëherë nga pakujdesia, apo nga dëshira e tepërt po na gjuan në segmente ku shoqëria jonë, familjet tona po devijojnë.

Nga frika e devijimit mendoj që duhet të jemi të gjithë të kujdesshëm, të punojnë të gjithë seriozisht në zbatimin e ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIIA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući,

Prosto je žalosno da ovom jako specifičnom Zakonu govore ovoliko žena u Parlamentu, a jako broj mali broj muškaraca, i to pokazuje činjeničnu stanje na terenu zašto je statistika uopšte ovakva, odnosno da Zakon o nasledstvu nasleđuju žene manje od 5% stanovništva.

Ukoliko mi kao mlada država koja želi i pratiti sve evropske standardne moderne civilizacije, bazirajući se sve demokratske zemlje Zapadne Evrope, želimo da promenimo nešto, onda se moramo se menjati sami, moramo promeniti i način našeg razmišljanja, moramo sa starne edukativnog karaktera obrazovati naše društvo da, ukoliko više od 50% na teritoriji Kosova čine žene, da li je moguće da mi kao roditelji naše nasledstvo ostavljamo manje od 5% našim ćerkama, prosto je neverovatna ta činjenica i onda nailazimo na jedno paradoksalno stanje koje govori da preko edukacije, da preko Ustava, da preko svih zakonskih regulativa implementacije Zakona na terenu, možemo samo promeniti stanje kako jeste, jer, u samom startu kao što je moja koleginica Vjosa reče i ostale, žene su diskriminisane da razviju bilo kakav vid svoga biznisa ukoliko najmanje svoje zemljište na svoje ime.

Tako da apelujem na sve nas ovde posebno na pripadnike muškog pola, da malo više o tome obrate pažnju, da se o tome govori javno da se poštuje Zakon o nasledstvu tako da se uopšte promeni činjenično stanje na terenu.

Naravno da za to treba vremena naravno to treba razno raznorazni stereotipi u društvu da se razbiju, ali ako o tome ćutimo i ako mi ne dajemo neke pozitivne korake u rešavanju tih problema i dalje ćemo imati te podatke kakve imamo. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për të votuar, nuk ka tjerë të paraqitur.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin. Zonja Hoxha, e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore. Ky projektligj është hartuar dhe finalizuar nga Ministria e Drejtësisë nëpërmjet së cilës synojmë që krahas eliminimit të pengesave të hasura në zbatimin e ligjit në fuqi të bëjmë harmonizimin e dispozitave të caktuara të këtij ligji me ligjet tjera të kësaj fushe, para së gjithash me Ligjin për trashëgiminë dhe Ligjin për noterinë.

Po ashtu, nëpërmjet këtij projektligji synojmë krijimin e infrastrukturës ligjore të përshtatshme për lehtësimin e punës së gjykatave, por edhe të saktësisë të përgjegjësive të noterëve. Janë rishikuar dhe qartësuar dispozitat, të cilat u referohen përgjegjësive të gjykatave, e që të njëjtat gjatë zbatimit të Ligjit për noterinë dhe Ligjin për procedurën jokontestimore kanë shkaktuar vështirësi në zbatim. Nëpërmjet këtij projektligji gjithashtu do të rritet transparenca, duke bërë shpalljen e njoftimit, ku përveç njoftimit të trashëgimtarëve nëpërmjet portalit shtetëror, Oda e Noterëve në një afat prej 30 ditësh do të mund ta mbajë të njoftuar për një procedurë të tillë edhe palët që mund të kenë interes në çështjen trashëgimore.

Me qëllim të krijimit të sigurisë për ta eliminuar mundësinë e keqpërdorimit të heqjes dorë nga trashëgimia, projektligji e ka përcaktuar, ndër të tjera, që noteri paraprakisht me deklarinim për heqjen dorë të zhvillojë një bisedë me trashëgimtarin për t'u siguruar që trashëgimtari nuk është vënë nën presion për të hequr dorë nga trashëgimia përkundër vullnetit të trashëgimtarit. Finalizimi i këtij projektligji është bërë në konsultim me aktorët relevantë vendorë dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe po ashtu i është bërë edhe vlerësimi i ndikimit financiar, si dhe është konstatuar se është në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Prandaj, ju ftoj që ta miratoni në lexim të parë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë me nënkryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Halimi, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin. Zonja Halimi, e keni fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion i rekomandon Kuvendit në parim ta aprovojë Projektligjin për procedurën jokontestimore dhe ne si komision e kemi formuar grupin punues për shqyrtimin e këtij projektligji dhe do të organizohen edhe dëgjime publike me qëllim që projektligji të jetë sa më mirë, me qëllim të zbatimit më të lehtë të tij në praktikë.

Andaj, edhe kërkojmë nga deputetët që ta votojnë në parim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Grupi i LDK-së, kush e ka fjalën? Agim Ademaj!

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar të pranishëm,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore. Propozimet e prezantuara nëpërmjet këtij projektligji nga Ministria e Drejtësisë e kanë qëllim kryesor bartjen e disa kompetencave nga gjyqtarët te noterët lidhur me kryerjen e shumë procedurave jokontestimore trashëgimore, krejt këto me qëllim të lehtësimit dhe uljes së ngarkesave në gjykata.

Vlen të theksohet se ne e kemi në punë edhe Projektligjin për noterinë, do ta kemi pikën tjetër dhe dy projektligjet që u cekën më lart dhe duhet të kemi kujdes të bartja e këtyre kompetencave në institucionin e noterisë nga gjykatat, sepse duhet të kemi një numër të kufizuar të noterëve dhe shumë specifika tjera. Sido që të jetë, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore dhe ndërmjet dy leximeve do ta japim kontributin tonë rreth këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin e PDK-së, Nezir Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar ministre e Drejtësisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për procedurën jokontestimore dhe si të tillë do ta mbështesë në parim. Ndërsa, gjatë amendamentimit do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Në projektligj janë përfshirë ndryshimet që kanë të bëjnë kryesisht me bartjen e autorizimeve ligjore në çështjet trashëgimore nga gjykata te noterët. Pra, me këtë rregullim procedura trashëgimore do të kalojë tërësisht te noterët, por kritika jonë sa i përket këtij projektligji është se kjo e rrit koston e qytetarëve që do të ballafaqohen me rastin e hapjes së trashëgimisë, pasi që taksa gjyqësore në procedurë trashëgimore është shumë më e ulët se sa inicimi i së njëjtës pranë noterit.

Domethënë, kjo do të krijojë edhe rritje të koston për qytetarët në këtë drejtim, madje edhe pakënaqësi sa i përket kësaj çështjeje. Mendojmë që në këtë projektligj duhet të krijuar mundësia që palët të mund t'i referohen edhe gjykatës. Është e vërtetë që kjo mund të krijojë komplikime në raport me ndryshimet, të cilat janë paraparë, mirëpo në situatën aktuale, pra duke marrë parasysh gjendjen sociale dhe ekonomike të qytetarëve, ose duhet zbritur taksa e noterëve, ose duhet lënë opSION që procedura trashëgimore të iniciohet edhe pranë gjykatës kompetente.

Rregullimi i tillë po arsyetohet në rritje të efikasitetit, mirëpo rritja e efikasitetit nuk duhet të jetë e ngarkuar në barrën e qytetarëve. Për këtë arsye, ne si subjekt politik nuk mund ta japim votën për këtë projektligj, pra do të abstenojmë, do t'i shikojmë mundësitë që ta adresojmë vërejtjen tonë, mirëpo për fund duhet ta themi edhe një kritikë sa i përket Qeverisë, saktësisht ministres së Drejtësisë, meqë është këtu. U bënë disa ligje, të cilat ne i shqyrtuam në këtë Kuvend, që i ka proceduar Ministria e Drejtësisë, prandaj është e udhës që pas shqetësimit të deputetëve të kemi edhe një përgjigje të ministres për shqetësimet, të cilat i kanë shtruar deputetët.

Domethënë, ministrja e Drejtësisë në vazhdimësi ka zgjedhur të heshtë në vërejtjet e deputetëve dhe unë mendoj që kjo fare nuk është në rregull, meqë këtë projektligj e ka proceduar Ministria e Drejtësisë. Tha që e kanë bërë në konsultim me grupet e interesit e andej-këndej, por është tepër e rëndësishme që vërejtjeve tona t'u jepet një përgjigje, përndryshe heshtja është edhe papërgjegjësi karshi qytetarëve, mirëpo edhe karshi vetë deputetëve të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar e përkrah në parim këtë plotësim-ndryshim të këtij ligji, ndërsa kontributin tonë do ta japim në komisionet përkatëse për të vendosur përfundimisht në leximin e dytë për votën pro apo kundër këtij ligji.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë që janë paraqitur për të debatuar për projektligjin. Kalojmë në trajtimin e ligjit tjetër, duke përfunduar kuorumin për votim.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për noterinë

Komisioni Funkcional për Legjislacionin e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin. Zonja ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Të nderuar deputetë,
E paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për noterinë. Siç dihet, ligji aktual për noterinë është hartuar në vitin 2010. Shërbimi noterial në Kosovë ka ndikuar dukshëm në ofrimin e shërbimeve në mënyrë më efektive për qytetarët.

Mirëpo, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të legjislacionit të noterisë, si dhe pengesave të hasura gjatë zbatimit, e kemi hartuar Projektligjin e ri për noterinë. Nëpërmjet këtij projektligji qartësohen çështjet e përgjegjësisë së noterëve në raport me gjykatën, si dhe me theks të veçantë do të adresohen çështjet, si në vijim:

- Zgjerimi i kompetencave të noterëve në zhvillimin e procedurës joontestimore trashëgimore,
- Rritja e numrit të zyrave noteriale, nga një noter në 20 mijë banorë, sa është ligji aktual, në 1 noter në 10 mijë banorë për secilën komunë,
- Mundësia që për një numër të caktuar të dokumenteve të hartuara nga palët apo përfaqësuesit e tyre të kërkohet solemnizimi i tyre nga noteri,
- Për noterët e rinj është paraparë edhe trajnimi tremujor i tyre pas emërimit dhe para fillimit të ushtrimit të detyrës së noterit.

Gjithashtu vlen të theksohet se hartimi dhe finalizimi i këtij projektligji është bërë në konsultim me aktorët vendorë dhe me partnerët ndërkombëtarë, veçmas me Odën e Noterëve, përfaqësues nga USAID-i, Instituti Ndërkombëtar i Noterisë, Projekti i Bashkimit Evropian për profesionet e lira e të tjera.

Ky projektligj i ka kaluar të gjitha fazat e konsultimeve sipas dispozitave për hartim të legjislacionit dhe po ashtu i është bërë edhe vlerësimi i ndikimit financiar, si dhe është konstatuar se është në pajtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Prandaj, bazuar në rëndësinë dhe nevojën për avancim të mëtejshëm të legjislacionit të kësaj fushe, ju ftoj për miratimin e Projektligjit për noterinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Pas prezantimit e hap debatin për diskutim në parim.

E ftoj nënkryetaren e Komisionit Funkcional për Legjislacion, zonjën Selvije Halimi, ta paraqesë dhe arsyetojë raportin. Agim Aliu, në emër të komisionit, e ka fjalën.

AGIM ALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

E nderuar ministre Hoxha,

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2017 pasi e shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-144 për noterinë, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandimin që të miratohet në parim Projektligji për noterinë, pasi që projektligji plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Po ashtu, le të më lejohet që të shpreh edhe qëndrimin në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i cili e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe po ashtu kërkon nga Kuvendi që të miratohet në parim, ndërsa kontributin do ta japë përmes grupit punues në Komisionin për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Agim Aliu flet për Grupin Parlamentar të PDK-së. Faleminderit! Agim Ademi për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

AGIM ADEMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për noterinë. Siç e thamë edhe më herët, edhe dy tri ligjet e mësipërme janë shumë të lidhura me këtë projektligj dhe mendojmë se Projektligji për noterinë është më i avancuar sesa ligji aktual që është në fuqi. Por, po e tërheq vëmendjen edhe një herë, duhet të kemi kujdes me bartjen e shumë kompetencave nga gjykata tek institucioni i noterisë.

Mendoj që në mes dy leximeve edhe Komisioni për Legjislacion, por edhe aktorët tjerë, duhet të jenë më të vëmendshëm rreth këtij projektligji. Sigurisht se do të ketë edhe dëgjim publik dhe mendoj se ky projektligj meriton që të përpunohet mirë edhe një herë, në mënyrë që të mos kemi probleme të mëvonshme.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim projektligjin dhe ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë projektligj. Konsiderojmë që ndryshimet që janë propozuar nga Ministria e Drejtësisë nuk janë kushedi se sa përmbajtjesore, duke pasur parasysh problemet që kemi pasur me noterët. Shumë keqpërdorime janë bërë në këtë drejtim dhe duhet theksuar faktin, se shumë, ndoshta një numër i konsiderueshëm i noterëve janë duke u hetuar për vepra të ndryshme, për keqpërdorim të detyrës zyrtare.

Mendoj, se nuk janë adresuar shumë probleme me të cilat jemi ballafaquar. Ne kemi pasur edhe kontakte e takime me shumë noterë. Në anën tjetër, edhe prej tyre kemi marrë vërejtje sa i përket këtij projektligji, për shkak të mosbashkëpunimit të Ministrisë së Drejtësisë në raport me ata.

Ajo që po dua ta theksoj në këtë seancë është që, përderisa me ligjin e vjetër nuk ishte parashikuar që noterët të kenë qasje në të gjithë regjistrat elektronikë të organeve publike, pra janë shërbyer vetëm me kopjet fizike të vërtetuar, domethënë tashmë me këtë projektligj është saktësuar që të kenë qasjen e plotë në këta regjistra, ku përfshihen regjistrat civilë. Pamundësia për të pasur qasje ka bërë që noterët dhe gjyqtarët nuk kanë pasur mundësi verifikimi të trashëgimtarëve. Në këtë kuptim noterët kanë qenë të kufizuar në akt-vdekjen që personat fizikë e kanë sjellë te noteri. Por, me ligj nuk theksohet nëse regjistrat e organeve publike nënkuptojnë edhe qasjen në regjistrat kadastralë të komunave, sepse mospasja qasje në këta regjistra ka bërë që të rritet pasiguria në kontratat dhe transaksionet e ndryshme të tokës.

Mendoj se do të duhej të specifikohet, se në cilat regjistra publikë kanë qasje noterët. Në këtë kuptim Ministria e Drejtësisë apo edhe Oda e Noterëve do të duhej të lidhin marrëveshje me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, në mënyrë që noterët të kenë vetëm qasje elektronike për t'i verifikuar të dhënat.

Natyrisht, se kemi edhe vërejtje të tjera, mirëpo ne si subjekt politik, si grup parlamentar do t'i adresojmë në grupin punues që do ta krijojë Komisioni për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i AAK-së e përkrahë në parim Projektligjin për noterinë. Siç e thamë edhe më parë, kontributin do ta japim në Komisionin Funkcional dhe komisionet e përhershme. Faleminderit!

KRYESUESI: Agim Aliu e ka kërkuar fjalën.

AGIM ALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për noterinë, padyshim se është një ligj i një rëndësie të veçantë dhe sigurisht se në kuadër të rishikimit dhe reformës që po bëhet, ndryshimi i këtij ligji është shumë i nevojshëm.

Përgjithësisht ky është një projektligj i mirë, megjithatë janë disa rregullime ligjore shumë shqetësuese, që cenojnë shërbimin noterial dhe noterët si shërbim publik dhe zyrtarë publikë.

Sipas nenit 2 të këtij projektligji noterët kanë të drejtë të zgjedhin se si do të regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve. Konsideroj, se ky është një rregullim aspak i mirë, sepse Ligji për shoqëri tregtare njihë pesë forma të regjistrimit të bizneseve. Noteri është zyrtar publik dhe nuk është biznes. Nëse, noterit i lehet në dispozicion që të vendos për formën e regjistrimit, atëherë bie ndesh me përgjegjësinë civile të noterit, ngase mundëson shmangie nga kompensimi i dëmeve për palët kontraktuese dhe organet publike.

Natyrisht, noteri duhet të paguajë tatimet dhe taksat, por në të njëjtin format, siç po e bëjnë edhe tani.

Në nenin 7 parashihet, se si të organizohet provimi për noterë. Në këtë nen është shkruar se provimi mbahet me gojë dhe me shkrim. Realisht, do të duhej të ishte e kundërta, provimi një herë mbahet me shkrim e pastaj kandidatët që e kalojnë provimin me shkrim, kanë të drejtë t'i nënshtrohen pjesës me gojë.

Në nenin 20 parashihet, se cilat janë detyrat e papajtueshme të noterit. Konsideroj, se ky nen është shumë gjithëpërfshirës dhe lë mundësinë që të ketë keqpërdorime të ndryshme. Shembull: në këtë nen parashihet që noteri mund të jetë edhe mësimdhënës. Kjo është e pamundshme, sepse një noter nuk mund të jetë edhe në zyrë noteriale 8 orë në ditë e njëkohësisht i rregullt edhe në Universitet. Prandaj, kjo dispozitë duhet të ndryshohet dhe noteri mund të mbajë vetëm ndonjë ligjëratë për promovimin e shërbimit noterial para studentëve të drejtësisë, por jo edhe të jetë noter dhe mësimdhënës i rregullt.

Neni 40 rregullon aktet e detyrueshme noteriale apo thënë më qartë, cilat akte duhet të bëhen në formën noteriale. Ky nen është i kompozuar në atë mënyrë që sjell në kundërshtim paragrafët e këtij neni. Po ashtu, bëhet dualizëm i kompetencave ndërmjet noterëve dhe avokatëve.

Sidoqoftë, unë parimisht e mbështes këtë projektligj, por njëkohësisht do të paraqes këto komente pranë grupit punues dhe Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka të paraqitur të tjerë për ta diskutuar ligjin në parim.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin. Ftoj ministren e Drejtësisë, zonjën Dhurata Hoxha, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Të nderuar deputetë,
Paraqes para jush për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Hartimi dhe finalizimi i këtij projektligji është rezultat i punës dhe përkushtimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë në funksion të avancimit të infrastrukturës ligjore në përgjithësi, e me theks të veçantë legjislacionit të fushës së luftimit dhe të parandalimit të korrupsionit.

Po ashtu, miratimi i këtij projektligji është pjesë e agjendës evropiane të reformave, apo procesit ERA.

Përmes angazhimeve tona duke përfshirë edhe aprovimin e këtij projektligji, konsideroj se institucioneve kompetente po u ofrojmë legjislacion adekuat, në mënyrë që puna e tyre të jetë sa më efikase dhe efektive në drejtim të parandalimit dhe luftimit të dukurive negative, veçmas korrupsionit dhe në këtë aspekt edhe konfliktit të interesit.

Projektligji përmban këto çështje kryesore, si në vijim: parasheh një numër të konsiderueshëm të ndalesave për zyrtarët publikë, si për shembull: u ndalohet kryerja e punëve të tjera, përmes të cilave në çfarëdo forme mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të funksionit publik. Pastaj, zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të punësohet apo të emërohet për një periudhë deri në dy vjet, pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse apo menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre, të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik.

Ndalimi që të përdorë informacionin e siguruar gjatë ushtrimit të funksionit publik për qëllim të punësimeve të tjera në të ardhmen, për interes privat të vet apo të një personi të afërm apo të besuar për një periudhë deri në dy vjet pas përfundimit të funksionit publik.

Përcaktimi i papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, i cili parasheh që zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar apo anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë, privatë fitimprurës.

Në kuadër të këtij projektligji janë trajtuar dhe paraparë edhe obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre, në situata ku ka konflikt të interesit.

Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjedhë vetë, në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të tij të interesit. Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Nëpërmjet këtij projektligji është bërë përpjekje që t'i kushtohet vëmendje e veçantë aspektit preventiv, përkatësisht parandalimit të konfliktit të interesit.

Vlen të theksohet, se ky projektligj është hartuar dhe finalizuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e Agjencisë Kundër Korrupsionit, ekspertë të Këshillit të Evropës dhe Zyrës së BE-së në Kosovë dhe konsiderojmë, se është ligj që do të ndikojë në avancimin e mëtejshëm të luftimit të dukurive të tilla në vendin tonë.

Megjithatë, nëse vlerësohet se ka edhe ndonjë gjë që duhet të përfshihet mund të bëhet në fazat e shqyrtimit të mëtejshëm, në kuadër të Komisionit për Legjislacion në cilësi të Komisionit Funkcional, duke marrë parasysh bashkëpunimin shumë të mirë që kemi me këtë komision.

Andaj, bazuar në rëndësinë që ka miratimi i këtij projektligji, si në drejtim të përmbushjes së obligimeve që dalin nga procesi ERA, si dhe avancimit të mëtejshëm të legjislacionit të kësaj fushe, ju ftoj për miratim të Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit Funkcional, e ftoj zonjën Selviqe Halimi, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2017 ka shqyrtuar projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik në lexim të parë dhe, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandimin që të aprovohet ky projektligj në parim nga Kuvendi dhe më pastaj të vazhdojmë me amendamentimin e tij, sipas nevojave dhe interesave të komunitetit publik, në mënyrë që ligji të jetë sa më funksional dhe më lehtë i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, flet Agim Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar!

E nderuar ministre Hoxha,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe konsideron se është një projektligj i vonuar, përkundër rëndësisë që ka, sepse tashmë është e njohur se ky projektligj dy herë radhazi është shqyrtuar dhe amendamentuar dhe se i njëjti është tërhequr nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pa ndonjë arsytim. Tani është proceduar edhe për herë të tretë, por kësaj radhe është projektligj i ri.

Ajo që propozuesi ka përfshirë në këtë projektligj është amendamenti, që Komisioni për Legjislacion në atë kohë pati bërë lidhur me harmonizimin, respektivisht unifikimin me Ligjin nr. 04/L-050 për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Ndonëse, kjo pikë është harmonizuar, ne si grup parlamentar dhe si komision gjatë fazës së amendamentimit do të kujdesemi, që fokusi të jetë tek kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e veprimtarive të tjera, krahas ushtrimit të funksionit publik. Po ashtu, edhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, sepse dihet tashmë fakti se kemi mbi 1500 raste të konflikteve të interesit. Ndonëse, me këtë projektligj parashihen detyrat dhe kompetencat e Agjencisë Kundër Korrupsionit ne do të kujdesemi, ashtu sikurse edhe herëve të tjera, që të jemi në bashkëpunim të ngushtë me agjencinë si zbatuese e ligjit. Kjo në asnjë mënyrë nuk do t'i anashkalojë edhe grupet tjera të interesit.

Shpresoj, që kësaj radhe puna jonë dhe e komisionit nuk do të hidhet poshtë nga Qeveria e Republikës, që edhe një herë ta tërheqë nga procedura në fazën finale, siç kishte bërë dy herë më parë, veçmas kur në fazat e saj e kishte përfunduar punën grupi punues dhe Komisioni për Legjislacion. Prandaj, kërkoj që Qeveria e Republikës të jetë serioze dhe e përgjegjshme dhe jo ashtu siç ka vepruar deri më tash.

Andaj, duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i rekomandon Kuvendit, respektivisht deputetëve, që ta miratojnë dhe që vërejtjet dhe komentet e tyre t'i bëjnë brenda komisionit, respektivisht grupit punues në kuadër të këtij komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin e Lëvizjes “Vetëvendosje”, flet Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

U tha edhe më përpara, që në këtë Kuvend dy herë radhazi është proceduar Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit dhe dy herë radhazi, pa asnjë arsytim, është tërhequr nga Qeveria.

Arsyeja pse po e përmend këtë edhe unë, është për faktin se në të dyja versionet e mëparshme, pas amendamenteve të Komisionit për Legjislacion, është paraparë që zyrtarët e lartë të mos kenë mundësinë që të kenë më shumë se një funksion publik. Kjo, si duket, i pengonte Qeverisë dhe pastaj e tërhiqte në shqyrtimin e dytë, në seancat e Kuvendit.

Ne si subjekt politik gjithnjë kemi pasur qëndrim, që zyrtarët e lartë të mos kenë më shumë se një vend pune. Kjo çështje nuk është adresuar as me këtë projektligj. Shtrohet pyetja, se pse po hezitohet që të bëhet diçka e tillë? A ekziston ndonjëherë mundësia, që ky Kuvend të përfaqësojë interesat e qytetarëve?

Në kohën kur qytetarët përballen me papunësi, varfëri, mjerim... ne kemi zyrtarë, si ta quaj... zyrtarë "supermenë", që i kanë nga dy, tri, katër e pesë vende pune, ndërkohë që qytetarët çdo ditë, çdo orë, kërkojnë vende pune kudo nëpër institucione, qoftë publike, po ashtu edhe ato private. Pra, mendoj se kjo çështje duhet të adresohet dhe është koha e fundit kur duhet ta adresojmë përmes këtij projektligji.

Më tej, tek përkufizimet e projektligjit, zakonisht tek përkufizimet qëllimi është për të qartësuar emërtimet, por në fakt te këto përkufizime janë aq të ngarkuara, sa që është shumë e vështirë të kuptohet se cili është qëllimi. Është e rëndësishme të mos lehet hapësirë interpretimi, pasi që për shkak të kësaj ligjet po mbesin të pazbatuara dhe pastaj institucionet që duhet t'i zbatojnë ligjet po kërkojnë nga Komisioni për Legjislacion, që t'u bëjë interpretime të ligjeve. Ne s'kemi atë të drejtë, ose atë përgjegjësi, që të bëjmë interpretime të ligjeve. Andaj, duhet që në përkufizime të jenë të definuar secili emërtim që përmban ky projektligj.

Tek po të njëjtat përkufizime, aty ku specifikohet se çfarë nënkupton "zyrtar i lartë", i referohet Ligjit për deklarimin e pasurisë. Mendoj se ky projektligj duhet të specifikojë, se kush janë saktësisht zyrtarët e lartë dhe jo të ketë referime tek Ligji për deklarim të pasurisë.

Në po të njëjtin projektligj, thuhet se personi që ofron informata të bazuara për rastet e konfliktit të interesit gëzon mbrojtje me ligj. Shtrohet pyetja, me cilin ligj? Cila është ajo mbrojtje, sepse ne kemi shumë raste, kur qytetarëve apo zyrtarëve u kthehet me humbje të vendit të punës, në rast se raporton çfarëdo shkeljeje, qoftë edhe rastin e konfliktit të interesit.

Rastin e fundit e kemi, për shembull: në Agjencinë AKI, ku inspektori i AKI-së largohet nga vendi i punës për shkak të raportimeve për keqpërdorime. Domethënë, largohet nga vendi i punës

ai që i ka raportuar keqpërdorimet në AKI. Ndërsa, ai më flagrant i është kur një zyrtar i ndërpritet marrëdhënia e punës, sepse ka kërkuar në rrjetin social, që qytetarët të mos blejnë produkte serbe. Pra, kjo ka ndodhur në komunën e Pejës. Po ashtu, ne kemi në fuqi Ligjin për mbrojtjen e informatorit, që ka mbetur i pazbatueshëm, pikërisht për shkak të frikës, shantazhit e kërcënimeve që mund të vijnë nga zyrtarët.

Më tej, mendoj se duhet të bëhet qartësim i afateve, në rastet kur Agjencia Kundër Korrupsionit vendos për konfliktin e interesit, por po ashtu edhe shkurtim të afateve, kur rasti shqyrtohet nga institucioni përkatës për ndonjë zyrtar, sepse konsideroj se afati tridhjetë ditor është jashtëzakonisht i gjatë. Pra, në secilin rast duhet të vendosen afate strikte dhe jo të mbetet në diskrecion të institucionit.

Më tutje, diku përmendet “person zyrtar”, diku “zyrtar i lartë”,... mendoj se duhet një unifikim i terminologjisë në këtë drejtim.

Në nenin që flitet për kufizimet që i kanë zyrtarët e lartë, pra ata nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e përmbaruesve, noterëve, falimentuesve, por nuk janë përfshirë ndërmjetësuesit. Pse nuk është bërë diçka e tillë? Sepse, mendoj që duhet edhe ndërmjetësuesve t’u ndalohej. Në disa prej dispozitave të këtij projektligji parashihet një fuqizim i institucioneve karshi rasteve të konfliktit të interesit, në anën tjetër nuk është bërë asgjë në praktikë, pra nuk është menduar një fuqizim i institucioneve edhe në praktikë, për t’u parandaluar rastet e konfliktit të interesit. Po flas për institucionet, sepse së pari ato duhet ta identifikojnë, në qoftë se ka një zyrtar konflikt të interesit.

Mendoj se ngritja e mekanizmave përbrenda institucioneve për të parandaluar rastet e konfliktit të interesit është e rëndësishme, në mënyrë që të mos kemi raste të shumta të konflikteve të interesit.

Lëvizja “Vetëvendosje” në këtë fazë do ta votojë këtë projektligj, me qëllimin e vetëm që t’i adresojë këto amendamente, sepse mendojmë se në qoftë se bëhen këto amendamente, ky ligj është më i mirë se sa që e kemi aktualisht. Pra, i vetmi qëllim se përse do ta përkrahim është për shkak se do t’i përpilojmë amendamentet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Agim Ademaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe mendojmë se është një projektligj mjaft i rëndësishëm në zinxhirin e infrastrukturës ligjore, që rregullon parandalimin, ose zvogëlimin e mundësisë për

zyrtarë të lartë shtetëror, që me ndërlidhjen e dy ose më shumë punëve, t'i krijojnë favore vetes së tyre dhe mundësi për përfitime të paligjshme.

Edhe unë dua të cek fillimisht, se gjatë vitit të kaluar kemi punuar në plotësim ndryshimin e këtij projektligji, por është tërhequr nga Qeveria të dy herët, në momentin e fundit.

Sido që të jetë, tani kemi një projektligj të ri rreth konfliktit të interesit dhe se ky projektligj është më i kompletuar dhe më i avancuar, krahasuar me ligjin aktual, që është në fuqi.

Duhet të jap një vërejtje për Ministrinë e Drejtësisë, kur bëhet fjalë për memorandum shpjegues të këtij projektligji. Gjatë krejt memorandumit shpjegues flitet për plotësim ndryshime të projektligjit, e në realitet Ministria e Drejtësisë ka sjellë një projektligj krejt të ri. Po e them këtë qëllimisht, që të kenë kujdes stafi juaj atje se këto arkivohen diku dhe nuk është mirë që të ndodhin gjëra të tilla.

Krejt në fund, unë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së parimisht përkrahim projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe ju ftojme që ta votoni. Dihet që në mes dy leximeve do të ketë punë, që ky ligj të vihet në binarët e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Time Kadrijaj flet për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Ky projektligj është një projektligj i rëndësisë së veçantë. E thanë edhe deputetët paraprakë, dy herë është amendamentuar me përkushtim nga komisioni përkatës parlamentar dhe në fund, pa asnjë arsytim, është tërhequr nga Qeveria. Nuk është dashur të lejohet që deputetët të punojnë me aq përkushtim, për ta bërë një projektligj të mirë apo për ta bërë një ligj të mirë dhe më pas, për interesa të Qeverisë, të tërhiqet.

Unë besoj që, meqenëse ky projektligj është edhe pjesë e Agjendës Evropiane, është amendamentuar mirë, ose është hartuar mirë, dhe janë precizuar se çfarë është "konflikt interesi", në cilat shkallë janë specifikuar, sepse ne kemi raste praktike kur konflikt interesi është konsideruar, për shembull: një zyrtar që nuk është në ndonjë pozicion të lartë në administratë publike, ose drejtor i një departamenti, në një punë tjetër pak më të vogël, konsiderohet si konflikt interesi. Ndërsa, sipas disa raporteve që i kanë bërë disa organizata, shihet se zyrtarë të lartë në nivel të deputetëve, në nivel të ministrave dhe zëvendësministrave, posedojnë deri në katër vende pune, gjë që është e papranueshme, duke ditur se në çfarë gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale është Kosova.

Unë mendoj se deputetët në Komisionin Parlamentar duhet të punojnë me përkushtim në këtë projektligj, t'i specifikojnë drejtë dhe saktë, se cila dhe çfarë është konflikti i interesit. Nuk mendoj, që në këtë situatë duhet t'i lejohet dikujt, zyrtarëve të lartë, të kenë më shumë se një vend pune, sepse është padrejtësi ndaj qytetarëve të tjerë, të cilët presin për një vend pune.

Ne mendojmë se gjatë amendamentimit të këtij projektligji, si Grup Parlamentar, do ta japim kontributin tonë maksimal dhe do ta përkrahim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Shukri Buja!

SHUKRI BUJA: Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje, kolegë deputetë,

Shpresoj se këtë herë do të kalojë ky ligj, sepse dy herë është rikthyer, po edhe zoti Aliu e tha se nuk i dimë arsyet pse u rikthye. U rikthye sepse s'u patën sistemuar ende njerëzit dhe besoj se është kryer deri tash sistemi në kundërshtim me interesin publik. Kanë mbetur edhe disa, por deri sa të kryhet, besoj se do të sistemohen dhe do të zbatohet ky ligj, zonja Haxhiu, sepse janë kryer këto punë.

Dhe, në rast se ndërron kjo Qeveri dhe ndërrohen institucionet, atëherë do të jetë problem të ndërrohen dhe duhet respektuar këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Buja! Deputeti Ismajl Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë,

Qeveria e Kosovës, në pajtim me nenin 93 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 19 dhjetor 2014 i pati propozuar Kuvendit të Kosovës ta miratojë këtë projektligj.

Kuvendi i Kosovës më 23 janar 2015 e miratoi në parim këtë projektligj dhe caktoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funkcional dhe përgjegjës për të raportuar për projektligjin.

Komisioni Funkcional, përveç tjerash, pati vlerësuar në vitin 2015 se është e nevojshme të bëhen kufizime shtesë të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksioneve, krahas ushtrimit të funksionit publik.

Lidhur me këtë, komisioni pati propozuar që zyrtarëve të lartë t'u ndalohej ushtrimi i një e më shumë funksioneve në sektorin publik.

Me amendamentin 6 të Komisionit Funkcional, të vendosur në nenin 16, pika 4, u propozua si në vijim: "Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik".

Këtë projektligj Qeveria e tërhoqi ditën kur duhej të kalonte në leximin e dytë, në maj 2015, pa dhënë asnjë arsytim, edhe pse arsyetimet ishin të kuptueshme. Aty prekeshin interesat e atyre zyrtarëve të lartë me ndikim që edhe ndikuan të tërhiqet ligji, me premtimin se projektligji do të kthehet në Kuvend brenda 2-3 ditëve.

Tani, pas 2 vjetëve projektligji është kthyer në Kuvend dhe është propozimi i Komisionit Funkcional që zyrtarëve të lartë t'u ndalohet ushtrimi i më shumë se një funksioni në sektorin publik është tretur.

Në versionin e ri të projektligjit, në lidhje me këtë çështje, thuhet: “Zyrtari i lartë nuk mund të jetë i punësuar me kohë të plotë në një detyrë tjetër”.

Që i bie se, sipas këtij formulimi të ri, zyrtari i lartë mund të jetë i punësuar edhe në ndonjë detyrë tjetër, por jo 100%, por ta zëmë, për shembull, 90% të kohës së plotë.

Pra, në kohën kur papunësia në Kosovë është shumë e theksuar, zyrtarët e lartë assesi nuk po donë të heqin dorë nga privilegjet që të kenë më shumë vende pune, edhe pse në Kosovë një vend pune konsiderohet privilegj, për shkak të papunësisë së lartë që është si rezultat edhe i keqqeverisjes aktuale, por edhe i qeverive të mëparshme.

Prandaj, edhe pse në kushte normale, punësimi është e drejtë elementare njerëzore dhe, për fat të keq, shumë qytetarë të Kosovës nuk po mund ta realizojnë.

Ky projektligj, që ka për qëllim forcimin e integritetit të sektorit publik dhe garantimin e kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente, në shërbim të interesit publik, nëpërmjet të identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit të zyrtarëve, është i mirëseardhur, nëse arrijmë ta jetësojmë dhe nuk e pëson fatin e shumë ligjeve të tjera në Kosovë që nuk po gjejnë zbatim.

Kur e kemi parasysh se sanksionet e parapara për ata që nuk e respektojnë këtë ligj janë simbolike, se inicimi i procedurës për konflikt interesi nuk mund të fillojë nëse kanë kaluar 2 vjet dhe dihet se këto gjëra zvarriten përherë më shumë se 2 vjet nga data e kryerjes së veprimt dhe se shkelësit potencialë janë zyrtarë të lartë, gjasat për shkeljen e këtij ligji janë të mëdha.

Sidoqoftë, unë përkrah formulimin e mëhershëm të Komisionit Funkcional që zyrtarëve të lartë t'u ndalohet ta ushtrojnë më shumë se një detyrë, sepse në Kosovë ka mjaft njerëz të kualifikuar, të cilët me vjet presin punë, e nuk po u vjen radha për shkak të mosngopjes së zyrtarëve me ndikim në këtë qeveri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministre, a keni koment? Atëherë, kolegë deputetë, më lejoni nga kjo pozitë ku jam t'i them dy-tri fjalë për këtë ligj.

Është e vërtetë se është një ligj me shumë rëndësi dhe është e vërtetë se ka ardhur tri herë në variacione.

Tashti e kemi në një variant, për të cilin foli Agim Ademaj dhe e theksoi një të vërtetë, se tash vjen si ligj i ri, ndonëse është prodhim i amendamentimit.

Për korrektësi të paraqitjes së historisë së tij, do të duhej të thuej, ajo funksionalisht sot nuk thotë diçka të veçantë, sepse ne po e bëjmë leximin e parë të këtij formulimi.

Unë, në të vërtetë desha të theksoj se ky ligj është i shkruar me përkufizime shumë të ngatërruara në shqip, shpeshherë kundërthënëse dhe jo të sakta.

Kam parasysh: “personi i afërm” te neni 1.6, kam parasysh “personi i besuar” te 1.7.

Edhe më fort te përkufizimet ku ka tentim që në mënyrën më kapitale të theksohet çka është konflikt interesi.

Te neni 5. Pika 6, thuhet: “Zyrtarit nuk i lejohet të kryejë ose të mos e kryejë një veprim të kundërligjshëm gjatë ushtrimit të funksionit të tij, me qëllim të marrjes së një përfitimi të padrejtë për vete ose një person apo subjekt tjetër”.

Lexoni mirë secili, nëse e keni. Pra, vërtet nëse e lexoni ligjin para vetes dhe e shihni se kjo nuk ka kurrfarë kuptimi, sepse e kundërshton vetveten në formulim.

Edhe neni 6, i cili thotë, dhe vërtet e ka prapë përkufizimin - elementaren, po e quaj themelor, kapital, bile e ka titullin përcaktues “Konflikti i interesit”, duket kështu, dhe thotë:

“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilin zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij publike”.

Variacionet “ndikon”, “mund të ndikojë” dhe kjo “duket se ndikon”, i bie se në dukje mund të ndikojë ose perceptim që i thonë nganjëherë me fjalë të tjera, ose dukje ose përngjasim, në një ligj të tillë nuk thotë kurrëgjë. Sepse, përngjasimi është problem i perceptimit individual të dikujt dhe s'ka të bëjë me të vërtetën kurrë.

Dhe, unë nuk dua të precizoj më tutje, veçse desha në këtë rast dhe lexim të parë, që unë i kam disa vërejtje konkrete dhe mund t'i paraqes në leximet e më tutjeshme, që të kihet parasysh, sepse unë po i bie më saktë e më shkurtë.

Në variante të gjuhëve të tjera nuk janë këto dysi. Atëherë, këtu është njëfarë kolazhi i çuditshëm, herë në një gjuhë është i saktë e në tjetrën është i pasaktë, i bie që është copa-copa i ndërtuar, pa një sintaksë dhe një saktësi të barasvlershme të termave themelorë.

Unë edhe një herë rreth këtij ligji vetëm desha të them se mendoj që duhet të kalohet kësaj radhe. Pra, të bëhemi seriozë dhe edhe deputetët dhe të tjerët e të mos shtyhet për afate e mandate të tjera, të saktësohet dhe sa mund të saktësohet, sepse edhe kështu si është shumë më i mirë se sa ata që për një kategori tërhiqeshin.

Mendoj se edhe ministrja e Drejtësisë na bëri lutje ta votojmë dhe s'do ta tërheqë edhe kjo në fund. E mbaj për fjale, prandaj edhe u thirra në të. Na ka lutur ta votojmë dhe besoj se ne e marrim të drejtën, po e quaj tash unë, morale që t'ia përmendim.

Atëherë, kalojmë, duke pritur mbledhjen e deputetëve, te pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës, që është:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë këtë projektligj.

Ftoj zonjën ministre, Dhurata Hoxha, sepse sot qenka kujdestare e Qeverisë, që të paraqesë ligjin që ka të bëjë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor para deputetëve të Kuvendit. Urdhëroni!

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Të nderuar deputetë,
Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor në politikat zhvillimore për mjedisin ka pikësynim arritjen e nivelit të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe të planifikimit bashkëkohor hapësinor.

Për realizmin e këtyre qëllimeve është domosdoshmëri ngritja e infrastrukturës ligjore, koherente dhe të harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si dhe ligjet nga fushat e tjera, si pjesë të legjislacionit në Kosovë.

Me këtë projektligj mundësohet krijimi, mbledhja si dhe shkëmbimi i informacioneve të centralizuara me vendet e tjera, sipas praktikave të Bashkimit Evropian, bëhet përcaktimi i qartë i përgjegjësive të strukturave qeverisëse të Kosovës, si dhe i kompetencave për krijimin, grumbullimin dhe shkëmbimin e informacioneve gjeo-hapësinore në Republikën e Kosovës.

Krijohet mundësia për përcaktim të qartë të kriterëve për krijimin e informacioneve, meta-datave si pjesë të infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore për Republikën e Kosovës.

Gjithashtu harmonizohet legjislacioni i Kosovës me direktivat e infrastrukturës dhe informacioneve hapësinore për Bashkimin Evropian, të rregulluara me Direktivën 2007/2, e që është obligim për vendet e Bashkimit Evropian dhe të atyre që e pretendojnë atë anëtarësim.

Andaj, kërkoj nga ju që ky projektligj të mbështetet dhe të procedohet më tej.

KRYESUESI: E hap debatin për diskutim në parim. Ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, Duda Balje, të paraqesë raportin. Nuk po e shoh këtë zonjën! Urdhëroni! Fjalën e ka Salih Salihu, në emër të komisionit?

SALIH SALIHU: Po, kryesues, në emër të Komisionit.

Faleminderit, kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1. 2. 2017 e shqyrtoi në parim Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-136 për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës.

Kryesues, meqë e kam fjalën, po e paraqes edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe duke parë rëndësinë e këtij ligji që edhe Kosova ta ketë një data-bazë të infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, në parim e përkrah këtë projektligj dhe propozon që të miratohet sot në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash do të dëgjojmë mendimet e përfaqësuesve, ose të grupeve parlamentare.

Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike, Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka diskutuar lidhur me Ligjin për infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor dhe çështjet kryesore të trajtuara në këtë ligj janë të dhënat hapësinore të rëndësishme dhe të domosdoshme për Republikën e Kosovës.

Këto të dhëna, ç'është e vërteta, janë mbledhur deri më tani dhe tani duhet të bëhet një organizim më i mirë i mbledhjes në një vend që do të raportohen në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe parë nga implikimet financiare, duke punuar ndaras këto institucione, janë duke u financuar momentalisht, ky projektligj nuk prodhon ndonjë implikim financiar dhe na e jep mundësinë që ta kalojmë sa më shpejt.

Është i bazuar në frymën e “acquis communautaire” sipas projekteve ins-Fair që paraqiten si nevojë e standardeve të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Po ashtu janë konsultuar, sipas këtij ligji, edhe ministritë përkatëse dhe besoj se do të kalojë shumë shpejt në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike flet Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës dhe do ta përkrahë në parim votimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj. Kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit në komisionin përkatës dhe do ta përkrahim në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “6+” flet deputeti Qerim Bajrami!

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se predsedavajuću!

Uzimajući u obzir da imam informaciju o važnosti ovoga zakona, i mi ćemo u načelu podržati njegovo prvo glasanje, a kasnije ćemo dati i doprinos, eventualno kroz dopune i izmene. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur për diskutim nuk ka.

14. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave

Të nderuar deputetë, Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hotni, të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja ministre,

Çështja kryesore e trajtuar në këtë projektligj është ratifikimi i Marrëveshjes për bashkëpunim financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Kjo marrëveshje i mundëson Qeverisë së Kosovës marrje të huas nga Qeveria austriake deri në vlerën prej 30 milionë eurove vetëm për investime kapitale, me afat kthimi deri në 15,5 vjet, me 4 vjet greis-periudhë, me normë interesi 0% që mund të ndryshojë varësisht prej shkallës së rrezikut në ekonominë e vendit, e që vendoset në baza të rregullta nga OECD-e.

Projektet ku pritet të investohen janë: trajtimi i ujërave të zeza, furnizimi me ujë të pijes, shëndetësia, arsimit, bujqësia dhe sektorë të tjerë që janë në përputhje me prioritetet e Qeverisë të parapara në Programin qeverisës dhe Strategjinë kombëtare për zhvillim.

Në këtë marrëveshje janë financuar tanimë disa projekte, sepse është marrëveshje e vitit 2012, e shtyrë edhe për dy vjet, deri në fund të vitit 2016 dhe është projekti në fushën e E-edukimit në Ministrinë e Arsimit, në vlerë prej rreth 5 milionë euro dhe është projekti tjetër në fushën e kardiologjisë në shumën prej 2,6 milionë eurosh.

Kjo marrëveshje për bashkëpunim financiar përcakton kushtet brenda të cilave financohen projekte specifike nëpër sektorë që i përmenda më lart. Pra, është marrëveshje kornizë dhe marrëveshjet specifike për secilin projekt do të diskutohen veç e veç dhe do të sillen në Kuvend për ratifikim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet e Financa, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 18 dhe 93, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-154 për marrëveshjen ndërkombëtare ia ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin Nr. 05/L-152 për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Austrisë.

Projektligji, respektivisht marrëveshja ka për qëllim ofrimin e kredisë prej 30 milionë eurove, shumë kjo që parashihet për investime, si në sektorin e bujqësisë, sektorin e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza, në sektorin e shëndetësisë, sektorin e trajtimit të mbeturinave, sektorin e arsimit dhe trajtimin personal, fushën e infrastrukturës, mbrojtjen civile dhe I-qeverisjen.

Periudha e kthimit të kësaj kredie është 15,5 vjet, me greis-periudhë 4 vjet dhe normë interesi prej 0%.

Kjo marrëveshje është kornizë e marrëveshjes konsensuale, ku bazohet në rregullat e OECD-së. Marrëveshja në fjalë do të jetë pjesë e klauzolës së investimeve.

Komisioni për Buxhet e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 28. 2. 2017, pasi e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë, vlerëson rëndësinë dhe kushtet e investimeve të marrëveshjes për bashkëpunimin financiar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Austrisë dhe njëherësh Kuvendit i rekomandon ta miratojë.

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i LDK-së mbështet rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa dhe fton që kjo marrëveshje të votohet në momentin kur sigurohen 2/3 e votës në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare nuk shoh se janë paraqitur për të marrë fjalën.

15. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar

Të nderuar deputetë, Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj ratifikon Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Qeverisë hungareze për themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar.

Marrëveshja në fjalë është nënshkruar pasi janë kryer të gjitha procedurat ligjore dhe janë marrë aprovimet e nevojshme, siç parashihet me ligj.

Kjo marrëveshje përmban kornizën dhe kushtet bazë financiare për projekte në trajtimin e ujërave të zeza, furnizimit me ujë dhe në infrastrukturë.

Marrëveshja kornizë me vlerë prej 62 milionë eurosh, me normë efektive të interesit 0%, me greis- periudhë 1,5 vjet dhe me periudhë të kthimit 17 vjet.

Unë ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, për arsyetim të raportit dhe rekomandimin.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Po ashtu kemi edhe një ratifikim, ku Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 18 dhe 93.3 e Kushtetutës së Republikës dhe në bazë të nenit 100, paragrafi 1.4, dhe paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L 153 për Marrëveshje ndërkombëtare i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin për Marrëveshjen për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Hungarisë.

Projektligji, respektivisht marrëveshja e nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë ka për qëllim financimin e aktiviteteve për zhvillimin dhe përmirësimin për realizimin e projekteve në sektorin e ujërave të zeza dhe infrastrukturës me kushte të volitshme.

Huadhënësi pajtohet që t'i japë huamarrësit një kredi në shumë prej 62 milionë eurosh për realizimin e këtij programi.

Periudha e kthimit është 17 vjet. Ndërsa interesi vjetor në shumën e tërhequr është 0%. Shuma e parë duhet të paguhet për 24 muaj nga përfundimi i çdo projekti.

Komisioni e ka shqyrtuar ratifikimin në fjalë Marrëveshjen për ratifikim më datën 28 shkurt dhe i rekomandon Kuvendit që të votohet.

Po ashtu, edhe Grupi Parlamentar e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe e fton Kuvendin që ta votojë ratifikimin në fjalë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur për të diskutuar. Regjistrohu.... Driton Çausi.

DRITON ÇAUSHI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i ka analizuar këto projektligje, e kam fjalën për këtë që po trajtohet aktualisht dhe atë paraprak.

Brenga e vetme është kontributi në borxhin e përgjithshëm të Qeverisë së Kosovës që këto katër marrëveshje dhe dy vijuese bëjnë dhe tjetra është për dy të parat, për këtë aktuale dhe atë me Qeverinë austriake, janë të përcaktuara fushat, mirëpo ne vlerësojmë se duhet të ketë një qartësi më të madhe të projektet, ku këto investime ose këto hua do të fokusohen, për shkak se duke u bazuar pak në të kaluarën dhe duke qenë në një situatë të ngjashme me një fushatë paraelektorale, vlerësojmë se mundësia e keqpërdorimit të këtyre fondeve është reale nga pushteti aktual. Gjegjësisht, në komunat ku koalicioni qeverisës mund ta vlerësojë si të dobishme një gjë të tillë.

Pavarësisht këtyre vërejtjeve, ne e përkrahim parimisht këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Nuk ka të tjerë që duan të diskutojnë.

16. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-154 për ratifikimin e Protokollit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, dhe të Marrëveshjes për Hua për zbatimin e Protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave së Republikës së Kosovës dhe NATIXIS

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjit për ratifikimin e protokollit financiar dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRI AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj ratifikon dy çështje: protokollin financiar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës të 5 korrikut 2016, nënshkruar në Paris, në takimin e kryeministrave të Ballkanit Perëndimor dhe Marrëveshjen për hua për zbatimin e këtij protokollin ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesit të Qeverisë franceze, NATIXIS.

Marrëveshja për hua parasheh financimin e projektit për trajtimin e ujërave të zeza në komunat e Prishtinës, Fushë-Kosovës dhe të Obiliqit.

Në përputhje me vendimin e Qeverisë dhe autorizimin e presidentit, unë e kam nënshkruar këtë marrëveshje më 19 janar 2017.

Marrëveshja është në vlerë prej 66 milionë eurosh dhe ka kushte mjaft të volitshme, me normë efektive të interesit prej 0.036%, me greis-periodhë 5 vjet dhe afat kthimi prej 25 vjetësh.

Unë ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër!

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të nenit 18 dhe 93.3 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 10, paragrafi 1.4 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-154 për Marrëveshje ndërkombëtare i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin për Marrëveshje për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Francës.

Po ashtu komisioni ka vlerësuar këtë ratifikim, këtë marrëveshje dhe i rekomandon Kuvendit që ta aprovojë, pasi që kjo kredi jepet në kushte të volitshme.

Njëkohësisht u bëjmë ftesë deputetëve që të gjitha këto ratifikime, sikur këtë që ka të bëjë në veçanti për trajtimin e ujërave të zeza në komunat të cilat i përmendi edhe ministri: Prishtinë, Fushë-Kosovë dhe Obiliq, ndërtimin e impianteve, të cilat i trajtojnë këto ujëra, që të votohet në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që do të diskutojnë për këtë çështje.

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Komisioni për Legjislacion ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Atëherë e ftoj deputetin Armend Zemaj, që në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Në emër të komisionit dhe në emër të grupit punues e paraqes raportin për mbikëqyrjen e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-033 dhe Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-035.

Kolegë deputetë,

Do të mundohem të jem i shkurtër, sepse të gjithë e keni raportin përpara, unë besoj që e keni lexuar, e keni shqyrtuar.

Është një prej raporteve të mbikëqyrjes të zbatueshmërisë së ligjit, i cili Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, pas shqyrtimit të listës së ligjeve të miratuara në Kosovë brenda fushëveprimit të tij vendosi të mbikëqyrë zbatimin e këtyre dy ligjeve.

Duke pasur parasysh faktin që ligjet në fjalë janë nënshtruar ndryshimeve të shpeshta, edhe atë në periudha të shkurtra kohore dhe duke marrë për bazë faktin që këto ndryshime janë bërë me procedura të përshpejtuara, komisioni vendosi që të mbikëqyrë zbatimin e tyre për të parë për së afërmi nëse këto ndryshime kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit në punën e gjyqësorit.

Dhe, si rezultat i këtyre shqetësimeve komisioni vendosi që në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve për të parë në të gjitha fushat se cilat do të jenë problematikat që duhen të adresohen.

Aktiviteti i komisionit për mbikëqyrjen e këtyre dy ligjeve dhe gjetjet e prezantuara në këtë raport janë rezultat i mbikëqyrjes që është zhvilluar nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me institucionet relevante, që përfshin aktivitetet, si në vijim:

Më lejoni të theksoj se për herë të parë Kuvendi i Republikës së Kosovës, grupi punues, Komisioni për Legjislacion i ka realizuar këto vizita me institucionet e drejtësisë me qëllimin që ta avancojë bashkëpunimin institucional si kategori kushtetuese për qëllim të avancimit të sistemit të drejtësisë në vend.

Takimet kanë ndodhur me: Këshillin Gjyqësor, Gjykatën Themelore të Prishtinës, Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, Gjykatën Themelore në Pejë, Zyrën e Prokurorit Disiplinor, Kryeprokurorin e Shtetit, Degën e Gjykatës së Prishtinës në Lipjan, Gjykatën Supreme të Kosovës dhe në Gjykatën e Apelit.

Grupi punues gjatë këtyre vizitave, domethënë shprehu edhe qëllimin e vet se zbatueshmëria e ligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial ishte synim që të njoftohemi për së afërmi me sfidat dhe ngecjet që ka sistemi i drejtësisë në vend.

Shqetësimet që u paraqitën edhe nga komisioni, edhe nga anëtarët e grupit punues, më lejoni t'i përmend se ishin zonja Selvije Halimi, nënkryetare e komisionit, zonja Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit dhe unë Armend Zemaj, qëllimi ishte që të shihen organizimi, mosha, përvoja e punës, integrimi i gjeneratës së re, parashkrimi i lëndëve dhe shumë shqetësime tjera, të cilat gjatë tërë procedurës dhe gjatë takimit i kanë paraqitur anëtarët e grupit punues.

Kolegë deputetë,

Më lejoni që t'i shpreh apo t'i qartësoj përfundimet që i ka gjetur komisioni dhe të cilat janë miratuar edhe në mbledhjet e komisionit: grupi punues i ka paraqitur këto përfundime për sistemin e drejtësisë, apo për gjyqësorin, në përgjithësi. Ne e kemi gjetur që buxheti është i pamjaftueshëm, mungesa e numrit të gjyqtarëve, e prokurorëve dhe stafit administrativ, veçmas e theksuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës, si një ndër gjykatat më të ngarkuara nga aspekti territorial dhe numri i banorëve; mungesa e stafit dhe e bashkëpunëtorëve profesionalë, punësimi i stafit me kontratë mbi vepër si rezultat i pengesave në rekrutim të stafit në Gjykatën Themelore të Prishtinës, vonesa në nxjerrjen e akteve nënligjore, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet KGJK-së, KPK-së me Ministrinë e Drejtësisë me rastin e hartimit të ligjeve që preken në këtë fushë.

Dispozita përfshijnë nga evidenca të masave disiplinore duke përcaktuar edhe afatin kohor, vendosja e një pragu minimal të përvojës për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe atij Prokurorial, të ndryshohet mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Prokurorial nga Kuvendi, të ndryshohet përbërja dhe mënyra e përfaqësimit të Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor, të diskutohet çështja e bartjes së lëndëve për të menaxhuar me ngarkesat që kanë disa gjykata, Oda e Avokatëve të përfaqësohet apo të mos përfaqësohet me këta këshilla, të bëhen ndryshime duke mos lënë hapësirë interpretimi të dyfishtë për mënyrën e kompensimit të anëtarëve të Këshillit Prokurorial.

Transferimi i gjyqtarëve nuk ka dhënë rezultatet e pritshme, decentralizimi duhet të rishikohet nga KGJK-ja, sepse bartja e kompetencave të kryetarët e gjykatave për çështjet financiare dhe të prokurimit ka bërë të ketë ngarkesa shtesë për gjyqtarët dhe e fundit - Zyra e Prokurorit Disiplinor është diskutuar shumë nëse të bartet si pjesë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, apo duhet të ndryshohet afati ligjor për parashkrimin e shkeljeve disiplinore.

Sipas këtyre të gjeturave, komisioni për Ministrinë e Drejtësisë ka nxjerrë këto rekomandime, të cilat më lejoni t'i lexoj dhe besoj që edhe kolegët tjerë deputetë dhe të gjithë deputetët tjerë do të kenë mundësi që t'i inkorporojnë sipas interesimit të tyre. Rekomandimet rezultojnë:

1. Të hartohen ligje të reja për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës për shkak të ndryshimeve të shpeshta të ligjeve në fuqi, duke marrë për bazë të gjetura nga ky raport, obligohet Ministria e Drejtësisë,

2. Të ketë bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës gjatë hartimit të ligjeve të obligohen Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës,

3. Të ketë harmonizim ndërmjet të dy ligjeve, ajo që ndryshohet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të përfshihet edhe në Ligjin për Këshillin Prokurorial kur bëhet fjalë për çështje të njëjta, si rekrutim, kompensim, vlerësim, parashkrim, buxhet e tjerë,

4. Me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2017, të ndahet buxhet shtesë për rritjen e numrit të gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë, obligohet Ministria e Financave.

Në emër të komisionit dhe të Grupit Punues ju ftoj që t'i aprovoni këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e ka Nezir Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar kryesues,

E nderuar ministre,

Ministra të nderuar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe atë për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe si i tillë do t'i japë një përkrahje të plotë.

Në të njëjtën kohë, kërkojmë nga ministrja e Drejtësisë që gjatë plotësim- ndryshimit apo edhe hartimit të ligjeve të reja t'i kenë parasysh të gjitha rekomandimet dhe vërejtjet që i tha raportuesi në emër të grupit punues dhe komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

U përmend edhe nga zoti Zemaj që përbërja e grupit punues që i ka mbikëqyrur apo monitoruar këto dy ligje, pra Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Ligjin për Këshillin Prokurorial, kam qenë edhe unë anëtare e këtij grupi punues, dhe në Komisionin për Legjislacion në kohën kur është

kërkuar që të procedohet për seancë plenare, kam kërkuar që të mblidhemi edhe një herë si grup punues për t'i evidentuar disa probleme me të cilat ballafaqohen Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, mirëpo për shkak të rrethanave nuk kam mundur që t'i adresoj në grupin punues këto çështje dhe natyrisht që disa prej tyre po i përmend këtu.

Ne jemi dëshmitarë të asaj se në çfarë gjendje është sot sistemi i drejtësisë, domethënë me ndikimet politike, apo me futjen e dorës së padukshme të Qeverisë në sistemin e drejtësisë, mirëpo sot nuk do të flas për këtë çështje, do të rezervohem që në një seancë tjetër të flas për këtë çështje. Do të flas vetëm për disa që kanë të bëjnë me Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Në këtë raport nuk është evidentuar mungesa e bashkëpunimit dhe e koordinimit ndërmjet dy këshillave, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, gjatë plotësim-ndryshimit të akteve të brendshme të KGJK-së dhe KPK-së.

E po ashtu, edhe mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në miratimin e legjislacionit sekondar, që është jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm. Një prej përfundimeve të këtij raporti thuhet, madje i pari është buxheti i pamjaftueshëm. Është për keqardhje që për sistemin e drejtësisë ende nuk ndahet as 2% e totalit buxhetor. Domethënë vetëm 1,90% e diçka ndahet për sistemin e drejtësisë në kohën kur sistemi i drejtësisë ballafaqohet me probleme jashtëzakonisht shumë të mëdha. Unë shpresoj që në buxhetin e ardhshëm, por uroj që kjo qeveri të mos ketë mandat deri në atë kohë, mirëpo është tepër e rëndësishme që të ndahet buxhet për sistemin e drejtësisë. E kam përmendur disa herë, po e përmend edhe këtu, vetëm vendet e rajonit nga buxhetet e tyre 5% e totalit domethënë ndajnë apo rezervohet për sistemin e drejtësisë, sepse fjalët i keni shumë të mëdha, themi që do ta forcojmë sistemin e drejtësisë, në anën tjetër nuk ndahet buxhet për këtë sistem.

Dhe, në qoftë se duam ta forcojmë sistemin e drejtësisë, kjo duhet të reflektohet para se gjithash në buxhet. Një prej përfundimeve tjera është që nga KGJK-ja dhe KPK-ja të kontrollohen aktivitetet e gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë orarit të punës lidhur me angazhimet e tyre. Sipas Ligjit për KPK-në dhe KGJK-në, domethënë gjyqtarët dhe prokurorët mund të ligjërojnë pas orarit të tyre zyrtarë. Unë kam informata nga studentët që edhe brenda orarit zyrtarët gjyqtarët dhe prokurorët ligjërojnë. Domethënë është shkelje e ligjit nga ata që duhet ta respektojnë ligjin.

Dhe KGJK-ja dhe KPK-ja kanë dështuar që ta kenë një evidencë së pari të gjyqtarëve dhe prokurorëve kush ligjëron nëpër universitetet publike dhe private. Për mendimin tim nuk duhet t'u lihet kjo e drejtë, por kështu ka vendosur Kuvendi dhe po ashtu ka dështuar që t'i evidentojë rastet kur gjyqtarët dhe prokurorët e shkelin ligjin, sepse ligjërojnë gjatë orarit të punës. Kjo u ndalohet me ligj.

Tjetër çështje që e parash ky raport është që të ruhet pavarësia e ZPD-së. Ka një insistim të Ministrisë së Drejtësisë që Zyrën e Prokurorit Disiplinor ta vendosë nën kthetrat e Ministrisë së

Drejtësisë. Domethënë, ka qenë një tendencë, tash po e shoh ministrja e Drejtësisë po e thotë të kundërtën, domethënë kanë hequr dorë nga kjo dhe unë e përsëris për faktin që është jashtëzakonisht e rëndësishme në qoftë se Zyra e Prokurorit Disiplinor vendoset në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Në këtë raport thuhet se nuk janë nxjerrë aktet nënligjore, ose rregulloret në fakt, nga KGJK-ja dhe KPK-ja. Unë dua ta theksoj faktin se është dashur të renditen se cilat nga rregulloret kanë dështuar që t'i nxjerrë Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, për shembull: ajo për transparencë dhe llogaridhënie e sistemit prokurorial dhe gjyqësor dhe ajo për komunikim me medie dhe publikun. Keni parasysh rastin flagrant, kur Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur që t'i mbyllë seancat gjyqësore në rastin e Sali Mekajt. Kjo nuk duhet të lejohet në asnjë mënyrë dhe vjen si pasojë e mospasjes së rregulloreve për këto çështje.

Po ashtu, ka një shprehje të KGJK-së me gjykatat dhe KPK-së me prokuroritë. S'ka llogaridhënie dhe ende s'ka asnjë rast, ku një kryetar i gjykatës apo kryeprokuror është degraduar për shkak të performancës së dobët.

Pra, këto janë disa nga çështjet, të cilat e mora përsipër që t'i adresoj. Natyrisht, për bindjen time, është dashur që raporti të jetë më i plotë dhe përfundimet apo rekomandimet të jenë më përmbajtjesore, mirëpo megjithatë ne si grup parlamentar do ta votojmë raportin e Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Mirjeta Kalludra e ka fjalën.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe pse menjëherë pas votimit të rezolutës kërkoja, që të sqaroj lidhur me votimin tim për rezolutën lidhur me ndalimin e ish-kryeministrit të Kosovës, zoti Ramush Haradinaj në Francë, ishte një gabim teknik nga ana ime dhe e shpreh në mënyrë nominale votën time pro rezolutës së miratuar. Kërkoj nga Administrata e Kuvendit që ta bëjë këtë përmirësim në regji. Faleminderit për mirëkuptim!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka të tjerë të paraqitur. Shënjoje me gisht të lutem, që të regjistrohet, se unë nuk kam... tash është, Time Kadrijaj. AAK, Time Kadrijaj, urdhëro!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Është praktikë e mirë mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, sepse nëse e shohim planin legjislativ shpeshherë duke bërë ligje të shpejta, në fakt ato ligje po janë të paimplementueshme në praktikë dhe shpeshherë po ndodhë kur e kemi planin legjislativ që shumë ligje janë për plotësim ndryshim, gjë që nuk është e mirë.

Ne si grup parlamentar përkrahim këtë raportin e mbikëqyrjes së ligjeve për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe besojmë se rekomandimet që janë dhënë nga Komisioni Parlamentar këto rekomandime do të zbatohen, sepse janë rekomandime që gjatë punës që e bën komisioni në mbikëqyrjen e këtyre ligjeve janë pjesë që nuk zbatohen apo nuk implementohen në praktikë. Këto rekomandime, në fakt, i bëjnë më të implementueshme ligjet në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

17. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-155 për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë për FSDK - Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe arsyetojë këtë projektligj.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj ratifikohet marrëveshja për garancinë shtetërore për marrjen e kredisë nga BERZH-i si linjë kreditore për fondin për sigurimin e depozitave të Kosovës.

Ministria e Financave në janar të këtij viti ka pranuar kërkesën nga fondi për sigurinë e depozitave të Kosovës për emetimin e garancisë të dytë shtetëror për linjën e dytë kreditore në shumë prej 24 milionë euro, e ndarë në tri transhe: në 14, 6 dhe në 4 milionë euro.

Ju informoj se Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2014 ka emetuar një garanci shtetërore për FSDK-në ndaj BERZH-it në shumë prej 10 milionë euro për sigurimin e depozitarëve të vegjël në sektorin bankar të Kosovës.

Propozimi për linjën e re kreditore është bazuar në projeksione financiare duke marrë për bazë rritjen e limitet e depozitave të siguruara sipas ligjit në fuqi, ku specifikohet nga depozitat e siguruara nga data 1 janar 2016 duhet të jenë 4 euro, ndërkaq nga 1 janar 2018 duhet të arrijnë në 5 mijë euro.

Sipas projeksioneve financiare për arritjen e këtyre niveleve të depozitave të siguruara, shuma e linjës së re kreditore duhet të jetë 14 milionë euro nga viti 2016, përkatësisht 20 milionë euro nga viti 2018.

Bazuar në vendimet paraprahe të Qeverisë dhe marrjes së aprovimit nga presidenti, unë kam nënshkruar marrëveshjen e garancisë, e cila ka këto kushte financiare:

- vlera e kredisë është 24 milionë euro, e ndarë në tri transhe;
- 14 milionë zotohen me rastin e hyrjes në fuqi të marrëveshjes financiare;
- 6 milionë bëhen efektive në vitin 2018, me rastin e rritjes së nivelit të depozitave të siguruara në sistemin bankar të Kosovës, nga 4 mijë në 5 mijë euro;
- 4 milionë bëhen efektive në vitin 2020, më rastin e skadimit të linjës së parë kreditore;
- kohëzgjatja e kredisë është 7 vjet me mundësi të shfrytëzimit;
- amortizimi është 12 - 15 vjet;
- me normë të interesit Euriborit + 1% norma vjetore.

Ne vlerësojmë se kushtet e kësaj kredie janë mjaft të favorshme, prandaj ju ftoj që ta aprovonit këtë ligj për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje për garancinë shtetërore. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, për arsyetim të raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të dispozitave në fuqi i ka proceduar Kuvendit të Kosovës për miratim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë së linjës së dytë kreditore për fondin e sigurimeve të depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje Fondi për sigurimin e depozitave të Kosovës i mundësohet qasje në kredi në shumë prej 24 milionë euro nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe kjo kredi është e garantuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës në vitin 2014 ka emëruar një garanci shtetërore për fondin për sigurimin e depozitave ndaj Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në shumën prej 10 milionë eurove, për sigurimin e sektorit të vogël dhe sektorëve bankarë.

Linja e dytë kreditore prej 14 milionë eurove është shtesë, ku së bashku me linjën e parë kreditore, gjithsej 24 milionë euro, është që ky projekt parashihet të përfundojë në vitin 2023. Marrëveshja, respektivisht garantimi i mjeteve nga huadhënësi është në interes për sigurimin më të madh të depozitave të institucioneve financiare dhe për mbrojtjen e depozitave të personave fizikë dhe juridikë, bazuar në ligjin përkatës.

Kredia prej 24 milionë eurosh ndahet në tri transhe, ku transheja e parë është 14 milionë euro, e dyta 6 milionë euro dhe e treta 14 milionë euro. Norma e tarifës së zotimit është 0,5% në vit dhe kjo hua i nënshtrohet normës variable të interesit.

Kredia e lartpërmendur nuk disponohet direkt nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, por krijon obligime për fondin e sigurimit të depozitave të Kosovës deri në momentin kur kjo e fundit, sipas ligjit në fuqi parasheh se ndonjë nga institucionet financiare do të ballafaqohet me vështirësi për sigurimin e depozitave të personave fizikë dhe juridikë. Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj kredie, që garanton sigurimin e depozitave, Komisioni për Buxhet dhe Financa më 28. 2. 2017 i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që të aprovojë marrëveshjen në fjalë.

Me fjalë të tjera, me këtë marrëveshje të katërt sot, ne hyjmë në obligim gjithsej 182 milionë, por duhet pasur parasysh që disa marrëveshje janë kornizë, nuk janë marrëveshje të drejtpërdrejta.

Edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ju ftoj që ta votoni rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa.

KRYESUESI: Kolegë deputetë, i kemi diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës. Ju lus edhe juve, edhe regjinë, të provojmë praninë tash.

Ju lutem, edhe një herë të dimë praninë, le të regjistrohen njerëzit që janë këtu. A keni kartela, regjistrohuni!

Të pranishëm në sallë me kartela janë 48, tash 49, dikush s'ka kartelë. Kush është ai që s'ka kartelë?

Atëherë, faleminderit për sot. Vazhdojmë nesër në orën 10:00, kur kemi vetëm votime. Faleminderit!

* * *

E premte, 10 mars

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 2 dhe 9 mars

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Ju lus që t'i zini vendet,
Po fillojmë vazhdimin e seancës së lënë përgjysmë.
Në sallë ka kuorum të mjaftueshëm për të votuar.

E nderuar ministre e Drejtësisë,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 2 dhe 9 mars 2017.

Pika e katërt, prapë në mungesë të ministrit, hiqet nga rendi i ditës.

Kemi votimet, ju lus, zoti Lekaj, Nait Hasani, uluni, zoti Selimi, të lutem, ulu në vend ku e ke kartelën dhe voto.

Pika e gjashtë e rendit të ditës që ka mbetur në gjysmë është:

6. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe mineralet

Diskutimi për projektligjin e propozuar nga deputetët Shaip Muja, i përkrahur edhe nga pesë deputetë të tjerë ka përfunduar.

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka rekomanduar të mos miratohet në parim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Ka ngelur pa u votuar, mendoj që mirë është të votohet për ose kundër, nuk është me rëndësi shumë. Por prapë është e njëjta gjendje. Edhe një herë e qesim në votim dhe po i presim edhe deputetët e tjerë që t'i zënë vendet e tyre.

Derisa të bëhemi gati, ju njoftoj që sot është Dita e fëmijëve të prekur me sindrom, kemi edhe këtu në sallë, dua t'i përshëndes në emër tuajin edhe prezencën e tyre dhe t'i përshëndes të gjithë ata që kanë probleme të tilla, si dhe familjet e tyre që me përkushtim kujdesen për ta. Gjithashtu dëshiroj që edhe shteti i Kosovës do të ketë angazhime shtesë për njerëzit e tillë, të cilët kanë probleme të tilla.

Edhe një herë, ne projektligjin e kemi hequr dje për shkak të mungesës, vullnetit për të votuar, jo mungesës së kuoromit, edhe një herë e hedh në votim. Në qoftë se nuk votohet, e vetmja gjë mbetet të hiqet krejt prej rendit të ditës dhe vazhdojmë me të tjera.

Edhe një herë votojmë, e përsëris votimin, meqenëse deputetët nuk ishin të vendosur në karriget e tyre. Pra, votimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

Po përsëris, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka rekomanduar të mos miratohet në parim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Edhe një herë, se ka probleme me teknikë.

Edhe një herë e përsërisim votimin, votojmë tash:
Nuk kalon, s'kemi pse e përsërisim më.

7. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar.

Të nderuar deputetë,
Lus që të përgatiteni për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Konstatohet që 70 deputetë me kartelë kanë votuar, 2 janë pa kartelë, bëjnë 72 dhe 72 vota janë për. Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgiminë në Kosovë.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore

Diskutimet për këtë ligj kanë përfunduar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kemi 71 vota, me kartelë. 63 vota janë për me kartelë. Kemi 1 votë të paraqitur pa kartelë që ka votuar për, bëjnë 64 vota; 8 abstenime dhe konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën jokontestimore.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të ndryshojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Votimi i Projektligjit për noterinë

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar me kartelë 72 deputetë. Kemi 72 vota për me kartelë, 1 e kemi pa kartelë, bëjnë 73 vota për.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për noterinë.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

10. Votimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! I kemi 70 vota me elektronikë të gjitha janë për, kemi 1 pa kartelë bëjnë 71 vota për. Asnjë kundër, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Votimi i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar me kartelë 73 deputetë. Një deputet është pa kartelë, bëjnë 74 vota për. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbime

Të nderuar deputetë,

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandojnë miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Grainca, e keni fjalën.

BLERIM GRAINCA: Fusha e shërbimeve ka qenë një sektor i parregulluar deri më tani, mirëpo ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që mundësojnë themelimin dhe ushtrimin e aktiviteteve përafuese të shërbimeve në Kosovë duke garantuar njëkohësisht siguri dhe cilësi të shërbimeve dhe njëkohësisht shërbime më të mira për përfituesit e tyre.

Ky projektligj është në përputhje me direktivat, përkatësisht me legjislacionin e BE-së dhe gjithashtu parashihen edhe modalitete për thjeshtimin e procedurave administrative, si dhe krijimi i një pike të vetme të kontaktit nga ana e MTI-së që t'ua mundësonte të gjithë përfituesve të kenë shërbime më kualitative.

Ministria e Financave ka garantuar se MTI-ja mund ta implementojë këtë ligj në përputhje me buxhetin që e ka të ndarë për vitin 2017/2019, andaj ju rekomandojmë që ta votoni në vijim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kontestime lidhur me amendamentet. Kemi gjithsej 15 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 74 deputetë, 72 vota janë për, 1 votë është kundër, 1 abstenim është. Kuvendi miratoi Ligjin për shërbime. Faleminderit!

13. Votimi i raportit të Komisionit për Legjislacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës me ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Diskutimet për këtë raport kanë përfunduar. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim të raportit. Votojmë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 70 deputetë. 65 vota janë për, asnjë kundër, 5 abstenime. Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Unë dua të ju njoftoj se në sallë i kemi 80 deputetë dhe kemi disa projektligje, të cilat kërkojnë votimin e 80 deputetëve. Në qoftë se jeni dakord dhe jeni të gjithë për t'u votuar, po i votojmë, nëse keni diçka të kontestueshme, mirë është të tregoni.

Andaj, po futemi në votimet të cilat kërkojnë 80 vota.

Muhamet Mustafa e ka kërkuar fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Desha vetëm ta ngre çështjen se e kemi edhe një marrëveshje, që rastësisht ka rënë, nuk ka hyrë. Ka të bëjë me Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë lidhur me marrëveshjen për

rregullimin e operatorëve të sistemit të transmisionit, OST, SHA dhe KOST-it, lidhur me shfrytëzimin racional të interkoneksionit dhe bashkëpunimit tjetër.

Kjo marrëveshje ka qenë në rend dite me vendim të Kryesisë, në mbledhjen e 27 shkurtit, por ka mbetur pa hyrë... Unë kisha propozuar që nëse hyjmë në votim, për shkak të rëndësisë, që edhe kjo marrëveshje të hyjë në rend dite. Faleminderit!

KRYESUESI: Janë këtu ato projekt-marrëveshje, nëse pajtohen deputetët ne i fusim në votim dhe nëse votojmë të gjithë. Unë ju lutem, që të mos i lini vendet e juaja, sepse nëse një votë nuk është, atëherë nuk mund të kalojnë.

14. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-152 për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Konstatohet, se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë, numër i mjaftueshëm për procedim. U bënë tani 83 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Një e kemi pa kartelë. Kemi 81 votë me kartelë, një pa kartelë bëjnë 82, 80 vota me kartelë janë për edhe një pa kartelë është për, që bëjnë 81 vota, ka abstenuar vetëm një. Konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, e përfaqësuar nga Ministria Federale e Financave.

15. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e programit kornizë për bashkëpunim financiar

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Në sallë janë 83 deputetë dhe lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kanë votuar 81 deputetë me kartelë, një është pa kartelë. 80 janë për me kartelë, një pa kartelë që bëjnë 81 për, një ka abstenuar, asnjë s'është kundër.

Konstatohet, se Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për themelimin e Programit kornizë për bashkëpunimin financiar.

16. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e protokollit financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të marrëveshjes për hua për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Në sallë janë 83 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Kemi 79 vota, një pa kartelë, 80. 76 kanë votuar për, një kundër, 2 abstenime. Nuk kalon.

Nuk i di arsyet pse s'votuat, por sidoqoftë... ndoshta... s'e di! Unë s'po kuptoj pse të mos votohet kjo. Edhe një herë e fus në votim Projektligjin për ratifikimin e protokollit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të marrëveshjes për hua për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS. Unë besoj se duhet të gjithë ta votojmë.

Votojmë tash! Nuk kalon!

17. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së Garancisë për FSDK-në Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar. Në sallë është numri i njëjtë i deputetëve. Votojmë tani!

Sa vota janë pa kartelë? Një, dy... prapë s'mjaftojnë, sepse duhet edhe një votë më shumë. Atëherë, kemi 80 vota me kartelë, tri janë pa kartelë, që bëjnë 83 vota. Kanë votuar për me kartelë 77 deputetë, 3 janë pa kartelë që kanë votuar për, asnjë s'është kundër, 3 abstenime. Konstatoj se me 80 vota për Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë për FSDK-në, Linja e dytë kreditore për Fondin për Sigurimin e depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, deputetin Naser Osmani, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Para se t'i them dy-tri fjalë lidhur me amendamentimet që i ka bërë Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore. Më vjen keq që deputetët nuk ishin në nivelin e detyrës për të votuar marrëveshjen financiare me Shtetin e Francës, sepse ka të bëjë me ndërtimin e impiantit për kryeqytetin e Prishtinës, Obiliqit dhe të Fushë-Kosovës dhe ky do të ishte njëri nga projektet më të mëdha të natyrës së përpunimit të ujërave të zeza. Çuditërisht deputetët e papërgjegjshëm nuk e kanë marrë për bazë që ka të bëjë me diçka që Kosova, sidomos Prishtina gjithnjë rrezikohet dhe ndotet, ndoshta dikujt i konvenon që të jetë i ndotur vazhdimisht, prandaj edhe nuk ka votuar.

Sa i përket Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Bankës Qendrore, Komisioni i ka bërë dy ndryshime, ajo që ka të bëjë me afatin e ankesës në rast se guvernatori e ushtron këtë ankesë nga 15 në 30 ditë, edhe ajo që ka të bëjë me auditimin. Kemi bërë më tepër një përmirësim të terminologjisë apo standardizimin e terminologjisë adekuat që e kemi quajtur “Auditori i jashtëm” e jo “kompania e auditimit”. Pra, këto janë dy përmirësime, të cilat besoj se deputetët do t'i votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Tash e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Faleminderit! I kemi 78 vota me kartelë dhe 2 pa kartelë, që janë paraqitur dhe bëjnë 80 vota.

Për janë me kartelë 67 vota, 2 pa kartelë, që bëjnë 69 vota.

10 janë kundër. 1 ka abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, zonjën Selvije Halimi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar deputetë,

Komisioni e ka formuar Grupin punues dhe i ka përpiluar amendamentet dhe gjithashtu komisioni i ka përkrahur amendamentet për këtë projektligj.

Amendamentet e komisionit janë kryesisht amendamente teknike, kurse e kemi pasur edhe një amendament të deputetit Hasani, por duke kërkuar falje publikisht nga zoti Hasani dhe të gjithë të tjerët që e kanë marrë raportin, ne kemi bërë një lëshim teknik në përshkrimin e amendamentit të zotit Hasani në raportin me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, të cilin po e korrigojmë këtu në Kuvend.

Propozimi ka qenë që një ditë, apo 24 orë të kaluara në ekzekutim të dënimit me burg të përlllogaritet me 1.5, gjegjësisht 24 orë të llogariten me 36 orë dhe ne e kemi shtuar fjalën “24 orë të kaluara në ekzekutim të dënimit me burgim apo burgim të përjetshëm”. Pra fjalët “apo burgim të përjetshëm” nga amendamenti në raport të komisionit duhet të hiqen, ka qenë lëshim yni, nga se, zakonisht kur bëhen dënimet, përmendet edhe ky lloj dënimi. Pra, ka qenë lëshim jo i qëllimshëm, por lëshim neglizhent, nga pakujdesia dhe për këtë fakt është edhe amendamenti i propozuar nga zoti Hasani, i cili u është shpërndarë të gjithë deputetëve, por ky amendament nuk ka pasur vota të mjaftueshme në komision për të kaluar dhe si i tillë tash vendosin deputetët.

Ne si komision jemi pro Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale që të kalojë në seancën e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi gjithsej 14 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL dhe 1 amendament nga deputeti Nait Hasani, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, që është amendamenti 1 dhe e votojmë me elektronikë.

Naiti e do fjalën! Atëherë, urdhëro zoti Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, ministër,

Përshëndetje kolegë deputetë,

Falënderoj edhe nënkryetaren e Komisionit që e bëri sqarimin, sepse amendamenti im ka qenë ai që e prezentoj këtu tash nënkryetarja.

Unë mendoj se amendamentin e kam proceduar me kohë dhe kam kërkuar jo më shumë se sa t'i ndihmohet shtresës së të burgosurve dhe pikërisht kam menduar, pasi që kam qenë pjesë e burgjeve të asaj kohe, e di në ç' gjendje janë brenda. I njoh kushtet e brendshme të të burgosurve, i njoh edhe vuajtjet dhe mundësitë e tyre që të ndikohet në përmirësimin e tyre.

Gjatësia e burgut, në shumicën e rasteve nuk e kryen efektin pozitiv, por vetëm e dëmton shëndetin e tyre.

Në anën tjetër, po ashtu, shteti i Kosovës, Qeveria e të tjera kanë mundësi të lirojnë për të mos paguar për të burgosurit aq shumë, por edhe familjet e tyre, po edhe familjet tona, të cilat i kanë njerëzit e afërm atje, do të lirohen nga një përgjegjësi dhe shpenzim i madh.

Qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burg te personat e vuajtjes është riedukimi, si qëllim kryesor, risocializimi në shoqëri, prandaj në burgjet e Kosovës në krahasim me burgjet e shteteve të Bashkimit Evropian dënimi është nga 1.1, 1.3, 1.5, 1.7 , në forma të ndryshme e kanë, secili shtet e ka rregulluar në formën e vet.

Pra, janë masat lehtësuese si qëllim i jetës së njeriut. Burgjet kanë qëllim t'i kthejnë njerëzit në jetë, t'i bëjnë të aftë për familjet e tyre dhe shoqërinë, e cila do të ndikojë në lehtësimet financiare në familje dhe në shtet.

Prandaj, kërkoj nga deputetët që ta miratojnë ose të përkrahin amendamentin që është 1 ditë ose 24 orë të kaluara në ekzekutimin e dënimit me burgim, të jetë i barasvlershëm me 1,5 ditë, ose 36 orë të kaluara në liri.

Me miratimin e këtij amendamenti ne do të ndihmojmë 1.800 të burgosur tanë, të cilët kanë vuajtur dhe kanë vuajtje të ndryshme atje, me përjashtim atë që e prezantoi edhe Selviya, te burgimi i përjetshëm, por ne nuk kemi raste të tilla, prandaj po kërkoj nga deputetët ta votojnë amendamentin që të ndihmojnë familjet, të ndihmohen të burgosurit, të ndihmojmë edhe shtetin e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! E votojmë amendamentin e parë, me elektronikë.

Amendamenti 1. Deputeti Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash:

Nuk kalon. Nuk votojnë, arsyeja dihet.

Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve të tjera, sipas radhitjes:

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

(Ndërhyrje, ndërprerje)

Atëherë, kur të kemi kuorum, e qesim prapë në votim këtë ligj të famshëm.

Pal Lekaj e ka kërkuar fjalën. Lus deputetët të kthehen në sallë!

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sapo bisedova me zotin Haradinaj. Ai ju përsëndet të gjithëve dhe më tha që ta votojmë Marrëveshjen me Francën për ratifikim dhe tha, pa marrë parasysh gjendjen time, unë jam për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pra, e përsëndesim edhe ne Ramushin dhe e falënderojmë për insistimin e tij.

Tash e qesim në votim edhe një herë pikën e 16-të të rendit të ditës, sipas kërkesës së kryetarit të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zotit Lekaj:

16. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e protokollit financiar midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe të marrëveshjes për hua për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS

Lus të përgatiteni për votim. Votojmë tash!

Faleminderit! I kemi 5 vota pa kartelë. Kemi 79 vota pro, me kartelë, 80 kanë votuar me kartelë, të tjerët pa kartelë. 1 ka abstenuar.

Që do të thotë i kemi 84 vota për dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e protokollit financiar mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës dhe Marrëveshjes për hua për zbatimin e protokollit financiar ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe NATIXIS.

Regjia, zoti Morina e ka kërkuar fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Meqë është numri i mjaftueshëm, ne e kemi edhe një marrëveshje që kërkohet për ratifikim dhe është e nevojshme. Besoj që edhe partitë politike do të pajtohen. Është marrëveshja për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor ndërmjet Kosovës e Shqipërisë.

(Reagime)

Po unë thashë, nëse ka mundësi të gjendet pajtueshmëri e të gjitha subjekteve politike, e nëse jo, atëherë e lëmë për seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: S' është ministri për ta prezantuar. Prandaj, kjo mbetet për seancën e ardhshme.

Pra, me kaq edhe po e mbyllim seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*